

VJETARI 2014

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

YEAR-BOOK 2014

35



PRISHTINA
2015

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

VJETARI 2014

35



Redaktor

Isuf Krasniqi

Sekretar i përgjithshëm
i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

PËRMBAJTJA

PËRBËRJA E AKADEMISË

A. KRYESIA	7
B. ANËTARËT E AKADEMISË.....	7
I. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË	7
II. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE	7
III. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS	8
IV. SEKSIONI I ARTEVE.....	8
V. ANËTARËT IN MEMORIAM	8
VI. ANËTARËT JASHTË TRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS.....	9
VII. ANËTARËT E JASHTËM.....	9
VIII. ANËTARË NDERI.....	10
C. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE DHE TEKNIKE	10
RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2014	11
I. KUVENDI	13
II. KRYESIA	14
III. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË	27
IV. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE	29
V. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS	30
VI. SEKSIONI I ARTEVE.....	33
VII. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE E TEKNIKE.....	34
PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2015	43
PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS	59
KRONIKË - 2014	79

A. KRYESIA

Akademik **Hivzi Islami**, kryetar,
Akademik **Pajazit Nushi**, nënkryetar,
Akademik **Isuf Krasniqi**, sekretar i përgjithshëm,
Akademik **Mehmet Kraja**, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë,
Akademik **Mark Krasniqi**, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore,
Akademik **Fejzullah Krasniqi**, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës,
Akademik **Zeqirja Ballata**, sekretar i Seksionit të Arteve.

B. ANËTARËT E AKADEMISË

I. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Ali Aliu (1934), i zgjedhur më 2000,
Besim Bokshi (1930), i zgjedhur më 1996,
Eqrem Basha (1948), i zgjedhur më 2004,
Idriz Ajeti (1917), i zgjedhur më 1975,
Mehmet Kraja (1952), i zgjedhur më 2008,
Rexhep Ismajli (1947), i zgjedhur më 1996,
Rexhep Qosja (1936), i zgjedhur më 1975,
Sabri Hamiti (1950), i zgjedhur më 2008.

b) Anëtarët korrespondentë:

Mehmet Halimi (1937), i zgjedhur më 2012,
Zejnullah Rrahmani (1952), i zgjedhur më 2012.

II. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Ekrem Murtezai (1931), i zgjedhur më 2000,
Esat Stavileci (1942), i zgjedhur më 2000,
Hivzi Islami (1946), i zgjedhur më 2000,
Mark Krasniqi (1920), i zgjedhur më 1985,
Pajazit Nushi (1933), i zgjedhur më 2008,
Isa Mustafa (1951), i zgjedhur më 2012.

b) Anëtarët korrespondentë:

Arsim Bajrami (1960), i zgjedhur më 2012,
Anton K. Berishaj (1954), i zgjedhur më 2012,
Edi Shukriu (1950), e zgjedhur më 2012,
Jusuf Bajraktari (1948), i zgjedhur më 2012.

III. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Feriz Krasniqi (1931), i zgjedhur më 2000,
Latif Susuri (1941), i zgjedhur më 2008,
Minir Dushi (1929), i zgjedhur më 1979,
Nexhat Daci (1944), i zgjedhur më 1996,
Fejzullah Krasniqi (1953), i zgjedhur më 2012,
Isuf Krasniqi (1948), i zgjedhur më 2012.

b) Anëtarët korrespondentë:

Arsim Morina (1956), i zgjedhur më 2012,
Qamil Haxhibeqiri (1949), i zgjedhur më 2012,
Ruzhdi Pllana (1940), i zgjedhur më 2012,
Salih Gashi (1944), i zgjedhur më 2012.

IV. SEKSIONI I ARTEVE

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Engjell Berisha (1934), i zgjedhur më 2008,
Rauf Dhomi (1945), i zgjedhur më 1996,
Rexhep Ferri (1937), i zgjedhur më 2000,
Tahir Emra (1938), i zgjedhur më 2008,
Zeqirja Ballata (1943), i zgjedhur më 2000.

b) Anëtarët korrespondentë:

Luan Mulliqi (1953), i zgjedhur më 2012,
Xhevdet Xhafa (1934), i zgjedhur më 2012.

V. ANËTARËT IN MEMORIAM

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Agim Çavdërbasha,
Ali Hadri,
Ali Podrimja,
Dervish Rozhaja,
Enver Gjerqeku,
Esad Mekuli,
Fehmi Agani,
Gazmend Zajmi,
Jashar Rexhepagiq,
Muharrem Berisha,

Musa Haxhiu,
Muslim Mulliqi,
Osman Imami,
Remzi Bakalli,
Syrja Popovci,
Vladeta Vukoviq,
Vukasin Filipoviq.

b) Anëtarët korrespondentë:

Anton Pashku,
Eshref Ademaj,
Hajredin Hoxha,
Ibrahim Rugova.

VI. ANËTARËT JASHTË TRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Sinan Hasani (letërsi), Serbi, i zgjedhur më 1986.

b) Anëtarët korrespondentë:

Zef Mirdita (histori), Kroaci, i zgjedhur më 1991.

VII. ANËTARËT E JASHTËM

Aleksandar Stipçeviq (histori), Kroaci, i zgjedhur më 1983,
Ismail Kadare (letërsi), Shqipëri, i zgjedhur më 1991,
Wilfried Fiedler (gjuhësi), Gjermani, i zgjedhur më 1991,
Eric Hamp (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur më 1991,
Shaban Demiraj (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur më 1996,
Gunnar Svane (gjuhësi), Danimarkë, i zgjedhur më 1996,
Kristian Gyt (histori e kulturës), Francë, i zgjedhur më 1996,
Gjelosh Gjokaj (art figurativ), Gjermani, i zgjedhur më 1996,
Leonard Newmark (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur më 2000,
Robert Elsie (letërsi), Kanada, i zgjedhur më 2000,
Michel Roux (gjeografi, gjeopolitikë), Francë, i zgjedhur më 2000,
Muhamedin Kullashi (filozofi), Francë, i zgjedhur më 2000,
Tomë Berisha (elektroteknikë), Kroaci, i zgjedhur më 2000,
Noel Malcolm (histori), Angli, i zgjedhur më 2004,
Victor Friedman (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur më 2004,
Emin Riza (arkitekturë), Shqipëri, i zgjedhur më 2008,
Françesko Altimari (gjuhësi), Itali, i zgjedhur më 2008,
Muhamet Mufaku (histori), Jordan, i zgjedhur më 2008,

Alajdin Abazi (elektroteknikë), Maqedoni, i zgjedhur më 2012,
Kolec Topalli (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur më 2012,
Oliver Schmit (histori), Austri, i zgjedhur më 2012,
Radoslav Katicic (gjuhësi), Kroaci, i zgjedhur më 2012.

VIII. ANËTARË NDERI

Ferid Murati, nobelist, jeton në SHBA, i zgjedhur më 2000.

C. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE E TEKNIKE

Lendita Juniku Pula, sekretare e Akademisë,
Ali Caka, drejtor i departamentit të përkrahjes profesionale,
Vjollca Hykollli, drejtoreshë e departamentit financiar,
Hilmi Zogjani, përgjegjës i njësisë së bibliotekës,
Furtuna Naka, menaxhere e prokurimit,
Xhemshit Brajshori, bashkëpunëtor për marrëdhënie ndërkombëtare dhe
veprimtari botuese,
Hasime Maliqi, zyrtar certifikues, zyrtar i pasurisë dhe i të hyrave,
Lirijeta Bunjaku, zyrtar për shpenzime – financiar,
Lidije Kelmendi, bibliotekare,
Rejhane Ajeti Islami, bibliotekare,
Bedri Plana, zyrtar i librisë,
Taulant Veseli, Zyrtar i TIK, redaktor teknik, zyrtar i shpenzimeve,
mirëmbajtës i faqesueb, zyrtar për qasje në dokumente publike,
Rron Baraku, Zyrtar i TIK, radhitës në kompjuter, redaktor teknik,
zyrtar i pranimit,
Burim Rexhepi, radhitës në kompjuter (redaktor teknik),
Dafina Kavaja, sekretare teknike e Kryesisë,
Alban Bytyçi, shofer-korrier,
Valbona Olluri, punëtore teknike,
Avdi Gashi, librashitës-receptionist.

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2014



I. KUVENDI

Organi më i lartë i qeverisjes - Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në vitin 2014 është mbledhur tri herë. Për herë të parë më 18 shkurt (Mbledhja LXXXI), për herë të dytë më 2 korrik (Mbledhja LXXXII) dhe për herë të tretë më 24 dhjetor (Mbledhja LXXXII).

I. Në mbledhjen e parë të këtij viti (Mbledhja LXXXI), si zakonisht, përveç miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse, u shqyrtuan edhe pikat: Raporti mbi punën e Akademisë për vitin 2013; Raporti financiar i Akademisë për vitin 2013 dhe Çështje vijuese.

Pas miratimit të procesverbalit kryetari Islami në mënyrë përmbledhëse paraqiti aktivitetin vjetor të Akademisë.

Fjala e kryetarit është pasqyruar në procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit.

Në vazhdim u shqyrtua raporti i punës së ASHAK-ut për vitin 2013 sipas radhës, duke filluar nga ai i punës së Kuvendit dhe në vazhdim për punën e Kryesisë, të seksioneve deri te raporti i punës së shërbimit administrativ, profesional dhe teknik të Akademisë, i cili u miratua pa vërejtje. Raporti do të botohet në "Vjetari" 2013.

Kuvendi miratoi edhe raportin financiar të ASHAK-ut për vitin 2013.

II. Në Mbledhjen e dytë (Mbledhja LXXXII), të Kuvendit, mbajtur më 2 korrik, pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse u diskutua për Programin e punës së ASHAK-ut për vitin 2015.

Para nisjes së shqyrtimit të Programit të punës kryetari Islami paraqiti vlerësimet e tij. Fjala e plotë e kryetarit Islami është pasqyruar në procesverbalin e kësaj mbledhjeje.

Më pas Kuvendi shqyrtoi Programin e punës për vitin 2015, me radhë sipas seksioneve dhe e miratoi në plotni atë.

Programi i punës për vitin 2015 është i pasqyruar në tërësi në procesverbalin e kësaj mbledhjeje dhe do të botohet në *Vjetari 2014*.

III. Mbledhja e Kuvendit e mbajtur më 24 dhjetor, e fundit e këtij viti u mor me zgjedhjet për Kryesinë e Akademisë.

Pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse fjalën e hapjes (e cila është pasqyruar në procesverbalin e kësaj mbledhjeje) e paraqiti Kryetari i Akademisë.

Më pas Kuvendi i Akademisë emëroi Komisionin e zgjedhjeve me këtë përbërje: Ali Aliu, kryetar dhe Feriz Krasniqi e Rexhep Ferri, anëtarë. Komisioni i përgatiti dhe i shpërndau fletëvotimet për zgjedhjen e kryetarit, nënkryetarit dhe të sekretarit të përgjithshëm të Akademisë. Pas votimit me vota të fshehta, Komisioni i votimeve u tërhoq, i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këto rezultate:

Për zgjedhjen e kryetarit të Akademisë: kanë votuar 32 anëtarë të ASHAK-ut. Janë gjetur 28 fletëvotime të vlefshme dhe 4 të pavlefshme.

Kandidati Hivzi Islami ka marrë 28 vota dhe është zgjedhur kryetar i Akademisë për mandatin e ardhshëm 3-vjeçar.

Për zgjedhjen e nënkryetarit të

Akademisë: kanë votuar 32 anëtarë të ASHAK-ut. Janë gjetur 32 fletëvotime të vlefshme.

Pajazit Nushi ka marrë 20 vota.

Zeqirja Ballata ka marrë 12 vota.

Kandidati Pajazit Nushi ka marrë numrin e nevojshëm të votave dhe është zgjedhur nënkryetar i Akademisë për mandatin e ardhshëm 3-vjeçar.

Për zgjedhjen e sekretarit të përgjithshëm të Akademisë: kanë votuar 32 anëtarë të ASHAK-ut. Janë gjetur 31 fletëvotime të vlefshme dhe 1 i pavlefshëm.

Isuf Krasniqi ka marrë 24 vota

Rauf Dhomi ka marrë 7 vota.

Kandidati Isuf Krasniqi ka marrë numrin e nevojshëm të votave dhe është zgjedhur Sekretar i përgjithshëm i Akademisë për mandatin e ardhshëm 3-vjeçar.

Kuvendi i Akademisë gjithashtu verifikoi zgjedhjen e:

- Akademik Eqrem Bashës, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe Letërsisë;

- Anëtar korrespondent Jusuf Bajraktarit, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore;

- Akademik Fejzullah Krasniqit, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës;

- Anëtar korrespondent Luan Mulliqit, sekretar i Seksionit të Arteve.

Pas shpalljes së rezultateve, në emër të të zgjedhurve u falënderua kryetari, akademik Hivzi Islami.

II. KRYESIA

Bazuar në kompetencat dhe obligimet e përcaktuara me Ligjin për Akademinë dhe me Statutin e saj, Kryesia e Akademisë në 13 mbledhjet e vitit 2014 është marrë me shqyrtimin e shumë çështjeve.

Në vazhdim në mënyrë kronologjike do të pasqyrohet aktiviteti i Kryesisë së Akademisë.

1. Kryesia në mbledhjen (XXVIII) e 21 janarit vendosi të shpallë konkursin publik për ndarjen e Shpërblimit mbështetës 2014, me kriter: Për kandidatin e moshës së re që ka arritur rezultate të rëndësishme në fushën e shkencës dhe të artit.

U tha që konkursi të shpallet në njëren prej gazetave ditore të vendit.

Njëherësh Kryesia diskutoi edhe çështjen e Fondit për stimulimin e zhvillimit të punës shkencore-kërkimore të të rinjve nga lëmi i shkencave të natyrës. Kryetari Islami në fjalën e tij tërhoqi vërejtjen për punën e Fondit në fjalë, meqë kanë kaluar shumë vite nga pranimi i donacionit dhe deri më tani mjetet nuk janë shfrytëzuar. Ai më pas tha se për këtë çështje kemi pasur vërejtje edhe nga Auditori i përgjithshëm. M. Kraja në fjalën e tij propozoi që mjetet e Fondit të ridestinohen, ashtu që ato të bashkohen dhe Akademia të hartojë një rregullore të re me të cilën do të caktohej një Çmim vjetor i cili do të ndahej në fund të çdo viti në emër të Akademisë e jo veç e veç nga seksionet, meqë seksionet janë pjesë e saj.

Më pas kryetari Islami kërkoi nga

Isuf Krasniqi, si sekretar i përgjithshëm që vërejtjet e lartpërmendura t'ia përcjellë Këshillit drejtues të Fondit dhe kërkoi që sa më parë ai dhe udhëheqësi i Fondit të dorëzojnë raporte me shkrim lidhur me punën e deritashme të Fondit, meqë sipas nenit 4, pika 6 të Rregullores së Fondit parashihet që Këshilli drejtues i Fondit duhet t'i raportojë Kryesisë së Akademisë.

2. Në mbledhjen (XXIX) e mbajtur më 31 janar Kryesia i shqyrtoi me radhë të gjitha pikat e Raportit të punës së ASHAK-ut për vitin 2013, duke filluar nga Kuvendi e deri te Shërbimi Administrativ, Profesional e Teknik. Gjatë shqyrtimit të Raportit të punës diskutuan H. Islami, P. Nushi, M. Kraja. P. Nushi propozoi që në raportin e Seksionit të Shkencave Shoqërore të shënohet edhe anëtarësimi i anëtarëve të Seksionit, H. Islami dhe E. Shukriu në Akademinë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve (EASA), si dhe propozoi të riformulohet arsyetimi që ka të bëjë me botimin e tij Mendimi psikologjik popullor dhe gjeneza e të menduarit shkencor psikologjik të shqipfolësit, meqë arsyetimi i shënuar nuk është i saktë.

Lidhur më Raportin e Seksionit të Shkencave të Natyrës M. Kraja tha se pika që ka të bëjë me projektin "Identifikimi i ndotësve të efluentëve të ujërave urbane dhe të industrisë dhe trajtimi i tyre" të shikohet edhe një herë pas shqyrtimit të pikës së 7. të rendit të ditës. U diskutua edhe Raporti i Seksionit të Arteve dhe lidhur më botimin Përmbledhje romancash të kompozitorëve kosovarë, u tha se botimet e tilla duhet të kenë një

parathënie studiuëse. Pas diskutimeve u vendos që Raporti me plotësimet e lartcekura t'i përcillet Kuvendit të ASHAK-ut për miratim.

Po ashtu u shqyrta edhe Raporti financiar i ASHAK-ut për vitin 2013. U tha se disa pika të Raportit të plotësohen me arsyetime shtesë.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesia: vendosi që mbledhja LXXXI e Kuvendit të Akademisë të mbahet më 18 shkurt 2014, në orën 11:00 me rendin e ditës si në vijim: miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXX të Kuvendit; shqyrtimi i Raportit të punës së ASHAK-ut për vitin 2013; shqyrtimi i Raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2013; çështje vijuese; Vendosi të ngrihet Komisioni për vlerësimin e kandidatit për ndarjen e Shpërblimit mbështetës 2014 me këtë përbërje: akademik Hivzi Islami, akademik Tahir Emra dhe anëtar korrespondent Qamil Haxhibeqiri; Vendosi të shtohet tirazhi i monografisë Kosova, në gjuhën angleze; Shqyrtoi raportin e akademik Nexhat Dacit "Identifikimi i ndotësve të efluentëve të ujërave urbane dhe të industrisë dhe trajtimi i tyre" dhe vendosi që raporti në fjalë të kthehet edhe një herë për shqyrtim në Seksion me kërkesë që për projektin në fjalë të hartohet edhe një raport i punës për periudhën korrik-dhjetor 2013.

Kryesia po ashtu shqyrtoi dhe miratoi raportin e Këshillit drejtues të Fondit për stimulimin e zhvillimit të punës shkencore-kërkimore të të rinjve nga lëmi i shkencave të natyrës; Ngriti Komisionin përzgjedhës për pranimin e punonjësit të ri në vendin e punës

menaxher i Prokurimit, me këtë përbërje: Akademik Isuf Krasniqi, kryetar, Ali Caka, anëtar, Vjollca Hykolli, anëtare, Hilmi Zogjani, anëtar, Hasime Maliqi, anëtare; Mori vendim për vazhdimin e mandatit të Komisionit për blerjen e veprave artistike edhe për tri vitet e ardhshme. Në vend të Hivzi Islamit, anëtar i Komisionit u caktua Pajazit Nushi; Miratoi kërkesën e Drejtorit të Departamenti të Përkrahjes Profesionale për vijimin e trajnimit Mëso duke punuar; Miratoi raportin e akademik Hivzi Islamit dhe anëtarëve korrespondentë Arsim Bajrami dhe Anton K. Berishaj për qëndrimin e tyre në Tiranë më 23-25 janar 2014.

3. Kryesia në Mbledhjen e dt. 26 shkurt (XXX) pas miratimit, si zakonisht të procesverbalit nga mbledhja pararendëse shqyrtoi raportin e Komisionit përzgjedhës lidhur me konkursin e shpallur për plotësimin e vendit të punës menaxher i prokurimit (akademik Isuf Krasniqi, Ali Caka, Vjollca Hykolli Hilmi Zogjani, Hasime Maliqi) dhe duke përkrahur propozimin e Komisionit mori vendim që Furtuna Naka të pranohet në vendin e punës Menaxher i prokurimit. Po ashtu u shqyrta raporti gjashtëmujor (korrik-dhjetor) i projektit “Identifikimi i ndotësve të efluentëve të ujërave urbane dhe të industrisë dhe trajtimi i tyre”. U tha se raporti tani është i plotë dhe se janë dhënë të gjitha detajet rreth punës së deritanishme. Kryesia miratoi raportin në fjalë, si dhe mori vendim për pagimin e paushallëve personave të angazhuar në projekt.

Në kuadër të pikës së fundit të kësaj

mbledhjeje M. Kraja e njoftoi Kryesinë me propozimin e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë të Tiranës, i cili i është drejtuar atij si sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë për pjesëmarrjen e ASHAK-ut dhe përrurimin e botimeve të tij në panairin që organizohet nga fakulteti në fjalë, më 23 prill 2014. Ai tha se propozimi është shqyrtuar në Seksion dhe pas shqyrtimit Seksioni është pajtuar për promovimin e botimeve të tij, ndërsa propozimi për pjesëmarrjen në panair është thënë se duhet t’i dërgohet Kryesisë për miratim. Diskutuan H. Islami, I. Krasniqi, M. Kraja dhe pas diskutimeve Kryesia vendosi që Akademia të mos marrë pjesë në panair, ndërsa çështja e promovimit dhe përzgjedhjes së librave që do të promovohen u tha të vendoset nga Seksioni. Njëherësh në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës Kryesia mori vendim për organizimin e punëtorisë për Shërbimin Profesional Administrativ të ASHAK=ut në Durrës më 28 deri më 30 mars 2014.

4. Në mbledhjen (XXXI) e mbajtur më 5 mars Kryesia miratoi prononcimin e ASHAK, lidhur me shkrimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë publikuar ditë më parë në medie me këtë përmbajtje:

“LETËR PUBLIKE E AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS DREJTUAR AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve e Kosovës (ASHAK) i ndoqi me vëmendje prononcimet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH) lidhur me debatin midis dy

anëtarëve të ASHAK-ut, Rexhep Qosjes dhe Hivzi Islamit. Në të dy prononcimet udhëheqja e ASHSH-së pa asnjë shkas u implikua drejtpërsëdrejti në këtë debat midis individësh, duke marrë anën e atij që pa të drejtë dhe në vazhdimësi e denoncon Akademinë tonë. Pikënisja e debatit qëndronte tek kritikata ndaj ASHAK-ut që i paska pranuar J. B. Titon dhe S. Hasanin anëtarë dhe nuk i paska hequr deri sot nga lista e anëtarësisë. Shërbimi profesional i Akademisë, në bazë të procesverbaleve të kohës, i dha shpjegimet përkatëse për opinion, duke saktësuar se heqja nga lista e kujtdo që është pranuar njëherë në Akademi është e kundërligjshme dhe në kundërshtim me të gjitha parimet e akademive të botës. Në kohën kur janë pranuar gjithashtu Tito dhe Hasani anëtarë të ASHAK-ut, R. Qosja ka qenë anëtar funksional i Akademisë dhe i të gjitha forumeve të saj.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës është institucion me 36 anëtarë aktivë dhe një plotësisht pasiv (R. Qosja), i cili nuk merr pjesë në asnjë aktivitet dhe nuk vjen në institucion tash e shumë vjet. ASHAK i ka organet e veta të ligjshme: Kuvendin, Kryesinë, Seksionet dhe trupat e tjerë, përmes të cilave zhvillon veprimtarinë e saj. Në këto suaza, secili anëtar ka mundësi të shprehë të gjitha shqetësimet e tij dhe të kërkojë mbështetje për propozimet dhe idetë konkrete. Mbi këto nivele dhe themele Akademia si institucion e zhvillon edhe bashkëpunimin me institucionet e tjera, brenda Republikës së Kosovës dhe jashtë saj, përfshirë edhe bashkëpunimin me ASHSH-në mbi bazë të Marrëveshjes së bashkëpunimit dhe

protokolleve për zbatimin e saj, që nënshkruhen çdo dy vjet.

Ndërhyrja dhe rreshtimi i njëanshëm i udhëheqjes së ASHSH-së, mbi bazë të preferencave ideologjike, siç është bashkimi me një grup personash jashtë Akademisë, le të kuptohet se ASHSH-ja në raportet e saj me ASHAK-un, dëshiron të niset nga marrëdhëniet e saj me individë që ajo apo kreu i saj parapëlqen dhe jo nga raportet me institucionin, me të cilin ka marrëveshje bashkëpunimi. Seleksionimi i tillë i njëanshëm dhe ndërhyrja paternaliste mund të ketë implikime serioze në bashkëpunimin midis dy institucioneve.

Pavarësisht nga rrethanat, në këtë bashkëpunim ASHAK-u asnjëherë nuk është nisur nga parime të tilla, por ka bërë çmos që çdo gjë në marrëdhëniet midis dy institucioneve të rrjedhë në rrafsh institucional, pa ndërhyrë asnjëherë dhe për asnjë gjë në raportet dhe çështjet brenda ASHSH-së. Kjo ishte dhe baza e shëndoshë që ka siguruar bashkëpunimin afatgjatë dhe e ka bërë të mundshëm realizimin e një varg aktiviteteve të përbashkëta, gjë që për ASHAK-un gjithnjë ka qenë prioritet absolut.

Gjatë bashkëpunimit shumëvjeçar ASHAK është përpjekur që me çdo kusht t'i realizonte të gjitha pikat e Protokollit, ndërsa nga ana e ASHSH-së në vitet e fundit ka pasur mjaft ngecje, me arsyetim se Akademia është në proces të reformimit, nuk i ka më institutet dhe qendrat studimore brenda saj etj., që nuk dukeshin krejtësisht të qëndrueshme.

Kryesia e ASHAK-ut thekson edhe njëherë se dëshiron fuqishëm që

bashkëpunimin ta çojë përpara dhe ta ngrejë në shkallë edhe më të lartë, gjithnjë në kuadër të marrëveshjeve institucionale për bashkëpunim reciprok.

Raportet e individëve të ASHSH-së me individë a grupe joformale, kudo që të jenë, janë çështje të tyre, por në raportet me ASHAK-un është e nevojshme të evitohen sjelljet emocionale, mësimet ideologjike etj. ndaj Akademisë sonë dhe udhëheqjes së saj, mbi bazë të superioritetit të rremë dhe përgjithësisht të sjelljeve paternaliste, të cilat e rrezikojnë seriozisht raportin e bashkëpunimit, për çka ASHAK-u nuk mund të mbajë përgjegjësi.

Prishtinë, 5. 03. 2014

Për Kryesinë e ASHAK-ut,

Akademik Pajazit Nushi, nënkryetar

U vendos që prononcimi t'u dërgohet medieve.

Po ashtu në këtë mbledhje u miratua raporti i akademik Hivzi Islamit për qëndrimin e tij në Tiranë më 17-18 shkurt 2014 dhe arsyetimi i akademik Rexhep Ismajlit për anulimin e vizitës së tij në Salsburg.

5. Mbledhja (XXXII) e Kryesisë mbajtur më 27 mars : Kryesia shqyrtoi propozimin e Redaksisë Qendrore të Enciklopedisë së Kosovës për caktimin e shkallës së honorarëve për redaktorët dhe anëtarët e redaksive të fushave të Fjalorit Enciklopedik të Kosovës dhe mori vendim të paguhen honorarët si: për redaktorët e fushave, 300€; për anëtarët e redaksive të fushave, 200 €; Shqyrtoi propozimin e Pajazit Nushit,

kryeredaktor i revistës Studime shoqërore për zëvendësimin anëtarit të jashtëm të redaksisë së revistës në fjalë. Ai sqaroi se anëtarit të zgjedhur më parë Noel Malcolm, pas zgjedhjes i është dërguar njoftimi me shkrim nga Administrata e Akademisë, por nuk është kthyer asnjë përgjigje. Seksioni i Shkencave Shoqërore në mbledhjen e fundit në vend të Noel Malcolm ka propozuar të zgjidhet Robert Elsie, i cili është edhe anëtar i jashtëm i Akademisë sonë. Kryesia njëzëri vendosi që Robert Elsie të zgjidhet anëtar i jashtëm i Redaksisë së revistës Studime shoqërore; Vendosi të caktojë Komisionin përzgjedhës për pranimin e punonjësit të ri në pozitën Bibliotekar, me këtë përbërje: akademik Isuf Krasniqi, Lendita Pula, Ali Caka, Hilmi Zogjani dhe Lirijeta Bunjaku; Shqyrtoi propozimin e Seksionit të Arteve për caktimin e autorit të ri për monografinë e piktorit Gjelosh Gjokaj. U tha se kjo çështje duhet të kthehet për diskutim në Seksionin e Arteve dhe meqë monografia në fjalë ka hyrë në Programin e punës së ASHAK-ut, vetë seksioni të caktojë autorin e ri; Mori vendim për pagimin e mbushjeve telefonike për znj. Furtuna Naka, Menaxhere e prokurimit, në vlerë prej 30€ dhe z. Bedri Pllana tani më i sistemuar në vendin e punës Zyrtar i librisë, 10€. Pagesat fillojnë nga 01. 05. 2014.

6. Kryesia (XXXIII) e dt. 30 prill : Kryesia shqyrtoi propozimin e Seksionit të Shkencave të Natyrës për mbajtjen e takimit shkencor me temë "Gjuha e simetrive - një këndvështrim nga teoria e përfaqësimit dhe geometria". Diskutuan

H. Islami, P. Nushi, M. Kraja dhe pas diskutimeve propozimi u miratua; U shqyrtua raporti i Komisionit përzgjedhës lidhur me konkursin e shpallur për plotësimin e vendit të punës Bibliotekar (akademik Isuf Krasniqi, Lendita Pula, Ali Caka, Lirijeta Bunjaku dhe Hilmi Zogjani) dhe u vendos që Rejhane Ajeti Islami të pranohet në vendin e punës Bibliotekar;

Kryesia mori vendim për mbajtjen e takimit për projektin Enciklopedia e Kosovës (Fjalori Enciklopedik) në Durrës, nga data 9-12 qershor 2014. U tha se pjesëmarrësve të takimit t'u paguhen shpenzimet e akomodimit, transportit, materialeve të punës, si dhe 20% të mëditjeve ditore.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryetari Islami njoftoi sekretarët e seksioneve të ASHAK, se është koha të fillojnë përgatitjet për programin e punës për vitin 2015. U tha se gjatë muajit maj të mbahen mbledhjet e seksioneve ku do të shqyrtohen propozimet dhe javën e parë të qershorit ato të definohen. Kryesia rreth gjysmës së qershorit do të shqyrtojë propozimet të cilat më pas do t'i dërgohen Kuvendit të Akademisë për miratim.

Njëherësh në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia miratoi raportin e akademik Hivzi Islamit, anëtares korrespondente Edi Shukriu, Lendita Pulës, sekretare e Akademisë dhe Hilmi Zogjanit, përgjegjës i Bibliotekës, për qëndrimin e tyre në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Evropës (EASA) në Salsburg, më 6-9 mars 2014; Miratoi raportin e Shërbimit profesional administrativ të ASHAK, për mbajtjen e punëtorisë në

Durrës, më 28-30 mars 2014; Miratoi raportin e anëtarit korrespondent Luan Mulliqi për qëndrimin e tij në Rumani, më 2-6 prill 2014; Miratoi raportin e akademik Eqrem Bashës për pjesëmarrjen e tij në tubimin e ALLEA-s në Bruksel, më 8-10 prill 2014; Miratoi raportin e anëtarit korrespondent Arsim Bajrami për pjesëmarrjen e tij në Konferencën ndërkombëtare të organizuar nga Universiteti i Tetovës me temë: "Demokracia dhe sfidat e transicionit demokratik", në Maqedoni, më 11-13 mars 2014; Mori vendim për pagimin e mbushjeve telefonike për znj Rejhane Ajeti Islami, Bibliotekare, në vlerë prej 10€, nga 01. 06. 2014.

7. Në Mbledhjen (XXXIV) të saj mbajtur më 17 qershor, Kryesia shqyrtoi programin e punës së ASHAK-ut, për vitin 2015. Gjatë shqyrtimit të Programit të punës së Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, kryetari Islami lidhur me botimin e veprave të akademikëve Idriz Ajeti dhe Besim Bokshi, tha se për botimin e tyre nuk ka mjete të mjaftueshme financiare nga buxheti i ASHAK dhe se për botimet e tilla duhet të sigurohen mjete financiare nga donatorët e mundshëm. Ai tha se veprat e kësaj natyre janë realizuar edhe më parë në Akademi, por mjetet janë siguruar nga donacionet. Ai po ashtu përmendi faktin se sipas Rregullores mbi veprimtarinë botuese të Akademisë, neni 26, nuk rishtypen punimet që janë botuar në tërësi, ndërsa vepra e akademik Ajetit është botuar më parë dhe ende ka ekzemplarë të saj, ashtu si edhe librat e akademik Bokshit. Në

diskutimin e tij M. Kraja tha se botimi i veprave në fjalë është miratuar unanimitisht nga Seksioni. Ai po ashtu tha se nga përvoja e deritashme propozimet bëhen nëse ka mjete ato realizohen e nëse jo ndërpritet puna rreth përgatitjes së tyre, pra çështja është se miratohen nga Kryesia apo jo.

Më pas u shqyrtuan sipas rendit programet e punës së seksioneve të tjera të ASHAK-ut. Lidhur me propozimin e anëtarit korrespondent Luan Mulliqi për organizimin e dy ekspozitave personale, një në Zvicër dhe një në Gjermani u tha se Akademia nuk ka mundësi për organizimin e tyre, meqë siç u tha organizimi i ekspozitave jashtë vendit kërkon jo vetëm mjete të konsiderueshme financiare, por ka edhe procedura të tjera rreth transportit, sigurimit të veprave artistike, etj.

Lidhur me ndryshimet e lartpërmendura të Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe të Seksionit të Arteve diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë dhe në fund u tha se botimet e veprave të akademikëve I. Ajeti dhe B. Bokshi, si dhe ekspozitat e L. Mulliqit të hiqen nga Programi i punës.

Kryesia po ashtu propozoi që në programin e punës për vitin 2015 të hyjë edhe botimi 40 -vjet të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, si dhe të shënohet edhe 40-vjetori i themelimit të ASHAK.

Pas diskutimeve u tha se nga Programi i punës për vitin 2015 me plotësimet e lartshënuara do t'i

dërgohet Kuvendit të Akademisë për miratim.

Kryesia po ashtu: vendosi që mbledhja LXXXII e Kuvendit të Akademisë të mbahet më 2 korrik 2014, në orën 11:00 me rendin e ditës si në vijim: miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXXI të Kuvendit; miratimi i Programit të punës së ASHAK për vitin 2015; çështje vijuese; Miratoi propozimin e Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë për mbajtjen e tryezës shkencore me rastin e 200-vjetorit të lindjes së Jeronim De Radës; Mori vendim për blerjen e veprave artistike si më poshtë:

1. "Me hije dhe pa hije", pikturë, vaj në pëlhurë, 116x89 cm, autor Rexhep Ferri, 2008, me çmim prej 3.000€;

2. Nga cikli "Autobiografia 29", pikturë në pëlhurë (teknikë e kombinuar), 100x120 cm, autor Xhevdet Xhafa, 1989, me çmim prej 3.000€;

3. "Meditimi", skulpturë, metal i ngjyrosur, 97x120x47 cm, autor Ismet Jonuzi, 2010, me çmim prej 3.000€.

Njëherësh u tha se anëtari korrespondent Xhevdet Xhafa ka dhuruar edhe një pikturë për Akademinë: nga cikli "Autobiografia 19", pikturë në pëlhurë (teknikë e kombinuar), 100x90 cm, 1990;

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia: mori vendim për vazhdimin e angazhimit të Prof. Dr. Nebi Caka, deri më 31. 12. 2014, për punët në Qendrën Leksikografike Enciklopedike të ASHAK-ut; Mori vendim për angazhimin e z. Vehbi

Neziri për kryerjen e punëve rreth zhvillimit të softuerit për Bibliotekën e ASHAK. Punët dhe detyrat e punës caktohen me kontratë mbi vepër, e cila lidhet për periudhën 1 shtator 2014-1 shtator 2015. Të lartpërmendurit i bëhet kompensimi në vlerë prej 330€, për çdo muaj; si dhe Miratoi raportet nga udhëtimet zyrtare si në vazhdim: raportin e Ali Cakës, drejtor i DPP-së, për pjesëmarrjen e tij në trajnimin Aspektet praktike të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, në Ohër më 11-14 prill 2014; Raportin e Hilmi Zogjanit, përgjegjës i Bibliotekës për pjesëmarrjen e tij në Festivalin e parë të Librit dhe të Artit, Tirana 2014, në Tiranë, më 23-27 prill 2014;

Raportin e akademik Rexhep Ismajlit dhe Ali Cakës për qëndrimin e tyre në Lubjanë, me rastin e vizitës studimore në Institutin e gjuhës slovene dhe në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Sllovenisë, më 3-9 maj 2014; Raportin e akademik Zeqirja Ballatës për qëndrimin e tij në Bullgari, në kuadër të Protokollit të bashkëpunimit në mes të dy Akademive, më 12-16 maj 2014; Raportin e akademik Pajazit Nushit për qëndrimin e tij në Tiranë me rastin e pjesëmarrjes në konferencën ndërkombëtare kushtuar Akademik Jashar Rexhepagiqit dhe mendimit social –pedagogjik të tij, më 23-24 maj 2014; Raportin e znj. Lendita Pula dhe z. Ali Caka për qëndrimin e tyre në Shqipëri, bashkë me z. Zoran Mezeg, drejtor ekzekutiv i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Sllovenisë, më 29 maj-1 qershor 2014.

8. Në mbledhjen e saj të 4 korrik (XXXV) Kryesia: shqyrtoi raportin gjashtëmuor (janar-qershor 2014) të projektit “Identifikimi i ndotësve të efluentëve të ujërave urbane dhe të Industrisë dhe trajtimi i tyre”. U tha se raporti është përpiluar në detaje. Diskutuan I. Krasniqi dhe F. Krasniqi dhe pas diskutimeve Kryesia miratoi raportin në fjalë, si dhe mori vendim për pagimin e paushallëve për personat e angazhuar në projekt; Mori vendim që pjesëmarrësve të koncertit të organizuar nga Seksioni i Arteve (i paraparë me Programin e punës për vitin 2014) t’u paguhen paushallët përkatëse, vlera e të cilave do të përcaktohet me kontratë mbi veprën.

Kryesia më pas shqyrtoi raportin e anëtarit korrespondent Salih Gashi, për pjesëmarrjen e tij në tubimin “Euroscience Open Forum” (ESOF) në Kopenhagë, më 21-26 qershor 2014. M. Kraja në diskutimin e tij tha se Kryesia duhet të ketë një qëndrim të njëjtë për të gjithë anëtarët e Akademisë që shkojnë në udhëtime zyrtare, ashtu që shpenzimet e tyre të mbulohen vetëm kur udhëtimet bëhen në kuadër të aktiviteteve të Akademisë. Kryetari Islami në diskutimin e tij sqaroi se Akademia i mbulon vetëm shpenzimet e udhëtimeve që bëhen në kuadër të aktiviteteve të saj dhe në këtë rast anëtari korrespondent Salih Gashi është dashur ta cekë këtë në fillim të raportit të tij. U tha që raporti në fjalë t’i kthehet prof. Gashit dhe pasi të plotësohet t’i bashkëngjitet materialit të mbledhjes së Kryesisë.

Njëherësh në kuadër të kësaj

mbledhjeje u miratua propozimi nga sekretarja e Akademisë për planin e shfrytëzimit të pushimeve vjetore, si dhe u mor vendim për heqjen e telefonit roaming dhe pagimin e mbushjeve për akademik Rexhep Ismajlin, kryetar i këshillit për marrëdhënie ndërkombëtare në vlerë prej 50 €, nga data 1 gusht 2014.

9. Kryesia në mbledhjen e dt. 2 shtator (XXXVI) diskutoi lidhur më rizgjedhjen e sekretarit të Akademisë. Kryetari Islami njoftoi Kryesinë se më 1 dhjetor 2014 përfundon mandati i Sekretarit të Akademisë. Ai më pas duke iu referuar Ligjit për ASHAK, Ligji 2004/19, neni 25, pika 25. 3 dhe Statutit të Akademisë, neni 35, pika 5 dhe neni 39, pika 3, tha se është kompetencë e Kryesisë të bëjë rizgjedhjen e sekretarit të Akademisë. Ai në vazhdim paraqiti një raport të vlerësimit pozitiv të punës për znj. Lendita Pula, ku ndër të tjera theksoi: "Sekretaren e Akademisë e karakterizon vetiniciativa e theksuar, është tejet proaktive dhe energjike në kryerjen e punëve dhe detyrave të punës. Kompetente dhe e përkushtuar në zbatimin e udhëzimeve të marra nga organet drejtuese dhe qeverisëse të Akademisë. Ajo ka dëshmuar sjellje shumë korrekte me punonjësit e Akademisë dhe ka qenë tejet motivuese drejt ngritjes së performancës së punonjësve të Shërbimit Profesional Administrativ, si dhe ka dëshmuar që është e gatshme të përballojë punën me vëllim të shtuar, punën nën trysni si dhe jashtë orarit të rregullt të punës. Shquhet me profesionalizëm të nivelit të lartë në

kryerjen e detyrave të besuara, me sjellje korrekte në raport me palët dhe stafin Akademik. Bën mbikëqyrjen adekuate të punonjësve nën vartësinë e saj dhe raporton rregullisht për detyrat e punës. Performanca e përgjithshme e saj e punës vlerësohet tejet pozitive". Diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë dhe pas diskutimeve Kryesia njëzëri vendosi që znj. Lendita Pula, të rizgjidhet edhe për katër vite në pozitën e sekretarit të Akademisë. Kontrata e re punës lidhet për periudhën 1 dhjetor 2014 - 1 dhjetor 2018, me mundësi të rizgjedhjes.

Kryesia po ashtu shqyrtoi kërkesën e akademik Tahir Emrës për ndërprerjen e angazhimit të tij si anëtar i Redaksisë Qendrore të Enciklopedisë së Kosovës. U tha se kërkesa në fjalë do t'i dërgohet për miratim Bordit të Enciklopedisë, si organ kompetent për emërimin e anëtarëve të Redaksisë qendrore; Shqyrtoi kërkesën e punonjësit Xhemshit Brajshori, bashkëpunëtor për marrëdhënie ndërkombëtare dhe veprimtari botuese. Anëtarët e Kryesisë u shprehën kritik ndaj punës së z. Brajshori duke thënë se ai në vazhdimësi, përkundër vërejtjeve që i janë bërë, vazhdon të refuzojë kryerjen e detyrave të punës.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës të kësaj mbledhjeje, Kryesia: miratoi raportin e akademik Mehmet Krajës, kryeredaktor i Enciklopedisë së Kosovës për mbajtjen e takimit për Fjalorin Enciklopedik, në Durrës, më 9-12 qershor 2014; Miratoi

raportin e akademik Rexhep Ismajlit, për pjesëmarrjen e tij në Asamblenë e XV të përgjithshme të ALLEA-s, në Oslo, më 23-26 prill 2014; Miratoi raportin e akademik Rexhep Ismajlit për pjesëmarrjen e tij në Plenumin solemn të Akademisë Austriake të Shkencave, në Vjenë, më 15-19 maj 2014; Miratoi raportin e Lendita Pulës, Ali Cakës dhe Hilmi Zogjanit për qëndrimin e tyre në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë, më 23 korrik 2014; Miratoi raportin e Lendita Pulës, Ali Cakës, Hilmi Zogjanit dhe Dafina Kavajës për vijimin e trajnimit: "Menaxhimi i marrëdhënieve me publikun, roli i administratës dhe burimeve njerëzore në institucione qeveritare dhe ndërmarrje publike" në Budvë, më 31 korrik-3 gusht 2014; Miratoi raportin e Dr. Qëndrim Gashi, për pjesëmarrjen e tij në emër të ASHAK, në shkollën verore dhe konferencën: "Let's Face Chaos Through Nonlinear Dynamics" në Maribor, më 22 qershor - 3 korrik 2014; Miratoi raportin për qëndrimin e akademik Rexhep Ismajlit në Tiranë me rastin e pjesëmarrjes në ceremoninë e varrimit të akademik Shaban Demirajt më 31 gusht 2014; Mori vendim që akademikut të ndjerë Besim Bokshi t'i bëhet pagesa e shpërblimit pas vdekjes edhe për 6 muaj siç është e përcaktuar me Statutin e Akademisë, por bazuar në kërkesën e Ministrisë së Administratës Publike pagesa do të bëhet për të gjashtë muajt menjëherë, më tetor 2014; Mori vendim për caktimin e komisionit i cili do të bëjë evidencimin e gjendjes së kabinetit të akademikut të ndjerë Besim Bokshi, në

përbërje prej: Isuf Krasniqi, sekretar i përgjithshëm, Mehmet Kraja, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe znj. Lendita Pula, sekretare e Akademisë. U tha që komisioni në përbërje prej tre sekretarëve të jetë i përhershëm dhe të funksionojë sipas rasteve; Mori vendim për angazhimin e një dizajneri për përpunimin e dorëshkrimit të Pajazit Nushit: "Leksikon i psikologjisë". Punët dhe detyrat e punës, si dhe paushalli për dizajnerin do të përcaktohen me kontratë mbi vepër, si dhe mori vendim për pagesën e redaktorëve të fushave të Fjalorit Enciklopedik të Kosovës edhe për periudhën korrik-shtator 2014 në shumë prej 300.00 € për secilin.

10. Në mbledhjen e Kryesisë (XXXVII), mbajtur më 12 shtator Kryesia shqyrtoi raportin e Komisionit përzgjedhës lidhur me konkursin e rishpallur për plotësimin e vendit të punës Menaxher i prokurimit (Lendita Pula, Ali Caka, Vjollca Hykolli, Hilmi Zogjani, Agim Sheqiri) dhe duke përkrahur propozimin e Komisionit mori vendim që Furtuna Naka të pranohet në vendin e punës Menaxher i prokurimit.

Në kuadër të pikës së dytë të rendit të ditës Kryesia mori vendim për zëvendësimin e anëtarëve të Kryesisë dhe anëtarëve të Këshilli ndërademik për gjuhën shqipe (KNGJSH) si më poshtë:

I. Në vend të akademik Besim Bokshi, anëtar i Kryesisë dhe anëtar i KNGJSH caktohet anëtari korrespondent i ASHAK, Mehmet Halimi;

II. Në vend të anëtarit të KNGJSH

nga Maqedonia, prof. dr. Remzi Nesimi, i cili për shkaqe shëndetësore nuk mund të vazhdojë angazhimin, caktohet Prof. dr. Asllan Hamiti, profesor në Universitetin e Shkupit-Katedra e albanologjisë;

III. Prof. dr. Shkumbin Munishi, caktohet zëvendësues në punët e Këshillit, me të drejta të plota për akademik Idriz Ajetin, në rast të pamundësisë eventuale (për shkaqe shëndetësore) të pjesëmarrjes së akademik Ajetit;

Njëherësh Kryesia u njoftua nga M. Kraja se KNGJSH ka formuar edhe dy komisione:

- Komisioni për shqipen e shkruar në dokumente zyrtare;
- Komisioni shqipja standarde në median e shkruar dhe elektronike.

Kryesia po ashtu: mori vendim të paguhen paushallët për punët rreth katalogut për ekspozitën e akademik Tahir Emrës (z. Zeni Ballazhit t'i paguhet shuma bruto prej 200. 00€ për punën që ka bërë në cilësinë e dizajnerit grafik dhe z. Enver Bylykbashit t'i paguhet shuma bruto prej 200. 00€ për punimin e fotografive të katalogut), si dhe mori vendim për pagesën e kuotës së anëtarësisë së ASHAK-ut, në ALLEA, në bazë të faturave përkatëse.

11. Në mbledhjen e Kryesisë (XXXVIII), mbajtur më 20 nëntor, para fillimit të shqyrtimit të pikave të rendit të ditës Kryetari Islami njoftoi Kryesinë se akademikët Idriz Ajeti, Mark Krasniqi dhe Ali Aliu do të nderohen nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Bujar Nishani me titullin : “Nderi i

Kombit ”. Ceremonia solemne do të mbahet më 28 nëntor në Tiranë. Ai uroi akademikët dhe tha se me këtë rast nderohet edhe Akademia e jonë.

Më pas u shqyrtua shkalla e realizimit të Programit të punës për vitin 2014. U tha se deri më tani gjendja është e kënaqshme, por kjo nuk do të thotë se nuk ka vend për përmirësime dhe se deri në fund të vitit pritet të dalin edhe botimet e tjera.

Kryesia vendosi të thërrasë mbledhjen zgjedhore të Kuvendit të Akademisë për zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë, më 24 dhjetor 2014, ora 11:00, me këtë rend dite: miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXXII të Kuvendit, emërtimi i Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë, votimi për zgjedhjen e Kryesisë dhe shpallja e rezultateve të votimit; çështje vijuese, si dhe miratoi agjendën e aktiviteteve parazgjedhore si më poshtë:

“AGJENDA E AKTIVITETEVE PËR ZGJEDHJEN E KRYESISË SË ASHAK-ut

1. Mbledhja e Kryesisë së Akademisë, në të cilën thirret seanca zgjedhore e Kuvendit të Akademisë për zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë (së paku 30 ditë para mbajtjes së saj). Propozim: Kjo mbledhje të mbahet më 20. 11. 2014, ora 11:00;

2. Seanca zgjedhore e Kuvendit propozohet të mbahet më 24. 12. 2014, ora 11:00

3. MBLEDHJET E SEKSIONEVE – VOTIMI I (më 26. 11. 2014 deri 27. 11. 2014):

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, më 26. 11. 2014, ora 11:00;

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore, më 27. 11. 2014, ora 09:00;

III. Seksioni Shkencave të Natyrës, më 26. 11. 2014, ora 13:00;

IV. Seksioni Arteve, më 27. 11. 2014, ora 12:00.

3. Mbledhja e Kryesisë – njoftimi me pasqyrën (rezultatet) e votimit I, të cilën ua dërgon seksioneve për votim II (përfundimtar). Kjo mbledhje e Kryesisë propozohet të mbahet më 01. 12. 2014, ora 13:00.

4. MBLEDHJET E SEKSIONEVE – VOTIMI II (përfundimtar), (më 03. 12. 2014 deri 04. 12. 2014):

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, më 03. 12. 2014, ora 11:00;

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore, më 03. 12. 2014, ora 13:00;

III. Shkencave të Natyrës, më 04. 12. 2014, ora 11:00;

IV. Arteve, më 04. 12. 2014, ora 13:00.

VËREJTJE: Propozimet përfundimtare i dërgohen Kryesisë së paku 15 ditë para seancës zgjedhore të Kuvendit të Akademisë.”

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia miratoi raportet nga udhëtimet zyrtare si në vazhdim: raportin e punonjësve: Taulant Veseli, Burim Rexhepi dhe Rron Baraku për vijimin e trajnimit: “Arkivimi digjital, teknologjia e informacionit dhe komunikimit” në Budvë, më 25-28 shtator 2014; Raportin e akademik Rexhep Ismajli për qëndrimin e tij në Tiranë, më 1-2 tetor 2014; Raportin e Lendita Pulës, Vjollca Hykollit dhe Ali Cakës, për qëndrimin e tyre në Tiranë, në ASHSH, më 10-12 tetor 2014;

Raportin e Lendita Pulës, Hilmi Zogjanit dhe Ali Cakës, për qëndrimin e tyre në Tiranë, në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, më 30-31 tetor 2014; Raportin e akademik Rexhep Ismajlit për qëndrimin e tij në Vjenë dhe Muni, më 5-9 nëntor 2014; Raportin e qëndrimit të akademikëve Hivzi Islami, Ali Aliu, Rexhep Ismajli, Mehmet Kraja, Eqrem Basha dhe anëtarit korrespondent Jusuf Bajraktari në Tiranë, në Panairin e 17-të të librit Tirana 2014, më 13-17 nëntor 2014.

12. Në mbledhjen e saj (XXXIX), mbajtur më 1 dhjetor, Kryesia e Akademisë u njoftua me raportet me shkrim mbi rezultatet e zgjedhjeve në seksionet e Akademisë për kandidatët: për kryetar, nënkryetar dhe sekretar të përgjithshëm të ASHAK-ut dhe mbi zgjedhjet e sekretarëve të seksioneve.

U konstatua ky rezultat i zgjedhjeve, sipas seksioneve:

I. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

1. Për kryetar akademik Hivzi Islami,
2. Për nënkryetar akademik Pajazit Nushi,
3. Për sekretar të përgjithshëm akademik Isuf Krasniqi.

Akademik Eqrem Basha është zgjedhur sekretar i Seksionit.

II. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

1. Për kryetar akademik Hivzi Islami,
2. Për nënkryetar akademik Pajazit Nushi,
3. Për sekretar të përgjithshëm akademik Isuf Krasniqi.

Anëtar korrespondent Jusuf Bajraktari është zgjedhur sekretar i Seksionit.

III. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

1. Për kryetar akademik Hivzi Islami

2. Për nënkryetar akademik Minir Dushi.

3. Për sekretar të përgjithshëm akademik Isuf Krasniqi

Akademik Fejzullah Krasniqi është zgjedhur sekretar i Seksionit.

IV. SEKSIONI I ARTEVE

1. Për kryetar akademik Rauf Dhomi

2. Për nënkryetar akademik Zeqirja Ballata.

3. Për sekretar të përgjithshëm akademik Rauf Dhomi.

Anëtar korrespondent Luan Mulliqi është zgjedhur sekretar i Seksionit

Kryesia gjithashtu konstatoi se përcaktimi përfundimtar i kandidatëve për kryetar, nënkryetar dhe sekretar të përgjithshëm të ASHAK-ut do të bëhet sipas agjendës së miratuar nga Kryesia (më 20 nëntor 2011).

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia: mori vendim që pjesëmarrësve të Programit artistik, që do të organizohet me rastin e 80-vjetorit të lindjes së akademik Engjëll Berishës dhe anëtarit korrespondent Xhevdet Xhafa (i paraparë me Programin e punës për vitin 2014) t'u paguhen paushallët përkatëse, vlera e të cilave do të përcaktohet me kontratë mbi veprën; Miratoi raportin i z. Hilmi Zogjani, përgjegjës i Bibliotekës për qëndrimin e tij në Tiranë, më 11-17 nëntor, me rastin e pjesëmarrjes në Panairin e 17-të librit Tirana 2014, si dhe miratoi raportin e anëtares korrespondente Edi Shukriu për pjesëmarrjen e saj në Konferencën ndërkombëtare: Integrimi kulturor dhe

stabiliteti në Ballkan. Konferenca u organizua nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Maqedonisë, në Shkup, më 25-27 nëntor 2014.

13. Në mbledhjen e fundit (XL), mbajtur më 29 dhjetor, Kryesia pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse u mor me shqyrtimin e disa çështjeve. Ajo vendosi të shpallë konkursin publik për ndarjen e Shpërblimit mbështetës 2015, me kriter: Për kandidatin e moshës së re që ka arritur rezultate të rëndësishme në fushën e shkencës dhe të artit. U tha që konkursi të shpallet gjatë muajit janar 2014 në njërën prej gazetave ditore të vendit.

Kryesia po ashtu shqyrtoi raportin gjashtëmuor (korrik-dhjetor 2014) të projektit "Identifikimi i ndotësve të efluentëve të ujërave urbane dhe të industrisë dhe trajtimi i tyre" dhe e miratoi raportin në fjalë.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesia mori vendim për vazhdimin e angazhimit të prof. dr. Nebi Cakës deri më 30. 06. 2015 për punët në Qendrën Leksikografike Enciklopedike të ASHAK-ut; Ngriti Këshillin për bashkëpunim ndërkombëtar me këtë përbërje: akademik Rexhep Ismajli, kryetar, akademik Rexhep Ferri, anëtare korrespondente Edi Shukriu, anëtar korrespondent Salih Gashi dhe Prof. Dr. Qëndrim Gashi, anëtarë; Mori vendim që z. Enver Bylykbashi dhe znj. Suzana Mushkolaj t'u paguhet paushallë në vlerë prej 250. 00€. secilit, për punimin e fotografive të librit Gjelosh Gjokaj – Monografi; Mori vendim për pagimin e mbushjeve telefonike për Kryesinë dhe punonjësit e ASHAK.

III. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Projektet

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Është projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK. Gjatë pjesës së parë të vitit 2014 kanë vazhduar harmonizimet rreth fjalësit të zërave, i cili ka marrë formë përfundimtare, si dhe janë evidencuar bashkëpunëtorët e fushave që do të merren me hartimin e zërave. Edhe gjatë kësaj periudhe të gjitha punët janë realizuar sipas dinamikës së paraparë. Është hartuar udhëzuesi për autorët e teksteve dhe u është vënë në dispozicion të gjithë bashkëpunëtorëve. Hartimi i teksteve tashmë ka filluar dhe ai pritet të përfundojë deri nga mesi i vitit të ardhshëm.

2. Këshilli Ndërkademi për Gjuhën Shqipe. – Gjatë periudhës së parë të vitit të kaluar kryesimin e Këshillit e ka pasur ASHAK, ndërsa më vonë, sipas radhës, kryesimi i Këshillit sërish është bartur në Tiranë, tek ASHSH. Edhe përkundër vështirësive që janë shfaqur, falë insistimit të vazhdueshëm të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit nga ASHAK dhe të Seksionit të Gjuhësisë e Letërsisë, është arritur që disa grupe punuese ta përfundojnë punën dhe të dalin me propozime përkatëse. Gjatë kësaj periudhe, puna e Këshillit ka konsistuar kryesisht në shqyrtimin e gjetjeve dhe rezultateve të komisioneve të veçanta, të cilat tashmë e kanë përfunduar punën. Ndërkohë janë bërë disa ndryshime në përbërjen dhe kryesinë e Këshillit.

3. Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX. – Ka vazhduar puna në njësinë pilot për skanimin dhe digjitalizimin e dokumenteve. Janë skanuar 230 numra të revistës “Përparimi” të periudhës 1955-1991, si dhe është hartuar lista gjithëpërfshirëse e numrave të skanuar. Në proces është skanimi i të gjithë numrave të revistës “Jeta e re” nga viti 1949-1968. Gjithashtu vazhdon klasifikimi dhe përzgjedhja për skanim e teksteve të periudhës 1945-1968, duke bërë edhe digjitalizimin e tyre. Është konstatuar në Seksion se në masë të konsiderueshme kanë ngecur punët për ngritjen e kapaciteteve dhe aftësimin teknik dhe profesional të Qendrës Leksikografike Enciklopedike.

4. Vepra e plotë e Norbert Joklit. – Gjatë vitit 2014 ishte paraparë të bëhej gati për botim vëllimi i dytë i studimeve të Joklit: Linguistische-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen (Hulumtime linguistike-kulturohistorike në fushë të shqipes), i botuar më 1923. Përkthimi në shqip është bërë nga Anton Krajni në vitet '50 të shekullit XX, në gegërishten e atëhershme letrare. Në tekstin e përkthyer ka mungesa pjesësh, prandaj ka qenë e nevojshme të bëhet krahasimi i plotë me origjinalin. Puna rreth përgatitjes së kësaj vepre të Joklit ende nuk ka përfunduar.

Tubimet shkencore

1. Konferencë shkencore për studimet albanologjike. – Ishte paraparë që kjo konferencë të mbahej në bashkëpunim me Akademinë e

Shkencave të Shqipërisë, por mungesa e gatishmërisë së ASHSH për t'u përfshirë në këtë proces bashkëpunimi, ka bërë që përgatitjet për mbajtjen e këtij tubimi shkencor të mos fillojnë siç ishte paraparë. Ky aktivitet shkencor, nëse krijohet një frymë e re bashkëpunimi me ASHSH mbetet të realizohet vitin e ardhshëm.

2. Tryezë shkencore "Për kritikën letrare". - Seksioni i Gjuhësisë dhe Letërsisë i ASHAK e kishte përfshirë në programin e punës që më herët mbajtjen e një tryeze shkencore me këtë temë, si pjesë e bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Për shkaqet që u përmenden më sipër, as përgatitjet për këtë tryezë shkencore nuk arritën të bëheshin me kohë.

3. Tryezë shkencore me rastin e 200-vjetorit të lindjes së De Radës. – Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i ASHAK më 21 nëntor 2014 organizoi tryezën shkencore 'Në 200-vjetorin e lindjes së Jeronim De Radës'. Fjalën hyrëse e mbajti akademik Mehmet Kraja, ndërsa tryezën e drejtoi akademik Ali Aliu. Në tryezë morën pjesë të gjithë të ftuarit dhe çdo gjë u zhvillua sipas planit. Në dy seanca u paraqitën me kumtesa gjithsej 16 referues nga Kosova, Shqipëria, nga arbëreshët e Italisë dhe nga Maqedonia. Tryezë u vlerësua si një hap më tutje në ndriçimin e plotë të veprës së Jeronim De Radës.

Botimet

1. Vëllimi II i veprës së Norbert Joklit. – Sikundër u tha më lart, përgatitjet për botimin e veprës së dytë

të Joklit janë në proces. Bëhet fjalë për vëllimin Linguistische-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen (Hulumtime linguistike-kulturohistorike në fushë të shqipes), që do të botohet paralelisht në gjermanisht dhe në shqip, në një vëllim rreth 800 faqesh. Kopja në letër e përkthimit të veprës, bërë nga Anton Krajni, është marrë nga Qendra e Studimeve Albanologjike e Tiranës (Instituti i Gjuhësisë), ndërsa radhitja e tekstit, me plot shenja të veçanta diakritike dhe me shembuj greqisht, sllavisht dhe në alfabetet të tjera, përfshirë edhe verifikimin e përkthimit, ka kërkuar një punë të gjatë e të përkushtuar, e cila pritet të kurorëzohet me botimin e veprës në pjesën e parë të vitit 2015.

2. Besim Bokshi: "Varia". – Është vepra e fundit që përgatiti për botim akademik Besim Bokshi. Ajo doli nga shtypi pak ditë pasi ai u nda nga jeta. Përmban artikuj dhe studime, çështje albanistike, çështje ballkanistike, diskutime për shqipen standarde, si dhe fjalë të ndryshme përsëritëse e falënderuese. Në një vëllim prej 236 faqesh, e gjithë aparatit shkencor dhe indeksin, ky vëllim sikur jetësoi amanetin e fundit të studiuesit tonë të nderuar.

3. Françesko Altimari: "Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian". - Vepra është botuar dhe është përruar në mjediset e ASHAK, me praninë e autorit, midis dy seancave të tryezës për De Radën. Një fjalë rasti mbajti akademik Rexhep Ismajli, recensent i botimit. Prof. Altimari,

studiues i njohur nga arbëreshët e Italisë, profesor i Universitetit të Kozencës, është anëtar ynë i jashtëm, bashkëpunëtor i afërt në shumë projekte, botime dhe aktivitete të tjera të ASHAK-ut.

4. Rexhep Ismajli: “Studime për shqipen në rrethimin e saj ballkanik” (titull pune). – Libri parashihet të arrijë vëllimin prej rreth 30 tabakë autori. Do të përfshijë përmbajtje tematike për shqipen në raport me gjuhët e lashta të Ballkanit: vështrime për elementet e krahasueshme, për mundësitë e ndërlidhjeve të protoshqipes me to, gjithnjë në raport me diskutimet për lidhjet e shqipes me ndonjërin prej gjuhëve lashtoballkanike. Vepra është në proces të hartimit nga autori.

5. Revista “Studime” nr. 20. – Ka dalë nga shtypi në muajin shtator 2014, ndërsa Revista “Studime” 21 është finalizuar dhe është dërguar në shtyp para vitit të ri. Ka dalë prej shtypi në ditët e para të janarit, 2015. Është nga numrat më të vëllimshëm (rreth 500 fq.) Në të janë botuar të gjitha kumtesat e Tryezës shkencore me rastin e 200 vjetorit të lindjes së De Radës, artikuj e studime nga gjuhësia dhe nga letërsia, në shqip, frëngjisht, gjermanisht dhe italisht, in memoriam për akademik Besim Bokshin dhe akademik Shaban Demirajn, me shënime të plota biografike dhe bibliografike për ata, recensione dhe paraqitje botimesh të reja.

Me 16 gusht 2014 humbëm anëtarin e Seksionit tonë, akademik Besim Bokshin, ish kryetar i ASHAK-ut, studiues, artist dhe intelektual i shquar,

një nga albanologët më të mëdhenj të kohës sonë. Në mjediset e Akademisë u organizua një mbledhje komemorativë si dhe iu bënë homazhet e fundit në praninë e familjes, miqve, kolegëve dhe qytetarëve të shumtë. Për jetën dhe veprën e akademik Bokshit folën kryetari i ASHAK, akademik Hivzi Islami, akademik Rexhep Ismajli, si dhe nënkryetari i ASHAK, Pajazit Nushi në funeralin në Gjakovë.

Një ngjarje e veçantë që ka të bëjë me anëtarët e Seksionit, është dekorimi dhe titulli “Nderi i kombit” që iu nda dy anëtarëve të seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, akademikëve Idriz Ajeti dhe Ali Aliu, nga Presidenti i Shqipërisë, Bujar Nishani.

Sekretari i Seksionit

Akademik Eqrem Basha, d. v.

IV. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

Projektet

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Është projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK. Gjatë pjesës së parë të vitit 2014 kanë vazhduar harmonizimet rreth fjalësit të zërave, i cili ka marrë formë përfundimtare, si dhe janë evidencuar bashkëpunëtorët e fushave, të cilët do të merren me hartimin e zërave. Edhe gjatë kësaj periudhe të gjitha punët janë realizuar sipas dinamikës së paraparë. Ndërkohë, është hartuar udhëzuesi për autorët e teksteve dhe ai u është vënë në dispozicion të gjithë bashkëpunëtorëve.

Hartimi i teksteve tashmë ka filluar dhe ai pritet të përfundojë deri nga mesi i vitit të ardhshëm.

Tubimet shkencore

1. Konferencë shkencore “Lufta e Parë Botërore dhe çështja shqiptare”. - Konferenca është organizuar nga ASHAK, në bashkëpunim me Institutin e Historisë të Prishtinës dhe Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe ka qenë e përfshirë edhe në Protokollin e bashkëpunimit ASHSH-ASHAK 2013-2015. Konferenca është mbajtur me sukses më 19 shtator 2014. Në të është trajtuar me argumente të nevojshme shkencore çështja shqiptare në një luftë të karakterit botëror siç ishte Lufta e Parë Botërore, aq më tepër kur dihet se Shteti i Pavarur Shqiptar nuk kishte jetë më të gjatë se një vit e gjysmë. Në Konferencë kanë marrë pjesë specialistë të fushës dhe studiues nga të gjitha hapësirat shqiptare.

2. Tryezë shkencore “Arkeologjia në trojet shqiptare - sfidat dhe mundësitë”. – Tryeza është mbajtur më 19 qershor 2014 dhe ka përfunduar punimet me sukses. Tema e shtjelluar në këtë tryezë mundëson analizën e gjendjes aktuale të trashëgimisë arkeologjike në aspektin shkencor, profesional dhe legjislativ. Duke u paraparë si temë nismëtare, kjo nënkupton dhe hapje të dyerve për bashkëveprim të koordinuar midis institucioneve dhe individëve të fushës, gjithnjë duke pasur parasysh prioritetet shkencore dhe profesionale.

3. Tryeza shkencore “Perspektivat e komplementaritetit në zhvillimin

ekonomik ndërmjet Kosovës, Shqipërisë dhe regionit”. – Kjo tryezë pritet të mbahet në gjysmën e parë të vitit 2015.

Botime

1. Pajazit Nushi: “Leksikon i psikologjisë” – vëllimi I dhe II. - Është botuar.

2. Edi Shukriu: “Hyjnesha dardane”. – Është botuar.

3. Anton K. Berishaj: “Shoqëria pa shtet, studim socio-antropologjik”. – Është botuar.

4. Arsim Bajrami: “Historia e konstitucionalizmit shqiptar”. – Është botuar.

5. Ekrem Murtezai: “Hyrje konceptuale në filozofi” – Libri është në përfundim e sipër dhe pritet të botohet në fillim të vitit 2015.

6. Revista “Studime shoqërore” nr. 1. – Ka dalë botimi.

Ligjërata

1. Gjatë vitit më 17 prill anëtarja korrespondente Edi Shukriu ka mbajtur ligjëratën inauguruese me titull: “Tej imazhit arkeologjik - kosmologjia dardane”.

Sekretari i Seksionit

Anëtar korrespondent Jusuf Bajraktari, d.
v.

V. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Gjatë vitit 2014 Seksioni i Shkencave

të Natyrës ka punuar sipas Programit të punës të propozuar dhe të aprovuar nga Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Veprimtaria e Seksionit është mbështetur edhe në Protokollin e bashkëpunimit në mes të ASHAK dhe ASHSH.

Me qëllim të harmonizimit të aktiviteteve për realizimin e programit, Seksioni ka mbajtur disa mbledhje, në të cilat janë diskutuar dhe shqyrtuar problemet dhe veprimtaritë që i përkasin këtij Seksioni. Njëherësh është analizuar shkalla e realizimit të programit, si dhe janë propozuar veprimtari të tjera shkencore që do të parashihen edhe në programin e punës për vitin vijues.

Projekte

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Është projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK. Gjatë pjesës së parë të vitit 2014 kanë vazhduar harmonizimet rreth fjalësit të zërave, i cili ka marrë formë përfundimtare, si dhe janë evidencuar bashkëpunëtorët e fushave, të cilët do të merren me hartimin zërave. Edhe gjatë kësaj periudhe të gjitha punët janë realizuar sipas dinamikës së paraparë. Ndërkohë, është hartuar udhëzuesi për autorët e teksteve dhe ai u është vënë në dispozicion të gjithë bashkëpunëtorëve. Hartimi i teksteve tashmë ka filluar dhe ai pritet të përfundojë deri nga mesi i vitit të ardhshëm.

2. Klima dhe parametrat projektues për qytetet kryesore të Kosovës dhe të Shqipërisë. – Është ky projekt i përbashkët i Akademisë së Shkencave

dhe të Arteve të Kosovës dhe i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, i cili është përfshirë edhe në Protokollin e bashkëpunimit ndërmjet ASHAK dhe ASHSH për periudhën 2013-2015. Për vitin e parë të hulumtimeve, sa i përket pjesës që ka të bëjë me Kosovën, janë kryer pothuajse përfundimisht punët e planifikuara.

Në vitin në vijim, Seksioni i Shkencave të Natyrës do të intensifikojë bashkëpunimin me seksionin përkatës të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në mënyrë që të mos ketë ngecje në realizimin e tërësishëm të projektit.

3. Identifikimi i ndotësve të efluentëve të ujërave urbane dhe të industrisë dhe trajtimi i tyre - Ky projekt i takon kimisë së mjedisit dhe ka karakter hulumtues dhe aplikativ.

Projekti ka filluar të realizohet nga fillimi i vitit 2013 dhe lidhur me këtë udhëheqësi i projektit i ka paraqitur raporte të punës Seksionit të Shkencave të Natyrës çdo 6 muaj. Puna në këtë projekt tashmë ka përfunduar dhe bartësi i projektit e ka paraqitur edhe raportin për periudhën korrik-dhjetor 2014

4. Ndikimi i mbitensioneve atmosferike në sistemet elektroenergjetike të Kosovës - Në projekt do të trajtohet analiza e shkarkimeve atmosferike për disa linja transmetuese të sistemit elektroenergjetik të Kosovës në varësi nga densiteti dhe amplitudat e shkarkimeve atmosferike. Projekti ka përfunduar dhe është miratuar në mbledhjen e Seksionit.

Tubimet shkencore

1. “Ujitja në Kosovë”. - Në këtë tryezë shkencore të organizuar nga Seksioni i Shkencave të Natyrës të ASHAK, më 16. 10. 2014 është synuar që të identifikohen faktorët apo karakteristikat kryesore që ndikojnë në kushtet e ujitjes për vendin në tërësi, sipas pellgjeve lumore si njësi themelore e ekonomisë së ujërave dhe autoriteteve të pellgjeve si njësi për administrimin e ujërave. Është vlerësuar se diskutimi i kësaj teme në këtë tryezë shkencore ishte me rëndësi për shfrytëzimin racional dhe të efektshëm të tokës, rritjes së rendimenteve, stabilizimit të prodhimtarisë bujqësore, dhe zhvillimit ekonomik të vendit. Në bazë të analizës së kushteve pedogjene dhe topografisë së terrenit vlerësohet se në Kosovë ekzistojnë mundësitë për ujitjen e mbi 200. 000 ha ose rreth 50% të sipërfaqeve bujqësore. Janë të rralla vendet që disponojnë kushtet te tilla natyrore pedogjene, topografike dhe hidrike për zbatimin e ujitjes.

Kjo tryezë shkencore është karakterizuar me një përgatitje serioze shkencore dhe e njëjta ka zgjuar interesim të veçantë nga ekspertet e fushës përkatëse në Kosovë dhe Shqipëri.

2. “Gjuha e simetrive – një këndvështrim nga teoria e përfaqësimit dhe gjeometria”. - Edhe pse nuk ishte i paraparë në Programin e punës së Seksionit për vitin 2014, me propozim të Seksionit (iniciuar nga anëtari korrespondent Qamil Haxhibeqiri dhe Prof. dr. Qëndrim Gashi) dhe me

vendim të Kryesisë së Akademisë, ky tubim shkencor u mbajt në mjediset e Akademisë me dt. 11. 07. 2014. Në tubim përveç profesorëve të matematikës nga Kosova morën pjesë edhe profesorë të shquar nga vende të ndryshme të botës si: SHBA, Australi, Austri, Brazil, Gjermani.

Botime

1. Nexhat Daci, Majlinda Daci-Ajvazi: “Shkenca e mjedisit-zhvillim i qëndrueshëm”-Libri është botuar.

2. Fejzullah Krasniqi: “Termo–elektrocentralet e Kosovës”- Libri është botuar.

3. Qamil Haxhibeqiri: “Hapësirat metrike”-. Kjo vepër është botuar sipas planifikimit gjatë vitit 2014.

4. Ruzhdi Pllana: “Klima e Kosovës” - Vepra është në përfundim e sipër, pritet të shkojë së shpejti në shtyp.

5. Revista “Kërkime”21, është botuar.

Ligjërata

Gjatë vitit 2014, ligjërata inaguruese pas zgjedhjes anëtar korrespondent të ASHAK-ut, kanë mbajtur:

1. Anëtari korrespondent Salih Gashi, ka mbajtur ligjëratën inaguruese me titull: “Proceset membranore dhe zbatimi i tyre”. Ligjërata është mbajtur më 13. 02. 2014;

2. Anëtari korrespondent Arsim Morina ka mbajtur ligjëratën inaguruese me titull: “Shkenca e neurokirurgjisë sot”. Ligjërata është mbajtur më 28. 03. 2014.

Sekretari i Seksionit
Akademik Fejzullah Krasniqi, d. v.

VI. SEKSIONI I ARTEVE

Projekte

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës – Është projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK. Gjatë pjesës së parë të vitit 2014 kanë vazhduar harmonizimet rreth fjalësit të zërave, i cili ka marrë formë përfundimtare, si dhe janë evidencuar bashkëpunëtorët e fushave, të cilët do të merren me hartimin e zërave. Edhe gjatë kësaj periudhe të gjitha punët janë realizuar sipas dinamikës së paraparë. Ndërkohë, është hartuar udhëzuesi për autorët e teksteve dhe ai u është vënë në dispozicion të gjithë bashkëpunëtorëve. Hartimi i teksteve tashmë ka filluar dhe ai pritet të përfundojë deri nga mesi i vitit të ardhshëm.

Koncerte

Është realizuar Koncerti me vepra vokalo-pianistike të kompozitorëve të njohur shqiptarë dhe botërorë: W. A. Mozart, G. Verdi, Kozma Lara, Esat Rizvanolli, Fahri Beqiri, Zeqirja Ballata dhe Rauf Dhomi në interpretim të artistëve muzikorë shqiptarë: B. Llugiqi - soprano, Prishtinë; Armando Likaj - bariton, Tiranë; Lejla Haxhiu Pula - piano, Prishtinë; Etrita Ibrahim - piano, Tiranë; Çun Lajqi - aktor, Prishtinë.

Ekspozita

1. Ekspozita personale e akad. Tahir

Emrës – Nuk është mbajtur. U tha se ekspozita të mbahet më 6 mars 2015, në Gjakovë e pastaj pas dy javësh edhe në mjediset e ASHAK.

2. Ekspozita e anëtarit korrespondent Luan Mulliqi – Seksioni i Arteve i Akademisë ka paraparë që gjatë vitit 2014 të mbahet ekspozita e anëtarit korrespondent Luan Mulliqit. Mirëpo autori ka deklaruar se nuk mund ta mbajë ekspozitën pa u rregulluar (adaptuar) mjediset e Akademisë.

Botime

1. Zeqirja Ballata: “Me lirën muzikore ndër mote” (e paraqitur në Programin e punës me titull pune: “Gjurmëve të Muzës II”) – është rezultat i një përgatitjeje të gjatë mbi çështje studimore mbi krijimtarinë dhe krijuesit muzikorë shqiptarë nga aspekte të ndryshme ndriçimesh analitike gjinësh të ndryshme muzikore të autorëve shqiptarë, sidomos përgjatë dy shekujve të fundit. Libri pret të paraqesë interes për studiuesit e kësaj fushe si dhe për një rreth më të gjerë studiuesish nga fusha e krijimtarisë dhe veprimtarisë së muziktarëve mbarëshqiptarë. Dorëshkrimi është në përgatitje e sipër dhe pritet të dorëzohet për të vazhduar me procedurat përkatëse.

2. Rauf Dhomi: “Goca e Kaçanikut”. Duke ndjekur përvojat e deritanishme të botimeve të partiturave muzikore, Seksioni i Arteve ka paraparë për këtë vit botimin e kësaj opere. Bëhet fjalë për operën e parë të këtij autori, e cila më parë është realizuar me sukses.

Botimi i partiturës së plotë të kësaj opere do t'iu shërbejë njohjes më të gjerë të saj nga dirigjentë, interpretues vokalo-instrumentalë e skenikë, studiues të tjerë të ndryshëm, si dhe auditorë më të gjerë përdoruesish muzikorë. Vepra pritet të shkojë së shpejti në shtyp.

3. Monografia Gjelosh Gjokaj. - Libri ka dalë nga shtypi.

4. Përmbledhje romancash të kompozitorëve kosovarë, të zgjedhura nga akad. Engjëll Berisha e paraparë në Programin e punës për vitin 2013 është shtyrë për vitin 2014, por ende nuk ka arritur të përfundohet. Përshkruesi i notave, i caktuar nga Seksioni z. Valton Beqiri, nuk ka arritur ta kryejë punën dhe Seksioni propozon të caktohet përshkrues tjetër.

Aktivitete të tjera

Më 5 dhjetor 2014, u organizua një "Ekspozitë & Mbrëmje Muzikore-Poetike" në kuadër të shënimit të 80-vjetorit të lindjes së muzikologut Engjëll Berisha dhe piktorit Xhevdet Xhafa.

Mbrëmja muzikore-poetike u hap nga akademik Zeqirja Ballata. Akademik Rexhep Ferri mbajti fjalën e rastit për piktorin Xhevdet Xhafa ndërsa akademik Zeqirja Ballata mbajti fjalën e rastit për muzikologun Engjëll Berisha.

Aktori i njohur Çun Lajqi recitoi vargje poetike ndërsa pjesa muzikore përfshiu interpretimet e sopranos Sanije Matoshi, përcjellë në piano nga Lirika Pula Kasapolli. Mbrëmja muzikore-poetike u mbyll nga akademik Zeqirja Ballata.

Sekretari i Seksionit

Anëtar korrespondent Luan Mulliqi, d. v.

VII. SHËRBIMI ADMINISTRATIV, PROFESIONAL E TEKNIK

Shërbimi Administrativ, Profesional e Teknik i ASHAK, përgjegjës për ofrimin e shërbimeve administrative, profesionale e teknike u angazhua dhe punoi në realizimin e Programit të punës të Akademisë duke përpunuar dhe organizuar botimin e 22 titujve të librave.

SHAPT përkrahu profesionalisht drejtpërdrejt 9 aktivitete shkencore (konferenca, tubime, tryeza shkencore dhe ligjërata inauguruese) dhe 2 aktivitete artistike (koncert dhe ekspozitë me mbrëmje poetike).

SHAPT me përpjekje të vazhdueshme për ndërtimin dhe mbindërtimin e kapaciteteve lokale profesionale zbatoi metodat e përkrahjes së drejtpërdrejtë dhe të bashkëpunimit të ndërsjellët dhe të baraspeshuar me Akademikët, dhe me Operatorët ekonomikë të jashtëm duke e përmirësuar dhe ngritur cilësinë e shërbimeve administrative, profesionale e teknike me kosto shumë të ulët. Me zbatimin e qasjes ndryshe dhe politikave të tjera u kursyen mjetet financiare të shumta në botimin e librit dhe në material zyre.

SHAPT kontribuoi në përmbylljen me sukses të dizajnit dhe jetësimit të fazës së parë të standardizimit të botimit librit të ASHAK.

Ekipet profesionale të SHAPT kanë

përmbyllur fazën e parë të riorganizimit të bibliotekës. I gjithë fondi bibliotekar është zhvendosur për t'u parë gjendja reale dhe për të bërë një aranzhim të ri dhe për të kthyer në vend fondin e huazuar. Pas numërimit të fondit në të tri sallat e bibliotekës, është konstatuar se fondi i përgjithshëm i regjistruar nëpër rafte është rreth 9000 kopje. Fondit të bibliotekës i janë shtuar rreth 3000 njësi bibliotekare (libra, revista, vjetarë) kryesisht në gjuhën serbo-kroate. Është bërë riorganizimi i plotë i dollapëve të librit për vendosjen e fondit bibliotekar. Fondi i librit është pasuruar me rreth 200 tituj të rinj, që kryesisht janë blerë o këmbyer në panairët e librit.

SHAPT përgatiti specifikimet teknike të produkteve të veçanta të nevojshme për punën e ASHAK, e të cilat dhanë rezultate të shumta në profesionalizimin e mëtejshëm të administratës dhe të shërbimeve teknike.

SHAPT ka punësuar dy punonjës, znj Furtuna Naka Menaxhere të prokurimit dhe znj. Rejhane Ajeti Islami, Bibliotekare. Punonjëseve të reja u është mundësuar ngritja e duhur profesionale dhe pajisja me certifikatat e duhura.

SHAPT ka angazhuar një ekspert vendor të teknologjisë së informacionit për të zhvilluar programin e veçantë të katalogimit elektronik dhe menaxhimit të fondit të bibliotekës, i cili ka prezantuar fazën e parë të softuerit.

SHAPT ka vazhduar komunikimin me biblioteka të akademive të ndryshme dhe më institucione kosovare dhe të vendeve të ndryshme të rajonit dhe më gjerë për të zgjeruar bashkëpunim dhe këmbimin e botimeve dhe përvojave.

SHAPT ka arritur rezultate të kënaqshme në përhapjen dhe këmbimin e librit. Vlen të theksohet se pas shumë vitesh të ndërprerjes së komunikimit (për shkak të rrethanave në Kosovë dhe Bosnje) Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Bosnjë dhe Hercegovinës (Sarajevë) ka rifilluar t'i dërgojë Akademisë sonë disa nga botime e veta. Po ashtu edhe me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë (BKSH), në Tiranë të cilës u janë dërguar 425 kopje të botimeve të ASHAK (në veçanti botimet e viteve të mëhershme të cilat i kanë munguar për shkak të bashkëpunimit jo funksional). Po ashtu falë përhapjes së informacionit zyrtarë të Bibliotekës së Kongresit Amerikan kanë shprehur dëshirën që të kenë në fondin e tyre botimet e ASHAK. Atyre u është dërguar lista e botimeve me përkthim në gjuhën angleze. Ata tani janë në fazën e analizës së fondit të tyre në gjuhën shqipe dhe së shpejti do të kthejnë listën e botimeve të ASHAK, të cilat duan ti kenë. Po ashtu kanë premtuar se do t'i dërgojnë Bibliotekës sonë një numër botimesh të cilat i kanë në dispozicion për këmbim.

ASHAK gjatë 2014-ës ka marrë pjesë me botimet e veta në: Festivalin e Parë të Librit dhe Artit në Tiranë, në Panairin Prishtina 2014, në Panairin e 17-të të librit Tirana 2014, si dhe ka autorizuar Shtëpinë Botuese "Buzuku" nga Prishtina, si përfaqësuese e Shoqatës së Botuesve të Kosovës, që në Panairin Ndërkombëtar "Frankfurti 2014", të bëjë prezantimin e një numri të botimeve të ASHAK-ut.

Punonjësit e këtij Shërbimi gjatë

këtij viti kanë kryer trajnime nga fusha përkatëse e punës dhe me përkushtim janë angazhuar që me sukses t'i kryejnë punët administrative, profesionale, teknike dhe punët e tjera për nevojat e Akademisë.

1. Objektivat

Objektivat zhvillimore të arritura janë:

- Funksionalizimi i plotë i Njësisë së Prokurimit;
- Standardizimi i plotë i botimit të librit;
- Standardizimi i plotë i shkresave zyrtare;
- Shpërhapja e ideve të mira të hartimit të dokumenteve me qëllim të zhdukjes së gabimeve gjuhësore dhe terminologjike-administrative në dobi të sigurimit të qëndrueshmërisë profesionale;

- Përmirësimi i kushteve të punës;
- Funksionalizimi i Bibliotekës dhe depos së librit:

2. Sfidat

- Zhvillimi i vazhdueshëm drejt ngritjes dhe përparimit të kapaciteteve profesionale me këmbim përvojash që ka për qëllim përmirësimin dhe standardizimin e mëtejme të shërbimeve profesionale të shpejta dhe cilësore;
- Mbështetja e plotë në softuerët automatikë;
- Rritja e efektshmërisë dhe vëllimit të punës cilësore; dhe
- Zvogëlimi harxhimeve për shërbimet profesionale.

Sekretare e Akademisë

Lendita Pula, d. v.

RAPORTI I PERFORMANCËS FINANCIARE PËR VITIN 2014

Mjetet e ndara sipas Ligjit të Buxhetit të aprovuara për vitin 2014 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës janë 1,126,000.00€ si total në të gjitha kategoritë. Buxheti, sipas kategorive ekonomike, pasqyrohet në tabelat e mëposhtme:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investimet kapitale	Subvencionet dhe transferet	Gjithsej
636,000.00	480,000.00	10,000.00	0.00	0.00	1,126,000.00

Buxheti përfundimtar është i pasqyruar si në vijim:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investimet kapitale	Subvencionet dhe transferet	Gjithsej
732,670.32	411,500.00	5,000.00	0.00	0.00	1,149,170.32

Shih tabelat e mëposhtme me sqarime shtesë

BUXHETI I APROVUAR PËR 2014 ALOKIMI DHE REALIZIMI PËR PERIU DHËN JANAR - DHJETOR

Kategoritë ekonomike	Buxheti i aprovuar 2014 (A)	Alokimet Janar – dhjetor (B)	Realizimet Janar – dhjetor (C)	% (C/A)	% (C/B)
Paga dhe mëditje	636,000.00	732,670.32	732,670.32	115.20	100
Mallra dhe shërbime	480,000.00	411,500.00	405,910.64	84.60	98.64
Shpenzime komunale	10,000.00	5,000.00	3,514.76	35.10	70.30
Subvencionet dhe transferet	0.00				
Investimet kapitale	0.00				
Gjithsej	1,126,000.00	1,149,170.32	1,142,095.72	101.40	99.38

Vlera fillestare sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2014 ka qenë 1,126,000.00€. Ndryshimet në ndarjet buxhetore, krahasuar ato fillestare me ato finale, reflektojnë Vendimet e Qeverisë me nr. ref. 01/176 të datës 10/03/2014 (rritja prej 25% e pagave dhe mëditjeve) dhe asaj me nr. ref. 07/172 të datës 27/02/2014 (për kursimet prej 15% të shpenzimeve në kategorinë mallra e shërbime dhe shpenzime komunale).

Alokimet e mjeteve nga buxheti i konsoliduar i Kosovës sipas Planit të rrjedhës së parasë për periudhën Janar – Dhjetor 2014.

Mjetet e alokuara në periudhën janar – dhjetor kanë qenë në vlerë prej **1,149,170.32 €**, ose e shprehur në përqindje 102.06%, krahasuar me buxhetin e aprovuar.

Kategoritë ekonomike	Janar-Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej	(%)
Paga dhe mëditje	540,790.49	63,513.34	64,271.72	64,094.77	732,670.32	115
Mallra dhe shërbime	382,000.00	20,000.00	6,000.00	3,500.00	411,500.00	85.73
Shpenzime komunale	4,470.00	230.00	200.00	100.00	5,000.00	50
Subvencionet dhe transferet	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Investimet kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	927,260.49	83,743.34	70,471.72	67,694.77	1,149,170.32	102.06

Realizimi i buxhetit për periudhën Janar – dhjetor 2014

Realizimi i buxhetit në bazë të alokimit vjetor ka qenë **1,142,095.72 €**, shprehur në përqindje 99.38%.

Realizimi i buxhetit pasqyrohet si në vijim:

Kategoritë ekonomike	Alokimet Janar – dhjetor (A)	Realizimi Janar – dhjetor (B)	Ndryshimi (C)	% (B/A)
Paga dhe mëditje	732,670.32	732,670.32	0.00	100
Mallra dhe shërbime	411,500.00	405,910.64	5,589.36	98.64
Shpenzime komunale	5,000.00	3,514.76	1,485.24	70.30
Subvencionet dhe transferet	0.00	0.00	0.00	0.00
Investimet kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	1,149,170.32	1,142,095.72	7,074.60	99.38

Paga dhe mëditje

Mjetet e alokuara për paga dhe mëditje për vitin 2014 janë në vlerë prej **732,670.32€**, shprehur në përqindje 100%, ndërsa numri i aprovuar për personelin e ASHAK-ut është 55.

Alokimi

Kategoria ekonomike	Janar - Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej	%
Paga dhe mëditje	540,790.49	63,513.34	64,271.72	64,094.77	732,670.32	100

Realizimi

Muaji	Numri i punëtorëve	Buxheti	Alokimi (A)	Realizimi (B)	Ndryshimi (A-B)
Janar	55	53,000.00	53,000.00	51,450.69	1,549.31
Shkurt	55	53,000.00	53,000.00	51,258.78	1,741.22
Mars	55	53,000.00	53,000.00	52,352.15	647.85
Prill	55	53,000.00	59,696.96	63,635.34	-3,938.38
Maj	55	53,000.00	63,635.34	63,635.34	0.00
Qershor	55	53,000.00	64,094.77	64,094.77	0.00
Korrik	55	53,000.00	65,048.60	65,048.60	0.00
Gusht	55	53,000.00	65,801.48	65,801.48	0.00
Shtator	55	53,000.00	63,513.34	63,513.34	0.00
Tetor	55	53,000.00	63,513.34	63,513.34	0.00
Nëntor	55	53,000.00	64,271.72	64,271.72	0.00
Dhjetor	55	53,000.00	64,094.77	64,094.77	0.00
Gjithsej	55	636,000.00	732,670.32	732,670.32	0.00

Për zbatimin e Vendimit të Qeveritë për rritjen e pagave prej 25%, në kategorinë e pagave është alokuar shuma prej **96,670. 32 €**.

Mallra dhe shërbime

Mjetet e alokuar për mallra dhe shërbime për vitin 2014 janë në vlerë prej **411,500.00€**. Alokimi i mjeteve për mallra dhe shërbime për periudhën janar-dhjetor 2014 përbën 85.73% të buxhetit të aprovuar.

Alokimi

Kategoria ekonomike	Janar-Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej	%
Mallra dhe shërbime	382,000.00	20,000.00	6,000.00	3,500.00	411,500.00	85.73

Realizimi

Nr.	Muaji	Buxheti	Alokimi (A)	Realizimi (B)	Ndryshimi (A-B)
1	Janar	53,000.00	53,000.00	7,314.54	45,685.46
2	Shkurt	50,000.00	50,000.00	10,564.10	39,435.90
3	Mars	57,000.00	57,000.00	29,708.11	27,291.89
4	Prill	80,000.00	60,000.00	32,398.60	27,601.40
5	Maj	43,000.00	33,000.00	16,928.86	16,071.14
6	Qershor	39,000.00	39,000.00	36,594.97	2,405.03
7	Korrik	40,000.00	32,000.00	47,285.98	(15,285.98)
8	Gusht	38,000.00	28,000.00	7,109.10	20,890.90
9	Shtator	40,000.00	30,000.00	36,068.91	(6,068.91)
10	Tetor	30,000.00	20,000.00	39,423.23	(19,423.23)
11	Nëntor	6,000.00	6,000.00	52,971.13	(46,971.13)
12	Dhjetor	4,000.00	3,500.00	89,543.11	(86,043.11)
	Total	480,000.00	411,500.00	405,910.64	5,589.36

Në bazë të Vendimit të Qeverisë Nr. 07/172 dt. 27.02.2014 ka pasur shkurtrim buxhetor në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në shumë prej **68,500.00€** ose në nivel prej 15% të buxhetit të aprovuar.

Shpenzimet për shërbime komunale

Buxheti për shpenzime komunale për vitin 2014 është **10,000.00 €**. Alokimi i mjeteve për shpenzime komunale për periudhën janar-dhjetor 2014 përbën 50 % të buxhetit të aprovuar.

Alokimi

Kategoria ekonomike	Janar-Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali	%
Shpenzime komunale	4,470.00	230.00	200.00	100.00	5,000.00	100

Realizimi 1

Nr.	Muaji	Buxheti	Alokimi (A)	Realizimi (B)	Ndryshimi (A-B)
1	Janar	1,100.00	1,100.00	175.15	924.85
2	Shkurt	1,000.00	1,000.00	368.69	631.31
3	Mars	1,000.00	1,000.00	287.21	712.79
4	Prill	900.00	300.00	305.90	(5.90)
5	Maj	1000.00	220.00	316.44	(96.44)
6	Qershor	1000.00	190.00	290.22	(100.22)
7	Korrik	500.00	210.00	289.52	(79.52)
8	Gusht	1000.00	200.00	0.0000	200.00
9	Shtator	500.00	250.00	545.87	(295.87)
10	Tetor	1000.00	230.00	306.79	(76.79)
11	Nëntor	500.00	200.00	000.00	200.00
12	Dhjetor	500.00	100.00	628.97	(528.97)
	Gjithsej	10,000.00	5,000.00	3,514.76	1,485.24

Në bazë të Vendimit të Qeverisë Nr. 07/172 dt. 27. 02. 2014, ka pasur kursime prej 15% të shpenzimeve në kategorinë mallra dhe shërbime përfshirë edhe shpenzimet për shërbime komunale (5,000. 00 €).

Donacionet – grantet e donatorëve**Alokimi**

Emri i donatorëve	Totali i grantit	Alokimi	Realizimi	Mjetet e lira	%
Salbatring International	16,022.32	16,022.32	2,000.00	14,022.32	12.48
Eng Office	3,000.00	3,000.00	3,000.00	0.000	100
Marigona Rezidence	3,000.00	3,000.00	0.00000	3,000.00	0.00
Gjithsej	22,022.32	22,022.32	5,000.00	17,022.32	22.70

Granti në vlerë prej 16,022.32€ i pranuar prej Salbatring International si Projekt i veçantë, është i bartur nga vitet paraprake dhe është shpenzuar në vlerën 2,000. 00 sipas marrëveshjes me donatorin për stimulimin e të rinjve nga

¹ Shpenzimet e komunaleve nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës janë bërë vetëm në kodin e telefonisë fikse, shpenzimet e rrymës dhe ato të mbeturinave i mbulon Ministria e Administratës Publike.

lëmi i shkencës, si dhe nuk ka pasur kërkesa të reja për shpenzimin e këtij granti përveç vlerës së shënuar në tabelë, kurse granti në vlerë prej 3,000. 00€ është grand i ri i pranuar në fillim të vitit nga Eng Office Gjilan i cili është shpenzuar konform marrëveshjes me donatorin, si dhe granti i pranuar nga Marigona Rezidence është donacion i dedikuar për vitin 2015 për ndarjen e “Shpërblimit mbështetës 2015”.

Realizimi i buxhetit në shkallën 96.40% tregon se është një performancë e mirë.

PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2015



I. KRYESIA E AKADEMISË
Botimet
40 VJET TË AKADEMISË SË
SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË
KOSOVËS

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i
Letërsisë

I. Projektet

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK. Deri më tani janë përfunduar të gjitha punët që kanë të bëjnë me fjalësin e zërave, i cili tashmë është publikuar dhe në të janë inkorporuar vërejtjet dhe sugjerimet e diskutimit publik. Pas përcaktimit të madhësisë së zërave nga Redaksia Qendrore në bashkëpunim me redaksitë e fushave, ka filluar hartimi i teksteve të zërave. Në këtë proces janë angazhuar, ose janë në angazhim e sipër rreth 300 bashkëpunëtorë. Gjatë vitit 2015 pritet të realizohet në tërësi shkrimi i teksteve të zërave dhe, paralelisht me këtë, të avancojë edhe redaktimi i tyre. Për realizimin e suksesshëm të kësaj faze finale të punës rreth Fjalorit Enciklopedik, gjatë vitit 2015 do të jetë e nevojshme të themelohet një redaksi funksionale, e cila do të merrte përsipër punët redaktoriale rreth teksteve të Fjalorit.

2. Këshilli Ndërademik për Gjuhën Shqipe. – Deri në pranverë të vitit 2014, sipas marrëveshjes, ASHAK ka pasur radhën e kryesimit të Këshillit Ndërademik për Gjuhën Shqipe, ndërsa në dy vitet e ardhshme

mbledhjet dhe takimet e Këshillit do të zhvendosen në Tiranë. Edhe gjatë vitit 2015, ASHAK do të vazhdojë të participojë në punën e Këshillit, duke u angazhuar që grupeve të punës dhe anëtarëve të Këshillit t'u krijojë kushte optimale për punë kreative dhe sa më frytdhënëse. Si edhe deri më tani, Akademia do të sigurojë tërë logjistikën e nevojshme për anëtarët e Këshillit dhe grupet e punës, ndërkohë që do t'i përmbahet edhe më tej parimit të pavarësisë së plotë Këshillit në vendimet dhe punën e tij profesionale.

3. Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX. – Projekti do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2015. Sikundër është bërë e ditur edhe më parë, me këtë projekt synohet studimi i tërësisë së zhvillimeve gjuhësore në Kosovë gjatë shekullit XX. Deri më tani njësia pilot pranë Akademisë ka bërë skanimin dhe digjitalizimin e dokumenteve të revistave të botuara në Kosovë ("Përparimi", "Jeta e re"), si dhe ka hartuar listën gjithëpërfshirëse të numrave të skanuar. Pas skanimit të lëndës leksikografike, synohet që në vijim të bëhet një botim përmbledhës i fjalorit të gjuhës shqipe në Kosovë para Kongresit të Drejtshkrimin (1972), i cili ka sjellë ndryshime të ndjeshme në gjuhën e shkruar te ne. Paralelisht me punët konkrete që do të kryhen rreth realizimit të projektit, do të punohet edhe për ngritjen e kapaciteteve dhe aftësimin teknik dhe profesional të Qendrës Leksikografike Enciklopedike.

4. Vepra e plotë e Norbert Joklit. – Pas botimit të librit të parë të veprës së plotë të Norbert Joklit, puna do të

vazhdojë edhe më tej në përgatitjen dhe botimin e veprave të tjera të albanologut të shquar austriak. Vonesat në finalizimin e këtij projekti janë të natyrës objektive. Gjatë vitit 2015 parashihet të bëhen gati për botim vëllimi i dytë i studimeve të Joklit: “Hulumtime lingvistike-kulturohistorike në fushë të shqipes”, i botuar më 1923. Përkthimi në shqip është bërë nga Anton Krajni në vitet ’50 të shekullit XX, në gegërishten e atëhershme letrare. Në tekstin e përkthyer shpesh ka mungesa pjesësh, prandaj është paraqitur nevoja të bëhet krahasimi i plotë me origjinalin. Në këtë botim, pranë tekstit shqip, do të jepet edhe teksti gjermanisht i skanuar me pagjinimin origjinal, në mënyrë që specialistët të kenë mundësi t’i referohen burimit. Një punë e këtillë rreth përgatitjes së këtij botimi, ka shkaktuar edhe vonesa në përfundimin e këtij projekti. Përgatitja për shtyp e vëllimit të dytë pritet gjatë vitit 2015, ndërkaq përgatitja e vëllimi III të veprës së Joklit varet nga procesi i përkthimit.

II. Tubimet shkencore

1. Studimet albanologjike në Amerikë. – Shtetet e Bashkuara të Amerikës sot janë bërë një qendër shumë e rëndësishme e studimeve albanologjike. Atje kanë vepruar dhe veprojnë albanologë të shquar, kontributet shkencore të të cilëve janë jashtëzakonisht me vlerë për filologjinë dhe për studimet shqiptare në përgjithësi. Njohja më e gjerë dhe afirmimi i këtyre studimeve në hapësirën shqiptare paraqet interes për

shkencën e albanologjisë, prandaj mbajtja e një tryeze shkencore, në të cilën do të prezantoheshin autorët dhe kontributet e tyre në këtë fushë paraqitet me rëndësi për shkencën dhe Akademinë. Tryeza shkencore parashihet të mbahet në muajt e parë të vitit 2015.

2. Zhvillimet aktuale në letërsinë e Kosovës. – Tryezë shkencore, në të cilën do të shqyrtohen zhvillimeve bashkëkohore në këtë pjesë të letërsisë shqipe. Realiteti i ri politik, i krijuar pas vitit 1999, ka pasur ndikim të madh edhe në zhvillimet brenda letërsisë së Kosovës, e cila tashmë ka filluar procesin e ridimensionimit në kuadër të letërsisë shqipe, si tërësi integrale e një kulture kombëtare. Rreth këtyre proceseve letrare janë duke u zhvilluar diskutime të ndryshme, që kanë shpërfaqur diferenca konceptesh dhe pikëpamjesh. Një tryezë shkencore për këtë çështje, e organizuar nga Akademia, do të ishte me interes për studiuesit e letërsisë dhe supozon një pjesëmarrje aktive të autorëve të shquar të këtyre studimeve nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia.

3. Gjuha standarde në vendimet e Këshillit Ndërakademik. – Gjatë vitit 2015 pritet të përfundojë punën Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe. Në mbyllje të punës së këtij Këshilli, do të organizohet një tryezë shkencore, me një pjesëmarrje të gjerë studiuesve të gjuhës, në të cilën do të analizohen rezultatet e punës së Këshillit, duke ua bërë një analizë shkencore vendimeve të marra në fushat përkatëse, në drejtshkrim, leksik, morfologji dhe

sintaksë. Organizimi i një tryeze me këtë temë pritet të zgjojë interesimin e gjerë të studiuesve të gjuhës të mbarë hapësirës shqiptare, por edhe të opinionit të gjerë, duke pasur në dijeni se puna e Këshillit Ndërkademiç rreth standardit gjuhësor ka qenë objekt i diskutimeve dhe polemikave të shumta.

III. Botimet

1. Rexhep Ismajli: “Studime për shqipen në rrethimin e saj ballkanik” (titull pune). – Libri ishte paraparë të botohej gjatë vitit 2014, por për shkak të vonesës nga autori, mbetet të botohet në vitin vijues. Autori ka paraparë që vepra të arrijë vëllimin prej 30 tabakësh autori. Do të përfshijë përmbajtje tematike për shqipen në raport me gjuhët e lashta të Ballkanit: vështrime për elementet e krahasueshme, për mundësitë e ndërlidhjeve të protoshqipes me to, gjithnjë në raport me diskutimet për lidhjet e shqipes me ndonjërin prej gjuhëve lashtoballkanike. Një vend të veçantë në këtë libër do të zënë raportet e rishikuara të shqipes me rumanishten, krahasimet për ngjashmëritë, por edhe dallimet midis dy gjuhëve, duke diskutuar tezat e autorëve rumunë dhe shqiptarë. Në libër gjithashtu do të zënë vend diskutimet për çështjen e zhvillimit të shqipes dialektore në raport me gjuhët e Ballkanit, sidomos sllave e rumune etj.

2. Dr. Skënder Gashi: “Kërkime onomastike-historike për minoritete të shuara e aktuale të Kosovës”. – Kanë përfunduar të gjitha procedurat për botimin e kësaj vepre. Dorëshkrimi

përmban një trajtesë për bashkëjetesën sase-shqiptare në shekujt XIV-XVI dhe disa gjurmë onomastike e leksikore sase në Kosovë; pastaj trajtesën për bashkëjetesën e shqiptarëve dhe të raguzasve në Kosovë e në regjionin e Toplicës në dritën e disa burimeve raguzase të shekujve XIV-XV; një kontribut për historinë e hebrenjve në hapësirën etnolinguistike të shqiptarëve; një studim për një histori të romëve, hashkalinjve dhe „egjiptasve” në Kosovë; trajtesën për prejardhjen e goranëve në dritën e emrave të vëllazërive e të vendeve, si dhe disa mendime rreth dy minoriteteve mesjetare të shuara të Kosovës, kumanët e jurukët.

3. Revista “Studime” nr. 21/22. – Numri vijues të revistës “Studime”, të cilën e boton Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë së ASHAK, parashihet të jetë dynamësh. Sikundër edhe deri më tash, revista do të botojë kontribute shkencore të autorëve të ndryshëm nga fusha e studimeve gjuhësore dhe letrare. Parashihet që ky numër i revistës të botojë kontributet nga dy tryeza shkencore: trajtesat nga tryeza kushtuar 200-vjetorit të lindjes së De Radës, që do të mbahet gjatë vitit 2014, si dhe trajtesat nga tryeza shkencore për studimet albanistike në Amerikë, që parashihet të mbahet në muajt e parë të vitit 2015.

Sekretari i Seksionit
Akademik Mehmet Kraja, d. v.

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore

I. Projektet

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK. Deri më tani janë përfunduar të gjitha punët që kanë të bëjnë me fjalësin e zërave, i cili tashmë është publikuar dhe në të janë inkorporuar vërejtjet dhe sugjerimet e diskutimit publik. Pas përcaktimit të madhësisë së zërave nga Redaksia Qendrore në bashkëpunim me redaksitë e fushave, ka filluar hartimi i teksteve të zërave. Në këtë proces janë angazhuar, ose janë në angazhim e sipër rreth 300 bashkëpunëtorë. Gjatë vitit 2015 pritet të realizohet në tërësi shkrimi i teksteve të zërave dhe, paralelisht me këtë, të avancojë edhe redaktimi i tyre. Për realizimin e suksesshëm të kësaj faze finale të punës rreth Fjalorit Enciklopedik, gjatë vitit 2015 do të jetë e nevojshme të themelohet një redaksi funksionale, e cila do të merrte përsipër punët redaktoriale rreth teksteve të Fjalorit.

II. Tubimet shkencore

1. “Zhvillimi ekonomik midis Kosovës, Shqipërisë dhe rajonit: perspektivat e komplementaritetit”.

Problemet e zhvillimit të strukturës ekonomike të Kosovës shpijnë në domosdoshmërinë e lidhjeve më të forta ekonomike me trojet shqiptare dhe vendet fqinje. Këto lidhje për Republikën e Kosovës kanë rendësi jo vetëm ekonomike, por edhe politike, sepse nëpërmjet tyre do të arriheshin

objektivat më të gjera sociopolitike. Një tryezë me këtë temë do të tubonte disa studiues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Presheva e Bujanovci dhe nga Mali i Zi, për të prezantuar pikëpamjet e tyre lidhur me kushtet dhe me mundësitë e integritimit dhe rritjes së komplementaritetit të ekonomive të këtyre vendeve dhe rajonit.

III. Botimet

1. Muhamet Mufaku: “Nga historia e shqiptarëve të Egjiptit”

Gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare Kajroja ishte një ndër qendrat e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare pasi që aty u formua me kohë kolonia shqiptare, e cila u bë një ndër kolonitë kryesore në botë bashkë me atë të Stambollit, Sofjes, Bukureshtit etj. Mjafton të përmendim se aty u botua “Bleta shqiptare” e Thimi Mitkos më 1878, aty u paraqitën me krijimet e tyre Çajupi, Filip Shiroka e të tjerë, aty u botuan shumë gazeta në gjuhën shqipe.

Por, megjithatë, kjo koloni është një aspekt i pranishëm shqiptarë në këtë vend kyç të Lindjes së Mesme, meqë prania e shqiptarëve aty ka rrënjë qysh në shek. XV. Në atë kohë u paraqitën në krye të shtetit memluk, që sundonte Lindjen e Mesme gjatë viteve 1260-1517, dy sulltanë “arnautë” që lanë vepra të ndryshme në Egjipt, kurse me pushtimin osman më 1517 u paraqitën në administratën e re ca figura shqiptare si valinj e kadinj e një ndër ta ishte Sinan pasha i Topojanit, i cili la shumë monumente në Kajro e Aleksandri.

Megjithatë, figura shqiptare që ndikoi më së shumti në historinë e këtij vendi ishte pa dyshim Mehmet Ali pasha që sundoi Egjiptin gjatë viteve 1805-1848, kurse dinastia e tij e sundoi atë vend deri më 1952. Mehmet Aliu përmendet në Egjipt me respekt si “themelues i Egjiptit modern” dhe u nderua me të madhe gjatë gjithë vitit 2005 me rastin e 200-vjetorit të arritjes në pushtet.

Ndonëse për Mehmet Aliun e koloninë shqiptare u botuan ca shkrime nëpër gazeta me ndonjë botim aty këtu, tani është koha për një monografi shkencore që merret me praninë e shqiptarëve në Egjipt në baza shkencore.

Kjo monografi e propozuar do të bazohet në burimet egjiptiane të kohës (shek. XV-XVI), si dhe në dokumentet e periudhës osmane, në dokumentet e arkivit egjiptian gjatë sundimit të dinastisë së Mehmet Aliut, si dhe në shtypin e kohës.

Monografia do të ketë rreth 250 faqe dhe mund të kryhet deri në verë të vitit 2015.

Struktura e botimit: 1. Prania e shqiptarëve – arnautëve në mesjetën e vonshme (shek. XV); 2. Prania e shqiptarëve në Egjipt gjatë shekullit të parë të sundimit osman; 3. Sinan pasha dhe monumentet e tij në Egjiptin e shek. XVI; 4. Shqiptarët në Egjipt në prag të ardhjes së Mehmet Aliut; 5. Roli i Mehmet Aliut në historinë e Egjiptit; 6. Formimi i kolonisë shqiptare të Egjiptit; 7. Teqja bektashiane shqiptare në Kajro; 8. Dinastia e Mehmet Aliut 1849-1953.

2. Muhamedin Kullashi: “Dy gjenealogji të modernitetit”

Brenda filozofisë bashkëkohore franceze dhe asaj gjermane në veçanti janë problematizuar të kuptuarit dhe domethënia e modernitetit përmes trajtimit kritik të koncepteve të subjektit, arsyes dhe historisë. Filozofia franceze e gjysmës së dytë të shekullit njëzet shënohet dhe hapet me mendimin filozofik të Sartreit, me veprën “Qeniesimi dhe koha” (1943), “Kritika e mendjes dialektike” (1961), me veprat e Gaston Bachelard mbi shkencat dhe poezinë “Uji dhe ëndrrat - ese për imagjinatën e materies”, 1941; me ato të Merleau-Ponty-së mbi fenomenologjinë e perceptimit, mbi të dukshmen e të padukshmen, me antropologjinë e Levy-Strauss për strukturat e fafesisë të shoqëritë “primitive” dhe “Mendimin e egër”, me Althusserin që ndërton një marksizëm strukturalist, me gjenealogjinë e Foucault-së, me dekonstrukcionin e Derrida-së, me filozofinë nomade të Deleuze, me hermeneutikën e Paul Ricoeur, me mendimin postmodern të Lyotardit për fundin e “rrëfimeve të mëdha” për historinë e njeriut, me psikanalizën e Lacanit, me filozofinë politike të Calude Lefort dhe me estetikën e Rancière etj. Është fjala për një fenomen të shpërthimit krijues të mendimit origjinal filozofik, që ka dimensionin e mirëfilltë universal, ngase u flet njerëzve si të tillë, ndonëse është zhvilluar brenda një vendi-populli dhe është artikuluar përmes një gjuhe të veçantë, gjuhës frënge, një fenomen i universales konkrete, siç do thoshte Sartrei.

Ky mendim filozofik bashkëthuret me letërsinë, me gjuhësinë e antropologjinë, me kritikën sociale e

letrare, me psikanalizën. Themi ky “mendim”, ndonëse është fjala për konceptione të mëvetëshme, të ndryshme njëra nga tjetra, që janë zhvilluar edhe përmes konfrontimit të njëjës me tjetrën. Megjithatë, origjinaliteti dhe diversiteti i këtyre veprave të fuqishme filozofike është shpjeguar shpesh nga filozofët francezë edhe me ekzistimin e dy rrymave-burime kryesore brenda filozofisë franceze të shekullit XX: me filozofinë e Bergsonit për evolucionin krijues dhe elanin jetësor, në njëjën anë, dhe me filozofinë e shkencave të Léon Brunschvicg. Është fjala për dallimin midis filozofisë së jetës dhe një koncepti që ka si të përbashkët, megjithatë, çështjen e subjektit, si trup i gjallë dhe si krijues i koncepteve. Çështja e subjektit do të jetë çështje qendrore si për ekzistencializmin e Sartrrit dhe fenomenologjinë e Merlau-Pointy-së, po aq edhe për dekonstruktivizmin e Derridasë e gjenealogjinë e Foucaultës, për marksizmin e Althusserit “Historia si proces pa subjekt” apo psikanalizën e Lacanit. Të gjithë këta mendimtarë, ndërkaq, kanë pikëpamje shumë të ndryshme për subjektin, kështu që kjo temë është temë e përplasjeve të tyre në shkrimet e tyre.

Çështja e subjektit, ndasitë dhe konfrontimet brenda rrymave filozofike bashkëkohore vazhdojnë të mbajnë gjurmën e ndikimit të Descartesit, nga fillimi i modernitetit filozofik. Subjekti i modernitetit shpërfaqet në plotninë e tij substanciale, si vetëdije për veten, transparente ndaj vetes. Edhe konceptet moderne mbi arsyen (ratio) dhe historinë, mbi politikën dhe

pushtetin do të nxisin përsiatje e problematizime sa brenda filozofisë bashkëkohore franceze, aq edhe brenda filozofisë gjermane.

Originaliteti i konceptioneve filozofike të mendimtarëve bashkëkohorë francezë, është ngjizur përmes ndikimit të thellë të filozofisë gjermane, qoftë asaj klasike apo të kësaj bashkëkohore. Foucault, Derrida apo Jean-Luc Nancy përkujtojnë shpesh në shkrimet e tyre se problemet kyçe të filozofisë bashkëkohore franceze janë zhvilluar përmes një dialogu intensiv e shumështrësor me filozofinë gjermane, duke filluar nga ajo e Kantit e deri te temat e Husserlit, Heideggerit dhe Habermasit. Edhe transformimet që kanë pësuar konceptet filozofike të mendimtarëve francezë gjatë disa dekadave, mund të shpjegohen edhe në saje të formave të dialogut që ata kanë zhvilluar me këta filozofë gjerman, si i kanë përvetësuar pikëshikimet e tyre, në ç’drejtimit ka shkuar kritika e disa koncepteve të tyre (transcendentalja, “dasein”, subjekti, koha, historia etj.).

Në këtë libër ne do të tematizojmë kritikën e modernitetit të këta filozofë bashkëkohorë, duke u përqendruar te çështjet e subjektit dhe arsyes, si dhe të historisë, politikës e pushtetit.

Në shqyrtimet tona do të veçojmë konceptet filozofike mbi historinë e politikën të Foucault dhe Leforti, në njëjën anë, dhe te ato të Habermasit e Hannah Arendt, në anën tjetër. Do të orvatemi të vejmë në pah se në ç’mënyrë dy gjenealogji të ndryshme të modernitetit i kanë shtyrë këta mendimtarë francezë e gjermanë të

sajojnë konceptione rrënjësisht të ndryshme mbi historinë, politikën dhe pushtetin, në ç'mënyrë këto tema kyçe të filozofisë bashkëkohore kanë qenë të ndërmjetësuar me interpretimet e tyre të ndryshme të modernitetit. Kësisoj, fjala vjen, Lefort do të shpjegojë modernitetin si epokë ku sajohet një konfiguracion i veçantë midis pushtetit, ligjit dhe dijes, i cili cilësohet me sintagmën “zbulimi demokratik”, dhe me konceptet e “çtrupëzimit” dhe “shpërbërjes”, kurse Foucault me sintagmën “zbulimi i pushteteve disiplinore” dhe “biopolitika”, duke i shpërfillur tërësisht temat e demokracisë dhe totalitarizmit, që ishin thelbësore për Arendt. Habermas, ndërkaq do të zhvillojë konceptin e vet mbi modernitetin edhe përmes kritikës së koncepteve të Foucaultsë.

3. Hivzi Islami dhe Arsim Ejupi: “Popullsia dhe vendbanimet shqiptare në Luginën e Preshevës”.

Lugina e Preshevës si entitet i veçantë etniko-politik shumë pak është studiuar. Edhe kur janë prekur disa aspekte të studimit të këtij territori, ato janë bërë në kuadër të regjioneve më të mëdha, si të Anamoravës, të Pçinjës, të Vranjës, të Kumanovës etj. Studimet për popullsinë dhe vendbanimet shqiptare nga autorët shqiptarë mungonin krejtësisht. Botimi që po e paraqesim është i pari i këtij lloji për dinamikën dhe strukturën e popullsinë dhe vendbanimet, tipologjinë dhe proceset transformuese të tyre për këtë pjesë të trojeve tona, ku shqiptarët kanë një shtrirje territorialisht kompakte, me një

shkëputje të vogël, meqë komuna e Medvegjës lidhet me rajonin e Gallapit në Kosovë.

Në studimin “Popullsia dhe vendbanimet shqiptare në Luginën e Preshevës”, autorët punojnë një kohë relativisht të gjatë. Mbi bazë të të dhënave dhe fakteve, analizohet dhe shpjegohet ndikimi i një kompleksi rrethanash në krijimin e një tabloje karakteristike demografike të popullata shqiptare, që shtron nevojën e domosdoshme për hulumtimin e të gjitha aspekteve të zhvillimit demografik të shqiptarëve në Luginë dhe gjetiu. Popullata shqiptare e Luginës paraqet transicionin e fundit demografik në Evropë dhe specificiteti i gjendjes demografike përshkohej para së gjithash nga normat e larta të natalitetit dhe vdekshmërisë, ku baraspesha demografike midis lindjes dhe shuarjes së jetës arrihej me humbje të mëdha njerëzish, sikundër që deri vonë karakterizohej edhe nga përqindja e lartë e popullsisë imobile (autoktone), e lidhur për suaza familjare, vend të lindjes dhe bashkësi lokale.

Me rezultatet që pritet të dalin mbi bazën e analizës së të dhënave relevante, argumenteve, trajtimit me një metodologji bashkëkohore dhe konkluzioneve shkencore, botimi do të jetë i dobishëm për opinionin profesional e shkencor, për hulumtuesit nga fusha e shkencës mbi popullsinë dhe vendbanimet, klasifikimin dhe funksionet e tyre në kontekstin teorik dhe empirik. Shqyrtimi i kompleksit demografik, veçoritë, gjendja dhe proceset transformuese të zhvillimit të

popullsisë dhe të vendbanimeve shqiptare në Luginë gjithnjë mund të shërbejnë si burim informacioni për rrjedhat demografike, për problemet e vendbanimeve dhe zhvillimin e përgjithshëm shoqëror. Njëkohësisht do të jetë edhe një kontribut shkencor për planifikimin hapësinor, rajonal dhe shoqëror dhe për përpilimin e strategjive dhe politikave zhvillimore ekonomike e më gjerë. Studimi në tërë kompleksitetin e tij, me argumentimin që përmban, përveç vlerave të qëndrueshme, afatgjate shkencore, do të jetë padyshim në funksion të sensibilizimit të çështjes së shqiptarëve të Luginës.

Parashihet që këtë verë të bëhet edhe një hulumtim anketues. Qëllimi i anketimit është të shihet rrjedha e migrimeve të jashtme nga Lugina: shkaqet e shkuarjes, statusi i migrantit, adaptimi dhe asimilimi, lidhja me familjen dhe vendlindjen, investimet, çështja e kthimit, pasojat e emigrimit për familjen, bashkësinë lokale dhe shoqërinë, etj.

Arsyetimi i botimit përmban edhe strukturën e tij të shtrirë në disa pjesë dhe shumë kaptina, nënkaptina dhe pika të studimit. Arsyetimi i gjerë, bashkë me strukturën, gjendet në dokumentacion. Botimi do të ketë rreth 25 tabakë.

4. Edi Shukriu: “Studime për Dardaninë”

Libri me titull “Studime të Dardanisë” ka për qëllim që përmes rishikimit dhe analizës së burimeve arkeologjike dhe të shkruara antike të trajtojë çështje me relevancë të zhvillimeve parahistorike dhe antike në

Kosovë dhe në rajon.

Qasja shumëdisiplinare mundëson që objektet arkeologjike të shihen përtej dukjes së tyre fillestare dhe të shpaloset ndërlihdhmëria e proceseve të zhvilluara në kohë të ndryshme.

Duke sjellë rezultatet dhe njohuritë më të reja në fushën e arkeologjisë dhe të antikës, libri krijon bazë për vazhdimin dhe zgjerimin e hulumtimeve në fushat përkatëse.

Libri trajton çështje të lashtësisë arkeologjike dhe të historisë antike. Shfrytëzimi i burimeve arkeologjike dhe të burimeve të shkruara antike në të ka qasje shumëdisiplinare, gjë që mundëson krijimin e një pasqyre më reale për rrjedhat në të kaluarën e hershme.

Kur kihet parasysh se në libër trajtohen temat bazike për shpalimin e historisë së hershme, botimi i tij paraqitet si nevojë për vazhdimin e hulumtimeve në fushën e studimeve dardane, të ilirëve dhe të popujve të tjerë antikë të rajonit dhe më gjerë.

Libri, i ndarë në tri kaptina kryesore, sjell trajtesa që kanë të bëjnë me proceset e zhvilluara, si dhe studimin e monumenteve të veçanta, gjithnjë në relacion me hapësirën dhe kohën e krijimit dhe të vazhdimësisë.

Libri do të ketë rreth 210 faqe. Në të përfshihet materiali dokumentues (fotografi, harta etj.), bibliografia, indeksi dhe rezyrmeja në gjuhën angleze.

5. Anton K. Berishaj: “Konteksti sociokulturor i betimit të virgjërshave”.

Fenomeni i celibatit femëror nën presionin e normave sociokulturore

dhe pritshmërisë shoqërore për kujdesin ndaj prindërve të moshuar, pa trashëgimtarë meshkuj, ka qenë objekt studimi i shumë autorëve të profileve të ndryshme.

Konteksti specifik sociokulturor ka prodhuar forma të ndryshme të celibatit femëror, që kryesisht shfaqen në këtë pjesë të Ballkanit (Veriu i Shqipërisë, Kosova dhe Mali i Zi).

Libri do të analizojë qasjet e ndryshme nga autorë të ndryshëm, ku dominojnë shkrimtarët, antropologët, etnologët dhe publicistët.

Qasjet e autorëve ndërkombëtarë, por edhe të disa vendorëve janë të ngarkuara me doza ekzotizmi - që ndikojnë në ngatërrimin e metodologjisë së hulumtimit.

Punimi, sipas planit dhe strukturës paraprake, mund të ketë rreth 20 tabakë autori

Përveç intervistave, analizave të rasteve dhe interpretimeve të autorëve të ndryshëm, ky punim do të ilustruhet edhe me fotografi.”

6. Arsim Bajrami: “Fjalorthi i termave nga e drejta kushtetuese dhe parlamentare”.

Ky fjalorth ka për qëllim përfshirjen e termave nga e drejta kushtetuese dhe parlamentare, me qëllim të ofrimit të ndihmës për të gjithë juristët, politologët dhe ekspertët tjerë të shkencave sociale, të cilët janë të angazhuar në politikat publike. Fjalorthi do të përfshijë 1000 terma të përzgjedhur të cilat do të zërthehen sipas metodologjisë dhe standardeve evropiane. Në teorinë kushtetuese ka kohë që është ndër

mungesa e një fjalori të tillë dhe botimi i tij ka edhe rëndësi praktike në hartimin e legjislacionit dhe akteve kushtetuese. Fjalorthi do të botohet në formë klasike dhe atë elektronike në CD dhe çdo ekzemplar do të pajiset me CD. Gjatë hartimit të këtij fjalorthi do të bëhen përpjekje për unifikimin e terminologjisë kushtetuese dhe parlamentare me Republikën e Shqipërisë. Si burime për hartimin e tij do të merren enciklopeditë juridike në shumë shtete të botës, aktet kushtetuese, legjislacioni, rregulloret dhe kodet parlamentare, si dhe literaturë e gjerë shkencore nga kjo fushë.

Ky fjalorth do të fillojë të realizohet në janar të vitit 2015 dhe do të përfundojë brenda 12 muajve. Madhësia e tij do të jetë rreth 599 faqe.

7. Revista “Studime shoqërore”, nr. 2. - Revistë vjetore që do të botohet gjatë vitit 2015. Në të do të botohen studime dhe artikuj shkencor, tekste ligjëratah inauguruese, vështrime, recensione e kritika, etj. nga disiplinat e shkencave shoqërore.

Sekretari i
Seksionit

Akademik Mark Krasniqi, d. v

III. Seksioni i Shkencave të Natyrës

I. Projektet

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK. Deri më tani janë përfunduar të gjitha punët që kanë të bëjnë me fjalësin e zërave, i cili tashmë është publikuar dhe në të janë inkuorporuar vërejtjet dhe sugjerimet e

diskutimit publik. Pas përcaktimit të madhësisë së zërave nga Redaksia Qendrore në bashkëpunim me redaksitë e fushave, ka filluar hartimi i teksteve të zërave. Në këtë proces janë angazhuar, ose janë në angazhim e sipër rreth 300 bashkëpunëtorë. Gjatë vitit 2015 pritet të realizohet në tërësi shkrimi i teksteve të zërave dhe, paralelisht me këtë, të avancojë edhe redaktimi i tyre. Për realizimin e suksesshëm të kësaj faze finale të punës rreth Fjalorit Enciklopedik, gjatë vitit 2015 do të jetë e nevojshme të themelohet një redaksi funksionale, e cila do të merrte përsipër punët redaktoriale rreth teksteve të Fjalorit.

2. “Klima dhe parametrat projektues për qytetet kryesore të Kosovës dhe të Shqipërisë”- Është ky projekt i përbashkët i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Projekti është përfshirë në Protokollin e bashkëpunimit ndërmjet ASHAK dhe ASHSH për periudhën 2013-2015. Projekti ishte i përfshirë edhe në protokollin paraprak të bashkëpunimit për periudhën 2011-2013, por duket se në ASHSH pati probleme lidhur me përparimin e punëve në këtë projekt, që ka rezultuar edhe me ndryshimin e grupeve të punës dy herë radhazi. Këtë vit dhe vitin në vijim, Seksioni i Shkencave të Natyrës do të fuqizojë bashkëpunimin me Seksionin përkatës të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në mënyrë që të mos ketë ngecje në realizimin e tërësishëm të projektit. Në të kundërtën, Seksioni i SHN do të propozojë ndonjë zgjidhje tjetër eventuale lidhur me këtë projekt.

II. Botimet

1. Minir Dushi: “Boksitet e Dukagjinit”

Boksitet e Malit të Gremnikut për herë të parë ishin zbuluar në vitet 1954/1955. Në vitin 1966 është hapur Miniera e Boksitit “Kosova” me prodhim vjetor 100. 000 tona që janë shitur në RP të Rumanisë. Rezervat e boksitit janë 7. 000. 000 t të kategorive A, B dhe C1 që përfshihen brenda rreth 60 trupave minerale (vendburime).

Në jugperëndim nga Klina në serinë e sedimenteve të Kretakut të Sipërm të Malit të Gremnikut dhe rrethinës së tij ndodhen vendburime të rëndësishme ekonomike të boksiteve. Këtu shfaqet boksiti në një strukturë faciale të gjatë rreth 15 km dhe e gjerë 0. 5 – 3. 5 km, e cila fillon nga fshati Lug (Dollc) në veri dhe përfundon në atë Kështjellë (Zatriq), që përfshin një sipërfaqe rreth 15 km katror. Në këtë strukturë faciale në boshllëqet stratigrafike ndërmjet gëlqerorëve të turnanionit dhe atyre mastrite të kretakut ndodhen grumbullime të trupave minerale të boksiteve. Këto boksite eolitike me ngjyrë të kuqe janë të llojit të diasporës dhe më së shpeshti kanë këtë përbërje: Al_2O_3 46,52%, SiO_2 1,5 – 4,0 dhe Fe_2O_3 30 – 40 %. Për shkak të përmbajtjes së lartë të përbërësit Fe_2O_3 janë quajtur edhe boksite feroze.

Vepra shkencore “Boksitet e Dukagjinit” parashihet të arrijë vëllim prej rreth 20 tabak autori dhe paraqet një studim shkencor nga fusha e shkencave gjeologji-miniera.

Teksti shoqërohet me harta vështruese gjeologjike, profile

gjeologjike, tabela, skica, skema, fotografi e materiale të tjera.

Qëllimi i hartimit të këtij studimi qëndron në faktin që opinionit t'i ofrohet një studim me vlerë ekonomike të pasurive minerale të Republikës së Kosovës.

2. Latif Susuri: "Fjalor i termave bujqësore në gjuhët: shqip, anglisht, gjermanisht, frëngjisht dhe pjesërisht latinisht" (titull pune).

Fjalori përmban një numër termash të terminologjisë bujqësore që përdoren si në praktikë po ashtu edhe në mësim, në edukim dhe në shkencë. Në fjalor janë përfshirë termat e shumë fushave që i përkasin bujqësisë, siç janë: blegtorja, mjekësia veterinare, mikrobiologjia, botanika, agrokimia, pylltaria, mekanizimi, hidroteknika bujqësore, meliorimet bujqësore, teknologjia e përpunimit të produkteve bujqësore, meteorologjia, fitopatologjia, entomologjia, etj. Fjalori përbëhet nga dy pjesë.

Në pjesën e parë janë radhitur termat sipas alfabetit në gjuhën shqipe i cili pasohet në gjuhët anglisht, gjermanisht dhe frëngjisht. Emrat e bimëve, emrat e kafshëve, sëmundjet e bimëve, sëmundjet e kafshëve, dëmtuesit janë shënuar edhe në gjuhën latine. Këtu janë dhënë edhe formulat kimike që kanë të bëjnë me komponentet që përdoren për plehra artificiale kimike, insekticide, fungicide, herbicide, nematocide etj.

Pjesa e dytë e fjalorit përfshinë indeksin e radhitur në mënyrë alfabetike e të ndarë në gjuhët anglisht, gjermanisht, frëngjisht dhe latinisht.

Fjalori i terminologjisë bujqësore do të jetë mbështetje e mirë për specialistët e bujqësisë, punëtorët shkencorë, studentët e shkencave të natyrës dhe për të gjithë ata që kanë interes dhe merren me problemet teorike dhe praktike në fushën e bujqësisë.

3. Ruzhdi Pllana. " Lumi Sitnica, studim hidrogeografik "

Realizimi i konceptit për zhvillimin të qëndrueshëm shtron nevojën e studimit shkencor të resurseve ujore dhe përdorimit racional të tyre. Në studim trajtohen faktorët natyrorë që kanë ndikuar në krijimin dhe zhvillimin morfogjeologjik të basenit të Kosovës dhe rrethinat e tij, si dhe proceset e zhvillimit morfohidrologjik, krijimin dhe zhvillimin e rrethit aktual hidrografik dhe akuiferëve nëntokësorë. Në studim bëhet analiza komplekse e faktorëve natyrorë gjeologjikë, gjeomorfologjikë, klimatikë, biologjikë etj. që ndikojnë në formimin e pasurive ujore dhe regjimin hidrologjik në ujëmbledhësin e lumit Sitnica.

Sitnica kullon pjesët më të mëdha të basenit të Kosovës: Llapin, Drenicën dhe rrethinat kodrinore-malore të tyre. Hapësira veçohet me resurs të rëndësishëm tokësor (pedogjen), mi-nerale (metalor dhe jometalor) dhe burime energjetike (qymyr), por me mungesë të theksuar të pasurive ujore. Pellgu i lumit Sitnica paraqet pjesën më të stërngarkuar të Kosovës me përqendrim të vendbanimeve, popullsisë, infra-strukturës, aktiviteteve ekonomike dhe mjedisore.

Në studim, krahas analizës së kushteve

natyrore hidrologjike, trajtohen edhe çështjet e ndërhyrjeve të rëndësishme hidroteknike në ujëmbledhësin e lumit Sitnica si dhe mundësitë natyrore dhe teknike për rritjen e kapaciteteve ekzistuese të pasurive ujore dhe përdorimit të integruar të tyre.

Vepra shkencore “Lumi Sitnica, studim hidrogeografik”, së bashku me shtojcat e tabelave, grafikëve dhe hartave tematike do të ketë vëllim prej rreth 250 faqesh.

4. Salih Gashi. “Osmoza e kundërt”. - Edhe pse ekzistojnë shumë revista shkencore dhe një numër tekstesh profesionale për proceset membranore, përkatësisht për osmozën e kundërt, zhvillimet e sotme kërkojnë që përveç bazave teorike dhe praktike të prezantohen në vazhdimësi rezultatet më të reja dhe trendët e zhvillimit të kësaj fushe të teknologjisë bashkëkohore, aq më tepër që ka pak burime apo vetëm një numër i limituar i tyre në gjuhën shqipe.

Objektivi i kësaj vepre shkencore është që të ofrojë njohuri teorike dhe praktike për inxhinierët, shkencëtarët, operatorët e procesit, studiuesit dhe për të gjithë ata që merren dhe do të merren me studimin dhe zbatimin osmozës së kundërt në mënyrë që pa vështirësi t’i zbatojnë idetë e tyre në avancimin dhe përsosjes së saj. Lëxuesit do të kenë mundësi që të mësojnë për historikun, parimet themelore teorike, terminologjinë, gatitjen dhe llojet e tyre, zhvillimin e membranave të reja, membranat dhe komponentët e sistemit, konfiguracionin, kiminë e membranave, mirëmbajtjen, shpenzimet dhe sigurinë, arritjet e deri-

tanishme dhe parashikimet për të ardhmen e tyre.

5. Revista “Kërkime” nr. 21 dhe 22. -

Revista Kërkime boton tekste dhe kontribute shkencore nga fusha e shkencave të natyrës dhe të shkencave të tjera fundamentale. Sikundër edhe deri tash, në revista do të botohen punime shkencore të anëtarëve të Seksionit të Shkencave të Natyrës të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, si dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm, të tillë tekste që do t’i plotësojnë kriteret shkencore, pas vlerësimit profesional që do t’u bëhet nga redaksia e revistës.

Sekretari i Seksionit

Akademik Fejzullah Krasniqi, d. v.

IV. Seksioni i Arteve

I. Projektet

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK. Deri më tani janë përfunduar të gjitha punët që kanë të bëjnë me fjalësin e zërave, i cili tashmë është publikuar dhe në të janë inkorporuar vërejtjet dhe sugjerimet e diskutimit publik. Pas përcaktimit të madhësisë së zërave nga Redaksia Qendrore në bashkëpunim me redaksitë e fushave, ka filluar hartimi i teksteve të zërave. Në këtë proces janë angazhuar, ose janë në angazhim e sipër rreth 300 bashkëpunëtorë. Gjatë vitit 2015 pritet të realizohet në tërësi shkrimi i teksteve të zërave dhe,

paralelisht me këtë, të avancojë edhe redaktimi i tyre. Për realizimin e suksesshëm të kësaj faze finale të punës rreth Fjalorit Enciklopedik, gjatë vitit 2015 do të jetë e nevojshme të themelohet një redaksi funksionale e cila do të merrte përsipër punët redaktoriale rreth teksteve të Fjalorit.

II. Botimet

1. Engjëll Berisha: “Motivet kombëtare në veprat e kompozitorëve tanë”.

Do të jetë një përmbledhje punimesh mbi motivet kombëtare, përkatësisht aso nga folklori ynë muzikor shqiptar që i kanë përdorur kompozitorët tanë brezash të ndryshëm në veprat e tyre muzikore. Ato janë të pranishme varësisht nga tematika, përmbajtja afiniteti i krijuesve tanë muzikorë gjeneratash dhe qendrash muzikore ku kanë studiuar apo edhe ku janë perfeksionuar. Studime dhe punime analitike të kësaj natyre janë tejet të pakta ndër ne. Prandaj një studim i këtillë i akad. Engjëll Berishës mbi përdorimin e motiveve kombëtare që janë përdorur në veprat e gjinive të ndryshme: solistike instrumentale, aso vokale, kamertale, vokale-instrumentale, orkestrale-simfonike, muzikore-skenike, e mundësisht të përfshirë edhe me shembuj konkretë notalë, do të mund të ishte një kontribut në këtë fushë të ndjeshme (etno)muzikologjie ndër ne dhe më gjerë.

2. Rexhep Ferri: “Bukuria e zjarrtë” (titull pune). – Janë punime eseistike mbi artet pamore.

Akademik Rexhep Ferri, përpos si artist me përvojë dhe i afirmuar me punime të bollshme veprash, pikë së pari nga fusha e arteve pamore, ka një kohë bukur të gjatë që është aktiv edhe si poet dhe prozator me disa vepra të botuara, por dhe me punime të ndryshme sporadike nga fusha eseistike. Në këtë drejtim, një përmbledhje studimesh dhe esesh mbi krijimtarinë e artistëve tanë apo dhe të tjerë të njohur të arteve pamore, e përkufizuar me punime mbi veprat nga kjo fushë e arteve, ka për qëllim pasurimin e fondit tejet të paktë dhe modest të kësaj gjinie studimore mbi artet pamore. Besojmë se përmbledhja do të përfshijë brendapërbrenda saj autorë nga fusha e arteve pamore nga më të ndryshmit të njohur e të afirmuar shqiptarë, mbase të shoqëruar edhe me shembuj të ndryshëm reproduksionesh.

3. Zeqirja Ballata: “Vepra kamertale”.

- Është një përzgjedhje veprash muzikore të periudhës krijuese nga gjysma e viteve ‘60 të shekullit të kaluar deri te gjysma e parë e dekadës së dytë të këtij të tonit. Veprat muzikore kamertale të autorit (disa janë botuar në Slloveni e Holandë) kanë pasur rast të realizohen, përkatësisht të ekzekutohen nga ansamble, solistë e këngëtarë të njohur, përpos ndër ne në Kosovë, edhe në Shqipëri dhe në një varg vendesh, përkatësisht festivalesh dhe qendrash të ndryshme ndërkombëtare muzikore të njohura, si në Slloveni, Kroaci, Itali, Mal të Zi, Francë, Maqedoni, Gjermani, Vojvodinë, Austri, Serbi, Bullgari etj. Në krahasim me vendet tjera ku botimet e veprave muzikore mundësohen nga disa institucione të kulturës, të artit e të

arsimit, ndër ne për fat të keq, për botimet e veprave muzikore të kompozitorëve tanë, përpos në institucionin tonë më të lartë të dijeve dhe të arteve, pothuaj, nuk i kushton askush kujdesin e merituar. Botimi i këtyre veprave, njëherësh, ua lehtëson ansambleve dhe solistëve të ndryshëm në vend e jashtë që më me lehtësi të vendosin për t'i marrë në programet e tyre koncertale.

4. Rauf Dhomi: "Dasma arbëreshe". -

Opera e kompozuar ndër ne këtu në Kosovë, e propozuar nga autori për botim vitin që po shkon, bartet për t'u realizuar si botim i tërësishëm në vitin që vjen, në mënyrë që të kenë mundësi institucionet muzikore-skenike qoftë ndër ne këtu në Kosovë apo andej në Shqipëri dhe më gjerë ta vënë këtë vepër mundësisht në repertorët e tyre vjetore. Botime operash, baletesh e tablosh të ndryshme koreografike muzikore janë fare të rralla, për të mos thënë hiq fare. Në vende të tjera më të zhvilluara, ku kanë një traditë më të mirë muzikore, përfshirë këtu edhe Shqipërinë, botimet e tilla janë të pranishme

dhe të mirëseardhura, që d.m.th. se edhe realizimet e veprave të gjinive të tilla muzikore-skenike (operat, operetat, baletet, tablotë koreografike...) ua bëjnë më të lehtë mundësinë teatrove të operës e baletit dhe përgjithësisht institucioneve muzikore që t'i vejnë në repertorët, përkatësisht programet e tyre.

III. Ekspozitat

1. Anëtari korrespondent Xhevdet Xhafa do të realizojë ekspozitën e tij promovuese me rastin e pranimit anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Ekspozita inauguruese e kolegut tonë do të jetë dhe një rast që jo vetëm Seksioni i Arteve, por edhe anëtarët e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të njihen më për së afërmi jo vetëm me punimet e tij artistike tashmë të njohura, por edhe me ato të realizuara dhe të prezantuara në periudhën e fundit.

Sekretari i Seksionit

Akademik Zeqirja Ballata, d. v.

Shënim: Të gjitha seksionet e Akademisë edhe gjatë periudhës së ardhshme do të vazhdojnë të organizojnë promovimin e veprave të botuara të anëtarëve të Akademisë, si dhe ligjërata dhe paraqitje të ndryshme me interes për një auditor më të gjerë, përfshirë edhe ligjëratat e ndërsjella të anëtarëve të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

**PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMIË SË
SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS**



PROCESVERBAL

Nga mbledhja LXXXI e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 18 shkurt 2014, në orën 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Besim Bokshi, Ekrem Murtezai, Engjell Berisha, Eqrem Basha, Esat Stavileci, Fejzullah Krasniqi, Feriz Krasniqi, Hivzi Islami, Idriz Ajeti, Isuf Krasniqi, Latif Susuri, Mark Krasniqi, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Nexhat Daci, Pajazit Nushi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Tahir Emra, Zeqirja Ballata dhe anëtarët korrespondentë: Anton K. Berishaj, Arsim Bajrami, Arsim Morina, Edi Shukriu, Jusuf Bajraktari, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Qamil Haxhibeqiri, Ruzhdi Pllana, Salih Gashi, Xhevdet Khafa, Zejnullah Rrahmani.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi Hivzi Islami, kryetar.

Kuvendi e miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXX të Kuvendit;
2. Miratimi i raportit të punës së ASHAK-ut për vitin 2013;
3. Miratimi i raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2013;
4. Çështje vijuese.

Ad. 1. -

Procesverbali i mbledhjes LXXX të

Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Pas miratimit të procesverbalit kryetari Islami në mënyrë përmbledhëse paraqiti aktivitetin vjetor të Akademisë, si më poshtë:

“Kolegë dhe miq të nderuar,

Mirë se vini në mbledhjen LXXXI të Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me rendin e ditës që e keni marrë me kohë. Kjo është mbledhja e parë në këtë vit, ku do të shqyrtohet puna e të gjitha instancave të ASHAK-ut, Kuvendit, Kryesisë, seksioneve dhe Shërbimit Administrativ, Profesional dhe Teknik, si dhe Raporti financiar për vitin 2013. Të gjitha janë të përgatitura nga Shërbimi Profesional dhe Administrativ, i keni në materiale; disa çështje kanë kaluar edhe nëpër seksione, ku bëjnë pjesë të gjithë anëtarët e Akademisë. Por jemi këtu për të diskutuar. Ta kemi parasysh se na pret një koktej në mjediset tona, sepse sot po e shënojmë edhe ditën e pavarësisë dhe të sovranitetit të Kosovës, 17 Shkurtin e Madh. Prandaj edhe kjo mbledhje e Kuvendit le të zhvillohet në frymën e kësaj dite, në një atmosferë solemne, duke mos lënë anash atë që është esenciale.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës: miratimi i procesverbalit nga mbledhja LXXX e Kuvendit të Akademisë. A ka ndonjë vërejtje? Jo. Miratohet procesverbali në tërësi.

Vitin që shkoi Akademia mbajti gjithsej 2 mbledhje të Kuvendit dhe 10 mbledhje të Kryesisë dhe shumë

mbledhje të seksioneve dhe të trupave të tjera, të komisioneve, të këshillave organizuese të tubimeve shkencore dhe artistike, të redaksisë qendrore të FEK, redaksive të revistave etj. Përveç detyrave dhe programeve të punës të miratuara në Seksione, në Kryesi dhe në Kuvend në shkurt dhe në qershor të vitit 2013, angazhime dhe detyra shtesë nuk kemi pasur, siç kishim në vitin 2012, kur i kishim zgjedhjet e rregullta.

E filluam vitin 2013 me takimin solemn më 10 janar 2013 të anëtarëve të rinj, të rregullt dhe korrespondentë, të Akademisë, të pranuar në Kuvendin e Akademisë më 5 dhjetor 2012. E përmbyllëm me shumë sukses këtë proces mjaft të përgjegjshëm dhe në këtë aspekt ky ishte shpërthimi më pozitiv në historinë e kësaj themelate: 12 anëtarë të rinj dhe 3 avancime. Në këtë Kuvend u zgjodhën edhe katër anëtarë të jashtëm, punonjës të shquar të shkencave në vendet e tyre, por që kontribuuan edhe për Kosovën dhe shqiptarët. Me këtë rast anëtarëve të rinj iu dorëzuan edhe fletëdëshmitë.

Në këtë fillim (2013), më 23 janar Kryesia e pati edhe një prononcim për Luginën e Preshevës, në kohën kur ishin ashpërsuar raportet midis shqiptarëve të atjeshëm dhe pushtetit qendror në Beograd.

1. Botimet dhe projektet:

Pas një pune intensive në përgatitjen e monografisë "Kosova", versioni në gjuhën angleze, nga gjysma e vitit doli botimi, i cili u prit shumë mirë në të gjitha qarqet shkencore dhe shoqërore, vendore dhe ndërkombëtare dhe në

opinion. Tirazhi është gati nga fundi. Gjatë gjithë vitit raportues vazhdoi puna edhe më intensive në "Fjalorin Enciklopedik të Kosovës": u hartua fjalësi i plotë i zërave, versioni mesatar me rreth 6.000 zëra; sipas Redaksisë Qendrore fjalësi do të mbetet i hapur për ndryshime dhe plotësime deri në dorëzimin e veprës në shtyp. Për këtë qëllim u mbajt një trajnim në Durrës prej 19-22 shtator, ku morën pjesë Bordi, Redaksia Qendrore dhe redaktorët e fushave. Trajnimi doli mjaft produktiv.

Versioni final i tij, përmes një botimi pilot, do të nxirret në diskutim publik në kopje të kufizuara, i cili do t'u vihet në dispozicion të gjitha institucioneve tona, mediave dhe të interesuarve të tjerë, në mënyrë që të sigurohet një përfshirje sa më e plotë e njësive përmbajtjesore në këtë Fjalor. Botimi i fjalësit të kompletuar të Fjalorit Enciklopedik të Kosovës besojmë se do të del brenda këtij muaji.

Doli vepra e plotë e poetit dhe akad. Ali Podrimja, në 9 vëllime, monografia e akademik Tahir Emrës, botimi "Të shkruarit dhe të menduarit juridik" i akademik Esat Stavileci, botimi "Lugina e Preshevës – studim kompleks gjeohapësinor" i dr. Arsim Ejupit, "Uvetyra solemne" e akad. Rauf Dhomit, numri 20 i revistës "Kërkime", numri 33 i publikimit "Vjetari" etj. Në shtyp gjenden këto vepra: "Vepra korale" e akademik Zeqirja Ballatës, "Gërmime dhe studime arkeologjike të Kosovës", grup autorësh, "Ndarja territoriale-administrative e Kosovës 1944-2010 (dokumente), grup autorësh, numri 20 (1) i revistës "Studime" dhe numri 1 i revistës "Studime shoqërore".

Gati të gjitha dorëshkrimet që ishin përgatitur dolën nga shtypi. Disa tituj po zhagiten pa arsytetime bindëse. Ndërsa në disa projekte hulumtuese, afatmesme dhe afatgjatë, puna po ec relativisht mirë, çfarë është rasti me "Identifikim i ndotësve të efluentëve të ujërave urbane dhe të industrisë dhe trajtimi i tyre", por në disa të tjera, në mungesë të mjeteve dhe të infrastrukturës përkatëse për punë hulumtuese në terren, po shtyhet puna, si p. sh. me projektin "Bimët e rrezikuara e të rralla të florës së Kosovës." Na mungojnë mjetet dhe institutet hulumtuese me laboratore, institutet e shkencave shoqërore, atelietë dhe studiot për aktivitetet artistike etj. Nga gjysma e vitit 2013 kisha disa kontakte me rektorin që shkoi për një memorandum bashkëpunimi me departamentet përkatëse apo njësitë akademike përmes UP-së për shfrytë-zimin e laboratorëve, por puna nuk eci nga pengesat brenda Rektoratit dhe çështja mbeti e hapur. Që në fillim e dinim se me rektorët politikë dhe rektoratet politike bashkëpunimi nuk mund të ecë.

Gjendja në fushën e investimeve për shkencë dhe hulumtime mbetet e pandryshuar, tejet e pavolitshme, asnjë cent për shkencë dhe hulumtime! Dikur ka vluar jeta shkencore dhe veçanërisht puna hulumtuese në shkencat fundamentale (në institute, laboratore, katedra e departamente, ente, bërthama shkencore, etj.). Po e nënvizoj këtë fakt, sepse prurjet në Akademi janë kryesisht nga UP-ja. Fakultet dhe departamentet, mjerisht, janë shndërruar sot në punkte të mësimdhënies jofunkcionale, ekstensive. Punë shkencore dhe veçanërisht hulumtuese ka tepër pak.

Disa herë konkurruam në MASHT, që kishte do fonde për shkencë dhe hulumtime, për disa projekte, por nuk morëm as përgjigje.

Kur jemi te projektet hulumtuese, sa e sa herë e kemi biseduar që përveç mbështetjes financiare që mund të ofrojë Akademia nga buxheti i vet, duhet të kërkohen mjete plotësuese edhe në instanca tjera, si p. sh. në disa ministri (e bujqësisë, e mjedisit, e planifikimit hapësinor, e zhvillimit ekonomik, e shëndetësisë, e minierave, e industrisë, pastaj nga agjencitë, kompanitë e interesuara etj.) dhe të nënshkruhen memorandume bashkëpunimi me to. Nga ky bashkëpunim rrjedhin mjetet, fitojnë seksionet dhe individët, por edhe Akademisë si ndërmjetësuese i mbeten deri 20% të mjeteve. Por dikush duhet t'i porositë projektet hulumtuese-shkencore dhe rezultatet e tyre duhet ta kenë një destinim. Sa janë të nevojshme e të dobishme analizat dhe hulumtimet e ujit dhe të ndotësve të tij për ato ministri e kompani që e menaxhojnë ujin, që i ka bërë ekipi i prof. Dacit. Rezultatet janë të aplikueshme dhe duhet të aplikohen nëse nuk aplikohen atje në sektorët operativë. Mbetet obligim i sekretarëve të seksioneve, bashkë me sekretarin e përgjithshëm, që të jenë më aktivë në këtë drejtim.

2. Konferenca shkencore, tryeza shkencore, koncerte:

Më 15 shkurt Akademia mbajti një koncert solemn, shumë të suksesshëm, në 5-vjetorin e pavarësisë së Republikës së Kosovës, të drejtuar nga akad. Zeqirja Ballata. Përveç anëtarëve të Akademisë

morën pjesë edhe njerëz nga bota e artit nga Kosova dhe Shqipëria. Në vijim u organizuan këto tryeza dhe konferenca shkencore: më 13 qershor u mbajt tryeza shkencore me temë "Letërsia shqipe në shkrimet enciklopedike" dhe më 27 qershor tryeza "Depërtimi dhe përshtatja e huazimeve angleze në gjuhën shqipe", ndërsa më 30 tetor u mbajt konferenca shkencore "Energjetika dhe mjedisi për zhvillim të qëndrueshëm" dhe më 27 dhjetor u mbajt tryeza shkencore "Punësimi në kontekstin zhvillimor dhe integruet të Kosovës". Nga informacioni që kemi, shumë anëtarë të Akademisë të të gjitha seksioneve dhe fushave morën pjesë në aktivitete të ndryshme shkencore, profesionale e shoqërore jashtë Akademisë, në Kosovë dhe në botën e jashtme.

Anëtari korresp., prof. Arsim Bajrami dhe sekretarja Lendita Pula, të deleguar në Grupin e Qeverisë për hartimin e Ligjit për Akademinë, kanë marrë pjesë aktive në diskutimin për këtë ligj dhe i kanë mbrojtur qëndrimet e Akademisë. Me kërkesën e Grupit të Qeverisë për hartimin e Ligjit, është vizituar edhe Akademia Sllovene e Shkencave dhe e Arteve, që është model për ne. Pas përfundimit të punës së Grupit është organizuar edhe debati publik për Ligjin, ku kanë marrë pjesë edhe 5 anëtarë të tjerë Akademisë. Versioni i Grupit për Ligjin ka kaluar në Qeveri, ku ka marrë miratimin dhe procedura duhet të vazhdojë në instancat përkatëse.

Luten këshillat organizuese të konferencave shkencore, të tryezave shkencore, të tubimeve të tjera t'i

bëjnë gati materialet për botim. Vlera e tyre është botimi.

3. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Të gjitha aktivitetet e Akademisë, kontaktet dhe bashkëpunimi me instancat ndërkombëtare, akademike dhe shkencore janë të pasqyruara në raportin e punës. Nga raportet e deponuara dhe të miratuara nga Kryesia e Akademisë të pjesëmarrësve shihet se kemi pasur një aktivitet relativisht të dendur për rrethanat tona kadrovike dhe financiare. Nga 1-3 mars akad. Rexhep Ismajli ka marrë pjesë aktive në Kuvendin vjetor të Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve me seli në Salsburg. Më 9-10 prill akad. Nexhat Daci merr pjesë aktive në Konferencën e Akademive të Danubit; më 13 qershor në Tiranë nënshkruhet Protokollin e bashkëpunimit midis ASHAK-ut dhe ASHSH (delegacioni: nënkryetari akad. P. Nushi, sekretari i përgj. akad. I. Krasniqi dhe sekretarja e Akademisë Lendita Pula); nga 20-21 qershor delegacioni i Akademisë sonë (kryetari, kryetari i Komisionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe akad. Eqrem Basha) qëndruan në Akademinë Bullgare të Shkencave, me ftesën e kësaj të fundit; më 4 korrik delegacioni i ASHAK-ut në përbërje kryetari, nënkryetari, kryetari i Komisionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe akad. Ali Aliu qëndruan në MANU, me ftesën e kësaj të fundit, ku u bisedua për mundësinë e nënshkrimit të Marrëveshjes së bashkëpunimit, e cila së shpejti edhe do të nënshkruhet; më 29-30 gusht Akademinë tonë e viziton kryetari i ALLEA-s, njëherësh

edhe kryetar i Asociacionit të Akademive Gjermane të Shkencave dhe të Arteve dhe kryetari i Akademisë Berlin-Brandenburg, prof. Günter Stock. Me atë rast ai mbajti edhe ligjëratën me titull "Roli i akademive gjatë historisë – përgjegjësitë dhe parimet e akademive në të kaluarën dhe sot". Kryetari Stock u prit edhe nga nënkryetari i Qeverisë së Republikës sonë z. Hajredin Kuçi.

Prej 10-13 tetor 2013 anëtarja korresp. prof. Edi Shukriu ka qëndruar në Vjenë, ku me kumtesë ka marrë pjesë në takimin e ICOMOS - Evropa Juglindore. Prej 17-18 tetor sociologu i ri Ardian Gola, i dërguar nga ASHAK-u, në CANU në Podgoricë mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare "Young Scientists and Science in the Region" dhe mbajti temën "Research practices in Kosovo: Challenges in Humanities and Social Sciences". Më 24 tetor në Akademinë tonë qëndroi delegacioni i Akademisë Bullgare të Shkencave, i kryesuar nga kryetari Stefan Vodenicharov dhe sekretarja kryesore shkencore, prof. Evdokia Pesheva. Me atë rast kryetari Vodenicharov mbajti ligjëratën "Zhvillimi i Akademisë Bullgare të Shkencave". Akad. R. Ismajli në cilësi të të ftuarit mori pjesë në takimin në Akademinë Gjermane Berlin-Brandenburg më 21-22 nëntor, dhe prej aty shkoi (23-27 nëntor) në Zagreb për të marrë pjesë me kumtesë në Konferencën Ndër-kombëtare Shkencore "The Image (s) of South-Eastern and East-Central Europe throughout History", të organizuar nga Asociacioni Ndërkombëtar i Studimeve të Europës Juglindore (AIESEE),

Komiteti Nacional Kroat dhe Instituti i Shkencave Shoqërore Ivo Pilar. Më 20-21 nëntor anët. korresp. prof. Sali Gashi mori pjesë në takimin plenar vjetor të ALLEA-s në Dablin në Grupin e punës për edukim në fushën e shkencave të natyrës (Working Group on Science Education).

Nga 8-13 dhjetor në Akademinë tonë, në kuadër të shkëmbimit të kuadrove shkencore, në frymën e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Akademisë sonë dhe Akademisë Bullgare, qëndruan dy shkencëtarë (Dr. Emanuel Moutafov dhe Dr. Luchiya Antonova). Më 26 dhjetor në ASHAK qëndroi ambasadori ynë dhe anëtari i jashtëm i ASHAK Muhamedin Kullashi dhe informoi për takimin me përfaqësuesit e Akademisë Franceze "Académie des inscriptions et belles lettres" (e themeluar në vitin 1663) dhe mundësinë e nënshkrimit të Marrëveshjes së bashkëpunimit midis saj dhe ASHAK-ut në këtë vit. Gjatë këtij viti, në raste të ndryshme, kryetari i Akademisë dhe anëtarët tjerë janë takuar me diplomatë të vendeve të ndryshme, ku është biseduar për mundësitë e bashkëpunimit të akademisë sonë me akademitë dhe asociacionet e tjera të vendeve të tyre.

4. Përrurimet

Me daljen në godinën e re, vazhdon aktiviteti i Akademisë dhe i seksioneve të saj në përrurimin e publikimeve me interes për shkencën dhe opinionin. Janë përruruar këto botime: më 20 maj përrurohet botimi i akad. Esat Stavilecit "Të shkruarit dhe të menduarit juridik";

më 19 qershor përurohet botimi i dr. Arsim Ejupit, "Lugina e Preshevës", si botim i parë dhe komplet për atë pjesë të trungut gjeoetnik; më 5 korrik përurohet vepra e plotë e akad. Ali Podrimjes në 9 vëllime; kjo vepër u përrua edhe në Tiranë më 10 tetor: përrimin e organizoi Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, por me shpenzimet e ASHAK-ut (salla e hotelit dhe dreka); më 23 tetor përurohet monografia për akad. Tahir Emrën, një vepër që pati jehonë të mirë profesionale dhe mediale.

Te përrimi i publikimeve, Kryesia ka marrë një qëndrim që përrimet të organizohen 2 herë në vit: në fund të qershorit dhe në fund të dhjetorit. Do të jetë më produktive dhe më racionale t'i promovojmë botimet dy herë në vit. Akademia po rritet, aktivitetet po shtohen. Dhe ka ardhur koha që këto dhe aktivitete të tjera të mbesin punë pothuajse vetëm e seksioneve, pa obligime për anëtarët e seksioneve tjera. Anëtarët nuk po vijnë për ditë dhe në çdo aktivitet të seksioneve, veçanërisht jo të seksioneve të tjera; ndonjëherë nuk po marrin pjesë as në aktivitetet e seksionit të vet (promovimi i botimeve, tryezat, konferencat shkencore, ligjëratat inauguruese etj.).

5. Ligjëratat inauguruese

U mbajtën dy ligjëratat inauguruese të anëtarëve të rinj të ASHAK-ut dhe dy ligjëratat të anëtarëve të jashtëm të Akademisë. Në prani të anëtarëve të ASHAK-u dhe të botës akademike e shkencore, më 20 shkurt akad. Kolec Topalli mbajti ligjëratën me titull "Disa

rezultate në studimin e zhvillimit të gjuhës shqipe", ndërsa më 24 prill akad. Alajdin Abazi mbajti ligjëratën me titull "Konceptet e rrjeteve energjetike inteligjente dhe kualiteti i fuqisë". Të dy anëtarëve të jashtëm iu dorëzuan edhe fletëdëshmitë. Ndërkaq nga anëtarët tanë korrespondentë u mbajtën dy ligjëratat: më 15 maj prof. Arsim Bajrami mbajti ligjëratën inauguruese "Argumentimi kushtetues-juridik i pavarësisë së Kosovës dhe vendimi i GJND-së", kurse më 4 qershor prof. Ruzhdi Pllana mbajti ligjëratën inauguruese me titull "Karakteristikat morfologjike të karstit të Kosovës". Të dy ligjëratat u ndoqën me interesim.

6. Puna e shërbimit administrativ, profesional dhe teknik

Për punonjësit e shërbimeve profesionale, administrative e teknike të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës viti 2013 ka qenë një vit me mjaft angazhime. Ata edhe gjatë këtij viti kanë vazhduar t'i kryejnë detyrat e tyre në realizimin e Programit të punës të Akademisë. Ky shërbim në këtë vit është plotësuar dhe riorganizuar. Vendi i zbrazët i punës sekretar teknik i Kryesisë së Akademisë është plotësuar. Pas pensionimit të punonjëses F. Dauti në këtë vend të punës është pranuar znj. Dafina Kavaja. Po ashtu janë pranuar edhe tre punonjës të rinj: z. Hilmi Zogjani, përgjegjës i Njesisë së Bibliotekës, znj. Lirijeta Bunjaku, zyrtare për shpenzime/financiar dhe z. Ali Caka, drejtor i Departamentit të Përkrahjes Profesionale dhe TIK.

Në Bibliotekën e Akademisë ka

vazhduar pasurimi i fondit librar me botime të reja të anëtarëve të Akademisë sonë, me botime të tjera që sigurohen nga shkëmbimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe me institucionet e tjera brenda dhe jashtë vendit, si dhe përmes blerjes nga buxheti dhe Fondi për stimulimin e shkencëtarëve të rinj. Falë kushteve të mira që ofrojnë mjediset e reja të Bibliotekës është shtuar numri i studiuesve që vijnë dhe i shfrytëzojnë librat e Bibliotekës.

Akademia jonë ka marrë pjesë me botimet e veta në panairët e librit në Prishtinë nga 3-9 qershor, në Frankfurt prej 9-13 tetor, përmes Shoqatës së Botuesve të Kosovës, sepse nuk kemi dërguar njerëz tanë, dhe në Tiranë prej 13-17 nëntor 2013.

Punonjësit e këtij Shërbimi gjatë këtij viti kanë kryer trajnime nga fusha përkatëse e punës dhe me përkushtim janë angazhuar që me sukses t'i kryejnë punët administrative, profesionale, teknike dhe punët e tjera për nevojat e Akademisë. Atje ku ka pasur ngecje, neglizhencë dhe shkelje të detyrave të punës, me qëllim apo pa të, ka edhe "ndëshkime", duke u redistribuuar në vende tjera të punës.

Përmbyllje

Në përmbyllje po e përsëris atë që e kemi thënë sa e sa herë: të jemi më aktivë, të japim iniciativa, të organizojmë tryeza e konferenca shkencore, të paraqesim projekte (afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata), dhe nga sot të mendojmë për programin e punës për vitin 2015. Askund në botë orar të punës

nuk kanë anëtarët e Akademisë, as ne natyrisht, por t'i hapim këto zyre të mira më shpesh, të jemi prezentë. Vetë prezenca është një gjallëri e jetës akademike. Këto janë detyrat tona, të cilat vlejnjë për të gjithë anëtarët.

Ta mbrojmë këtë institucion autonom dhe të vetmin të pavarur në Kosovë, që është pasuria më e madhe që kemi, ta ruajmë dinjitetin e tij. Autoriteti i Akademisë varet nga puna dhe sjellja jonë. Me çdo çmim të mënjanohen ndikimet e jashtme, partiake dhe politike. Nëse nuk mund t'i sjellim dobi dhe favore Akademisë, duke hedhur çdo ditë nga një gur në të mirën e saj, bile mos t'i bëjmë dëm, duke hequr nga një gur. Edhe kjo është pozitive. Por të jemi të përgatitur për të gjitha.

Edhe pse Akademia me ligj është institucion këshillues dhe sugjerues, ajo nuk është konsultuar për asgjë, por ajo nuk ka qëndruar duarkryq për zhvillimet në shoqëri: me iniciativat e veta është prononcuar dhe ka dhënë opinionet e saj për çështje me interes të përgjithshëm përmes organizimit të tryezave dhe konferencave shkencore, botimit të studimeve, prononcimeve për çështje serioze të zhvillimeve në shoqëri, etj.

Nuk është konsultuar as për hapjen e universiteteve të reja në qendrat rajonale, që u bënë dhe po bëhen më tepër universitete politike, pa kuadër adekuat dhe kushte të tjera. Gati të gjithë anëtarët e Akademisë vijnë nga Universiteti; Akademia sot i ka gjallë tre rektorë, a është pyetur kush për hapjen e universiteteve dhe organizimin e

punës së tyre? Askush, kurrë?! Kishte zëra pse po hesht Akademia, zëra nga jashtë dhe nga brenda, pse nuk po prononcohet për gjendjen aktuale në UP. Thamë jo, sepse, së pari, ajo nuk mund ta marrë rolin e një kontrolli ose të një pushteti në fushën akademike-shkencore dhe artistike, çfarë e kishin akademitë e tipit sovjetik-komunist, përfshirë ASHSH, dhe në anën tjetër ata që e kanë krijuar këtë gjendje, le ta gjejnë edhe zgjidhjen, e ai është faktori politik. Por edhe reagimet ndaj gjendjes atje ishin politike; kushmos në ato protesta!

Involvimi i politikës në UP dhe abuzimi i rëndë i saj me UP-në për një kohë të gjatë nuk lë vend për një zgjidhje të shpejtë e të lehtë. Por le ta gjejnë aktorët që janë futur thellë aty. Të përzihet Akademia në stilin e arbitrit në momentin më të mjegulluar ku faktorët politikë ishin involvuar gjatë kohë do të ishte gabim i madh. Akademia e ka pasur dhe e ka gatishmërinë të sugjerojë, të këshillojë, të ndihmojë, nëse e kërkojnë faktorët relevantë brenda dhe jashtë UP-së.

Por situata e nderë në UP nga grupe e qarqe të caktuara dëshirohet të bartet në Akademi për interesa të caktuara dhe për qërim hesapesh. Në disa raste, përfshirë Kuvendin e Kosovës, ndonëse UP-ja ishte në rend dite, më shumë flitej për Akademi pa asnjë argument dhe pa asnjë shkas se sa për gjendjen në UP-në, që ishte edhe pikë e rendit të ditës. Akademia është e qetë dhe punon sipas Ligjit, Statutit, akteve të tjera juridike dhe natyrisht përvojës së saj gati katërdekadëshe. Kemi investuar shumë

në raportet e mira midis nesh dhe ato janë të shkëlqyeshme. Mirë është të mos pajtohemi mes vete në çështjet e natyrës së punës. Mospajtimi këtu del vetëm produktiv. Ta flakim oportunizmin në Seksione, në Kryesi, në Kuvend. Gjithmonë mund të punohet edhe më tepër. Një përgjigje u kemi dhënë edhe këtyre që i bëjnë llogaritë pa hanxhinë dhe do t'ua japim.

Përveç shpifësit dhe akuzuesit kujdestar shumëvjeçar, mjerisht anëtar i kësaj shtëpie, që i gëzon të gjitha privilegjet, akuzat më të rënda deri tash Akademisë ia drejtoi Kryeministri. Ka çka thuhet për këtë Qeveri dhe qeverisje, por për hir të proceseve dhe interesave madhore kemi heshtur, e kemi ruajtur.

Shërbimi ynë profesional-administrativ në bazë të dokumentacionit që posedon tregoi se si janë pranuar Tito e Sinani, se si kurrë nuk ka pasur propozim për Rrahman Morinën, siç thekson Kryeministri, duke kërkuar përjashtimin e tyre. Historia e Akademisë është kjo që është dhe do të ishte ahistorike, antishkencore dhe anticivilizuese vetëm të mendohet të revidohet historia; ta përjashtojmë ne Titon? Të bëhemi hor para botës? Jo! I kanë pranuar rrethanat e kohës. Shikuar nga perspektiva e kohës, pranimi i Titos ndoshta do të kishte qenë një privilegj për Kosovën. Lehtë është të flitet sot. Sinani ka hyrë si shkrimtar, ani pse ishte kryetar i KK të LK së Kosovës. E kanë votuar shqiptarët dhe serbët. Janë emrat.

Në dokumentet e Akademisë është pasqyruar shumë drejt historiku i saj. Aty janë edhe anëtarët e kombësive joshqiptare, serbë e malazezë, me

fotografi dhe CV, të mirë apo të këqij, përfshirë edhe kryetarin dymandatësh të saj Vuk Filipoviqin. Kur t'i vëmë portretet, do jetë edhe i V. Filipoviqit. Institucioni i së vërtetës, i shkencës, çfarë jemi, ndryshe edhe nuk duhet të sillet. Nuk bëjmë si UP-ja: dy korniza të zbrazëta për dy rektorët serbë: Çollakoviqi dhe Balosheviqi!

Ndërsimet, denigrimet dhe gënjeshttrat në adresë të Akademisë po shtohen nga shumë qarqe. Do shtohen edhe më shumë, tash është në diskutim Ligji për Akademinë si rast për të ndërhyrë, e mendojnë individë e klane, vijne zgjedhjet, rriten interesat e individëve për të hyrë në Akademi, të klaneve apo grupeve, rriten meritë etj. Ju kujtohet viti 2012 me qindra e qindra shkrime e prononcime kundër ASHAK-ut, sepse ishin zgjedhjet. Mbaruan zgjedhjet, u heshtën pak, tash po afrohen zgjedhjet, po diskutohet Ligji, agresiviteti po shtohet.

Ka anëtar të Akademisë, që me vite të tëra e nxit fushatën antiakademi, i mbështetur nga segmente të caktuara të pushtetit, njeriu i cili më se 14 vjet nuk e ka shkelur pragun e Akademisë, vetëm shanë e shpif, por këtu e merr shpërblimin rregullisht: 1050 euro! Ditën që mbahej mbledhja e Kuvendit për UP-në, ky njeri del me një seri gënjeshttrash e shpifjesh në gazeta kundër Akademisë me kërkesë deri në shkatërrimin e saj. Nuk është problem pse shpifësi dhe linçuesi sillet kështu, por shqetësuese është kur një deputet kërkon që ai tekst të deponohej në shërbimet e Kuvendit si platformë veprimi, e ky deputet, që ka pushtet më

të madh në Kosovë, e sulmon Akademinë pse nuk po prononcohet për UP-në, ama në favorin e klanit të tij etj. Dhe kërkesa e tij ishte të ruhet statuskuoja në UP – sepse ai e ka autonominë, ndërsa të hyjmë atje ku po synojmë - në ASHAK! Ai deputeti tjetër, kujdestar i Ligjit për Akademinë, me vite gënjen për Akademinë, sidomos për Seksionin e Shkencave të Natyrës. Por atë ditë del në shesh një koordinim. Thoshin UP-ja e ka autonominë dhe atje zgjidhen problemet, ndërsa duhet të ndërhyhet në Akademi! Atje ka parregullësi në zgjedhje e avancime!

Ne e kemi në Statut të Akademisë, në nenin 32, alineja 1, që thotë: "Të qenit anëtar i Akademisë është i përjetshëm", ndërsa alineja 4 thotë: "Të qenit anëtar i Akademisë pushon: me kërkesën nga vetë anëtar i Akademisë; me vendimin e Kuvendit të Akademisë për shkak të cenimit të rëndë të dinjitetit të Akademisë". Ky cenim i rëndë ka mbetur i relativizuar dhe i pazbërthyer. A ka cenim më të rëndë të dinjitetit të këtij institucioni që njeriu që i gëzon të gjitha privilegjet si anëtarët aktivë vetëm shpif e denigron shtëpinë që e ushqen, e të mos ketë kurajon intelektuale dhe qytetare të jep dorëheqje, të thotë se në atë institucion ku nuk ka shkencë, ku nuk ka punë, ku ka vetëm veprime politike e partiake, ku ka vetëm komunistë, hajna e spiuna të Serbisë – po tërhiqem! Të tillët mund t'i nxjerrim nga përbërja e punës dhe t'ia ndalim edhe shpërblimin. Këtë mund ta bëjmë dhe ndoshta do ta bëjmë një ditë; ka bërë kjo Akademi me të njëjtën dispozitë në vitin 1979 me Bogumil Hrabakun, një historian i

shquar, por i keq si njeri, pikërisht pse ka munguar mbi një vit dhe ka shpifur në adresë të Akademisë. Nuk po hapim debat për këtë, por ama të reflektojmë pak të gjithë. Akademi jemi të gjithë. Ta ruajmë këtë shtëpi apo ta lëmë të përbalteset. Çdo gjë ka një kufi.

Anëtarët e Akademisë mund të kenë angazhime jashtë saj, pse jo, në tubime, në jetën shoqërore, që është një imazh i mirë për Akademinë, por le t'i kryejnë punët në Seksione dhe në Akademi, ama edhe ta mbrojnë Akademinë kudo që janë. Ata janë të lirë dhe autonomë, si intelektualë që kanë një status të lartë akademik dhe shoqëror, të pronocohen për gjithçka, por jo në emër të Akademisë.

Ne që i kemi marrë përgjegjësitë ta drejtojnë këtë themelatë (Kryesia e ngushtë dhe Kryesia e gjerë), nëse nuk i kryejmë obligimet e përcaktuara me Ligj dhe Statut dhe nuk u themi jo çështjeve të palejueshme në Seksion, në Kryesi, në Kuvend vetëm i bëjmë dëme Akademisë. Ju keni të drejtë të kërkonti përgjegjësi nga ne. Ndërsa ky treshi (kryetari, nënkryetari dhe sekretari i përgjithshëm) ka përgjegjësi edhe më të madhe. Akademinë duhet ta ketë punë primare, jo të dorës së dytë apo të tretë. Tash të gjitha seksionet dhe Akademia kanë forca të reja, le t'i marrin përgjegjësitë. Pse bëme përpjekje kaq të mëdha për pranimin e numrit më të madh të anëtarëve të rinj – këtë e bëme për përtëritjen dhe perspektivën e saj. Le të mbështeten ata që punojnë. Por këtë çështje për sot po e lëmë me kaq, sepse e kemi ceremoninë për nder të 17

Shkurtit të Madh 2008.

Kolegë të nderuar, ishte ky një raportim i shkurtër për punën e bërë. Gati të gjitha dhe më në detaje i keni në materiale. Materialet janë një indormacion. Mos të kapemi për një a dy fjalë, për një a dy formulime, që mund të mos jenë të qëlluara, gjithmonë ka edhe të paqëlluara, por të kapemi për probleme atje ku ka nevojë. Fola shumë, fola edhe për ju. Ju faleminderit’.

Tash, urdhëroni, a keni diçka rreth fjalës sime? Duket jo. Ju faleminderit!”

Ad. 2. -

Në vazhdim u shqyrtua Raporti i punës së ASHAK-ut për vitin 2013 sipas radhës, duke filluar nga Kuvendi, Kryesia, seksionet e deri te raporti i punës së Shërbimit Administrativ, Profesional dhe Teknik të Akademisë.

Raporti mbi punën e Kuvendit u miratua pa vërejtje, sikurse edhe raporti për punën e Kryesisë. U miratuan gjithashtu edhe raportet e seksioneve të Akademisë, si dhe Raporti i punës së Shërbimit Administrativ, Profesional dhe Teknik të ASHAK-ut.

Raporti përmbledhës i miratuar i punës së ASHAK-ut për vitin 2013 është pjesë përbërëse e këtij procesverballi. Raporti do të botohet në “Vjetari” 2013.

Ad. 3. -

Kuvendi miratoi edhe Raportin financiar të ASHAK-ut për vitin 2013, i cili është pjesë përbërëse i këtij procesverballi.

Ad. 4. -

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës Besim Bokshi duke përkrahur në tërësi fjalimin e Kryetarit, propozoi që ky fjalim domethënës dhe përmbytjesor të publikohet i plotë në medie. Diskutuan edhe Nexhat Daci dhe Mehmet Kraja. Në diskutimin e tij N. Daci propozoi që tani e tutje para mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Akademisë të mbahet konferencë me gazetarë, ashtu që të shihet puna e Akademisë, ndërsa Mehmet Kraja propozoi që Akademia të caktojë një punonjës si zëdhënës të saj.

Mbledhja u mbyll në orën 12:30.

Procesmbajtës

Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Hivzi Islami

PROCESVERBAL

Nga mbledhja LXXXII e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 2 korrik 2014 në orën 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Ekrem Murtezai, Engjëll Berisha, Eqrem Basha, Feriz Krasniqi, Fejzullah Krasniqi, Hivzi Islami, Idriz Ajeti, Isuf Krasniqi, Latif Susuri, Mark Krasniqi, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Nexhat Daci, Pajazit Nushi, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Tahir Emra, Zeqirja Ballata dhe anëtarët korrespondentë: Arsim

Bajrami, Arsim Morina, Edi Shukriu, Jusuf Bajraktari, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Qamil Haxhibeqiri, Ruzhdi Pllana, Salih Gashi, Xhevdet Xhafa.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi Hivzi Islami, kryetar.

Kuvendi e miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXXI të Kuvendit;

2. Miratimi i Programit të punës së ASHAK-ut për vitin 2015;

Ad. 1. -

Procesverbali i mbledhjes LXXXI të Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Ad. 2. -

Pas miratimit të procesverbalit kryetari Islami në fjalën e tij tha:

“Kolegë të nderuar,

Mirë se vini në Mbledhjen e 82-të të Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me rendin e ditës që e keni marrë dhe materialet që u janë shpërndarë me kohë. Vetëm dy veta kanë njoftuar se për shkaqe shëndetësore nuk mund të vijnë në mbledhje të Kuvendit, akad. Besim Bokshi dhe akad. Esat Stavileci. Të tjerë nuk janë lajmëruar në Sekretari.

Pas miratimit njëzëri të rendit të ditës, u kalua në pikën e parë: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXXXI. Pas

miratimit të procesverbalit u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës: shqyrtimi dhe miratimi i Programit të punës së ASHAK-ut për vitin 2015, si pikë qendrore e kësaj mbledhje të Kuvendit.

Të nderuar kolegë, para se të kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin e Programit të punës së ASHAK-ut sipas seksioneve për vitin 2015, më lejoni t'i them disa fjalë. Programi i punës për vitin 2015, që e kemi sot për shqyrtim dhe aprovim, së pari ka kaluar nëpër katër seksionet dhe pastaj seksionet ia kanë përcjellë Kryesisë. Kryesia me shumë kujdes i ka shqyrtuar propozimet dhe kërkesat e seksioneve, diçka ka hequr, diçka ka shtuar, diçka ka riformuluar, krejt në përputhje me aktet tona normative, me kërkesat e auditorit dhe veçanërisht me gjendjen financiare për veprimtarinë e Akademisë.

Programi i punës për këtë vit (2014) është shumë i mirë, ambicioz në të gjitha pozicionet, por ka ngecje në dinamikën e realizimit të tij dhe nuk mund të themi se jemi të kënaqur.

Sivjet nga 14-15 dorëshkrime, të parapara me Program, deri tash janë dorëzuar për shtyp 3-4, nga 5-6 tubime, tryeza, konferenca është mbajtur vetëm një, nga 5-6 projekte vetëm në dy po punohet, nesër e kemi një aktivitet artistik: "Koncert veprash vokalo-pianistike". Por nuk ka asnjë ekspozitë, edhe pse disa janë paraparë. Është e vërtetë se jemi në gjysmën e vitit, ka kohë ende, deri më 31 dhjetor, po jo shumë nga se dy muaj (korriku dhe gushti) janë relativisht pasivë. Vërsulja vjen në shtator, tetor e nëntor, kur mbyllet zotimet. Atëherë nuk kemi

as shtrirje të duhur të harxhimeve të mjeteve, gjë që na vihet në barrë si menaxhim jo i mirë.

Prej nesh kërkohet punë dhe përgjegjësi dhe autoriteti i Akademisë varet nga ne, këtë e kemi thënë sa e sa herë. Nuk jemi si përpara as financiarisht e as me hapësirë. Po u jap disa shifra: buxheti i Akademisë e ka kaluar një milionshin, buxheti sot është 1.052.000 euro bruto. Ndarja nuk është e volitshme, sepse pjesa më e madhe shkon në të ardhura personale.

Transha mujore për paga nga 1 prilli është 68.000 euro bruto ose 56.000 euro neto, që nënkupton se për 12 muaj janë rreth 800.000 euro bruto ose gati 80% shkon në të ardhura personale. Me ngritjen e të ardhurave nga 1 prilli 2014 në nivel vendi, pozita materiale e anëtarëve të Akademisë dhe të gjithë punonjësve është përmirësuar dukshëm: anëtarët e rregullt kanë shpërblimin 1.308 euro, me korrespondencë në pension 1.177 dhe me korrespondencë aktivë 1.119 euro.

Rregullisht paguhen shtesat funksionale, honorari i autorëve, recensentët, redaksitë, redaktorët, paguhet puna në Fjalorin Enciklopedik në të gjitha nivelet etj. Në disa raste hiqen edhe shpenzimet për pjesëmarrje në tubime shkencore, në aktivitete artistike etj. Për nevoja urgjente të anëtarëve, përfshirë edhe ato familjare, makina është në dispozicion për ata që nuk kanë makina dhe janë të shtyrë në moshë.

Por është përkeqësuar situata financiare për punë shkencore dhe

artistike (për botime, projekte, tubime shkencore, tryeza, konferenca, bashkëpunim ndërkombëtar etj.). Sepse është reduktuar pozicioni "Shërbime dhe mallra", në të cilin mbështetet veprimtaria e Akademisë: nga rreth 400.000 euro sa i kemi pasur nga ky pozicion në fillim të vitit, rreth 70.000 euro na u kanë hequr me automatizëm, me vendim qeveritar, sikurse të gjithë organizatave buxhetore. Me këtë minus do të hymë edhe vitin e ardhshëm. Kush merret në këtë muaj me rebalans, në këtë mish-mash politik?

Prandaj viti 2015 do të jetë një vit jo i lehtë financiar. Akademisë do t'i duhet një menaxhim shumë i mirë, një racionalitet dhe një prioritet në akti-vitetin tonë shkencor, artistik dhe profesional. I kemi disa kriteret për përcaktimin e listës prioritare të veprimtarisë sonë, të cilat duket se do të jemi të shtrënguar t'i aplikojmë vitin e ardhshëm. Kriteret janë miratuar nga Këshilli Redaktues dhe Kryesia e Akademisë e dt. 28. 10. 2008 dhe të aprovuara në Kuvendin e ASHAK të dt. 30. 6. 2010. Do të jemi të detyruar t'i zbatojmë. Këto kriteret janë:

1. Dorëshkrimet apo pikat artistike që janë të përfshira në programin e punës;

2. Dorëshkrimet e përfunduara, të gatshme për botim, pikat artistike të gatshme për realizim;

3. Dorëshkrimet apo pikat artistike të anëtarëve të Akademisë;

4. Përpjesëtimi i përfshirjes së Seksioneve dhe

5. Përpjesëtimi i përfshirjes së autorëve.

Në këtë situatë financiare duhet t'u

kthehemi edhe donacioneve. I kemi lënë anash. Dikur, në vitet e 90-ta, më të rëndat për Kosovën, kemi pasur shumë donatorë. Po presim vetëm nga Buxheti i Kosovës, sikur jemi bërë komplet parazitë. Ka sot shumë kompani, firma, agjenci, individë të fuqishëm financiarisht, në Kosovë dhe jashtë saj, në diasporë që mund të na ndihmojnë, por duhet të kërkojmë mjete për projekte në kohëzgjatje të ndryshme, për botime ekskluzive, për botimin e completeve, të veprave të anëtarëve tanë, për realizime kulmore artistike etj.

Donacionet janë të ligjshme. Dhurimet lejohen edhe me Ligjin dhe Statutin tonë.

Kërkesat nuk bëhen krejt me letra, të cilave nuk po u përgjigjet askush, por përmes miqve dhe lidhjeve mund të sigurojmë mjete, ashtu siç kemi siguar përpara. Në vitet e 90-ta sistemi i donacioneve ka funksionuar shumë mirë. Në botimin për 30-vjetorin e Akademisë janë shënuar emrat e 87 donatorëve nga të gjitha trojet shqiptare. Me sa di unë, donacionet i kanë sjellë kryesisht prof. Daci, pastaj prof. Ismajli, z. Bylykbashi, ndoshta edhe dikush tjetër.

Disa seksione kanë kërkesa që implikojnë kosto të mëdha financiare, të cilat Akademia nga mjetet e rregullta nuk mund t'i përthekojë: p. sh. botimi i completeve, që mund të kapin shumën 50.000-60.000 euro për komplet, ose për vepra tashmë të botuara, e që gjenden në depot tona, apo i ekspozitave në Evropë, që kapin shuma marramendëse.

Kryesia, si kompetente për këto çështje, i ka shqyrtuar këto kërkesa me

vëmendje dhe ka konkluduar se mund të realizohen vetëm nga donatorët, ku në secilin vëllim ose në aktivitete tjera shënohet emri dhe mbiemri i donatorit, nëse janë disa, emrat e secilit shënohen në vëllimin e caktuar. Dera mbetet e hapur: të sigurohen mjetet, fillon puna. Atëherë me mjete nuk do të kemi problem. Akademia ndihmon me aq sa mundet, por nuk mund të hymë në obligime pa mbulesë dhe nuk mund ta reduktojmë aktivitetin e seksioneve tjera ose edhe pikat e tjera të aktiviteteve brenda vetë atyre seksioneve. Çështja është e hapur, me donacione kryejmë punë. Kryesia e Akademisë është për të marrë edhe vendime të këtilla.

Tash, para se të shkojmë në shqyrtimin e programeve nëpër seksione, ju pyes a ka dikush të thotë diçka parimisht.

Ju falemnderit!”

Pas fjalës së Kryetarit, diskutoi Nexhat Daci, i cili lidhur me pikat e propozuara të Seksionit të Arteve tha se do të ishte mirë që ato të kenë arsyetime më të gjata dhe më të plota, ashtu që të jenë të kuptueshme edhe për ata që nuk i përkasin fushës së arteve. Ai po ashtu diskutoi lidhur me bashkëpunimin me ASHSH-në dhe tha se viteve të fundit ky bashkëpunim nuk po ecën mirë dhe e gjithë kjo jo për fajin tonë, sepse ne gjithnjë kemi iniciuar aktivitete, por nga ana e tyre nuk ka pasur gatishmëri. Ai propozoi që Akademia jonë të ftojë akademikë të të gjitha fushave dhe të mbahen ligjëratat që parashihen në Programin e punës.

Njëherësh ai propozoi që me rastin e 40-vjetorit të themelimit të ASHAK të ftohen për të mbajtur ligjëratat akademikë dhe profesorë nga Shqipëria dhe njerëz të shquar nga mërgata.

Pas këtij diskutimi fjalën e mori sekretari i Seksionit të Arteve, z. Ballata i cili tha se pajtohet plotësisht me kërkesën e akademik Dacit lidhur me arsyetimet e Programit të punës dhe u zotua se do ta plotësojë atë dhe do t’ia dorëzojë Shërbimit Profesional, Administrativ të Akademisë. Ndërsa sa i përket bashkëpunimit me ASHSH ai tha se do të ishte mirë që një grup nga Seksioni i Arteve të realizojë një takim atje me qëllim të thellimit të bashkëpunimit edhe në fushën e arteve.

Kryetari Islami në vazhdim tha se nga Akademia jonë gjithnjë ka pasur dhe ka gatishmëri për bashkëpunim me ASHSH-në, por vitet e fundit gatishmëria ka munguar nga ana e tyre.

Pas diskutimeve Kuvendi miratoi Programin e punës për vitin 2015, i cili është pasqyruar më lart në pjesën e veçantë të këtij “Vjetari”.

Mbledhja u mbyll në orën 12:30.

Procesmbajtës

Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Hivzi Islami

PROCESVERBAL

Nga mbledhja LXXXIII e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 24 dhjetor 2014 në orën 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Engjëll Berisha, Eqrem Basha, Esat Stavileci, Feriz Krasniqi, Fejzullah Krasniqi, Hivzi Islami, Idriz Ajeti, Isa Mustafa, Isuf Krasniqi, Latif Susuri, Mark Krasniqi, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Nexhat Daci, Pajazit Nushi, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Tahir Emra, Zeqirja Ballata dhe anëtarët korrespondentë: Anton K. Berishaj, Arsim Bajrami, Arsim Morina, Edi Shukriu, Jusuf Bajraktari, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Qamil Haxhibeqiri, Ruzhdi Pllana, Salih Gashi.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi Hivzi Islami, kryetar.

Kuvendi e miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXXII të Kuvendit;
2. Emërtimi i Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë;
3. Votimi për zgjedhjen e Kryesisë dhe shpallja e rezultateve të votimit;

Ad. 1. -

Procesverbali i mbledhjes LXXXII i Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Pas miratimit të procesverbalit kryetari

Islami në fjalën e hapjes tha:

“Kolegë të nderuar,

po e hapi mbledhjen LXXXIII të Kuvendit të ASHAK, me rendin e ditës që e keni marrë me kohë. Para se të procedojmë me rendin e ditës, duhet ta vërtetojmë kuorumin. Kuvendi i ka 36 anëtarë, njëri (Rexhep Qosja) hiqet në bazë të Statutit të Akademisë, neni 34 (pikat 13 e 14) pasi nuk merr pjesë në asnjë aktivitet të Akademisë për shumë vjet, ndërsa mungojnë pa arsye tre anëtarë të tjerë (Ekrem Murtezai, Zejnullah Rrahmani dhe Xhevdet Xhafa). Dy kuvende i kemi në vit, një kuvend zgjedhor për anëtarët e rinj në 4 vjet dhe një kuvend tjetër për zgjedhjen e udhëheqjes së Akademisë në 3 vjet. Të mos marrësh pjesë pa arsye edhe në këto mbledhje vërtet nuk ka asnjë kuptim.

Pika qendrore e këtij Kuvendi sot është zgjedhja e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë. Siç e dimë të gjithë, në fund të nëntorit hymë në proces të zgjedhjes së udhëheqjes së Akademisë, i mbajtëm dy rrrathë të votimeve nëpër seksione, të parin më 26 dhe 27 nëntor dhe të dytin më 3 dhe 4 dhjetor. Procesi kaloi shumë mirë, krejt në mbështetje të akteve tona normative, të eksperiencës që kemi në këtë drejtim dhe në frymën kolegjiale. Votimi ishte i fshehtë.

Para aktit të votimit nëpër seksione është hapur edhe debat për kandidatë të mundshëm dhe është votuar *pro* dhe *contra*. Pas rrethit të dytë rezultati është ky që ka arritur sot këtu. Kryesia e ka miratuar këtë rezultat, sepse nuk ka pasur asnjë vërejtje. Sot jemi në proces të votimit, në një proces tepër të decentralizuar dhe

demokratik rrethohen kandidatët që i dëshirojmë. Respektohet vullneti dhe normat ligjore, por edhe eksperiencia e zgjedhjeve të mëhershme. Nëse e shohim të arsyeshme mund dhe të debatojmë.

Sikurse herën e kaluar, për tri funksionet (Kryetar, nënkryetar dhe sekretar të përgjithshëm) do të votojmë veç e veç, ndërsa për sekretarë të seksioneve do të bëhet verifikimi gjithashtu konform akteve tona normative.

Para se të procedojmë me votimin duhet ta zgjedhim Komisionin verifikues. Ne kemi një propozim, nëse e miratoni, të jenë akademikët Ali Aliu, Feriz Krasniqi dhe Rexhep Ferri. Natyrisht, bashkë me ta për ndihmë procedurale-administrative është edhe sekretarja, znj. Pula.

Për gjithçka që lidhet me procedurën juridike dhe tekniko-administrative na jep sqarime të duhura sekretarja”.

Më pas znj. Pula njoftoi Kuvendin se në sallë janë të pranishëm 32 anëtarë, kuorum ka dhe Kuvendi mund të vazhdojë punën. Ajo më pas dha shpjegime për procedurat e zgjedhjeve për kandidatët për kryetar, nënkryetar dhe sekretar të përgjithshëm të Akademisë dhe për verifikimin e zgjedhjes së sekretarëve të seksioneve. Ajo tha se bazuar në Rregulloren mbi propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së ASHAK, për të gjitha funksionet konsiderohet i zgjedhur kandidati që ka fituar shumicën e votave të anëtarëve që e përbëjnë kuorumin e Kuvendit. Konsiderohet i zgjedhur kandidati që fiton 18 vota.

Ad. 2. -

Kuvendi i Akademisë emëroi

Komisionin e zgjedhjeve me këtë përbërje: Ali Aliu, kryetar dhe Feriz Krasniqi e Rexhep Ferri, anëtarë. Komisioni i zgjedhjeve është përgjegjës për rrjedhën e rregullt të zgjedhjeve dhe numërimin e votave.

Ad. 3. -

Komisioni i zgjedhjeve i përgatiti dhe i shpërmdau fletëvotimet për zgjedhjen e kryetarit, nënkryetarit dhe të sekretarit të përgjithshëm të Akademisë. Pas votimit me vota të fshehta, Komisioni i votimeve u tërhoq, i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këto rezultate:

Për zgjedhjen e Kryetarit të Akademisë kanë votuar 32 anëtarë të ASHAK-ut. Janë gjetur 28 fletëvotime të vlefshme dhe 4 të pavlefshme.

Kandidati Hivzi Islami ka marrë 28 vota dhe është zgjedhur kryetar i Akademisë për mandatin e ardhshëm 3-vjeçar.

Për zgjedhjen e nënkryetarit të Akademisë kanë votuar 32 anëtarë të ASHAK-ut. Janë gjetur 32 fletëvotime të vlefshme.

Pajazit Nushi ka marrë 20 vota.

Zeqirja Ballata ka marrë 12 vota.

Kandidati Pajazit Nushi ka marrë numrin e nevojshëm të votave dhe është zgjedhur nënkryetar i Akademisë për mandatin e ardhshëm 3-vjeçar.

Për zgjedhjen e sekretarit të përgjithshëm të Akademisë kanë votuar 32 anëtarë të ASHAK-ut. Janë gjetur 31 fletëvotime të vlefshme dhe 1 i pavlefshëm.

Isuf Krasniqi ka marrë 24 vota.

Rauf Dhomi ka marrë 7 vota.

Kandidati Isuf Krasniqi ka marrë numrin e nevojshëm të votave dhe është zgjedhur sekretar i përgjithshëm i Akademisë për mandatin e ardhshëm 3-vjeçar.

Kuvendi i Akademisë gjithashtu verifikoi zgjedhjen e:

- Akademik Eqrem Bashës, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe Letërsisë;

- Anëtar korrespondent Jusuf Bajraktarit, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore;

- Akademik Fejzullah Krasniqit, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës;

- Anëtar korrespondent Luan Mulliqit, sekretar i Seksionit të Arteve.

Pas shpalljes së rezultateve, në emër të të zgjedhurve u falënderua kryetari akademik Hivzi Islami, i cili tha:

“Kolegë të nderuar,

në emër të udhëheqjes së re, ju falënderoj shumë të gjithëve. I falënderoj edhe ata që na votuan, por edhe ata që nuk na votuan. Edhe kjo vota e fundit është një votë demokratike, sepse procesit i jep një kolorit të mirë dhe e begaton demokracinë e brendshme të Akademisë. Për disa funksione patëm edhe kundërkandidatë.

Udhëheqja e ngushtë e Akademisë: kryetari, nënkryetari dhe sekretari i përgjithshëm, me votën e lirë, mbetën

këta që janë, prandaj do ta kemi një kontinuitet në punë. Me votën tuaj ju e çmuat, e vlerësuat punën tonë. Ne, bashkë me Kryesinë e plotë dhe me gjithë ju, punuam sipas ligjit, Statutit dhe akteve tjera, por edhe eksperiencës së gjatë akademike tashmë 40-vjeçare.

Me besimin që na i dhatë sot, ne marrim përgjegjësi edhe më të mëdha që ta drejtojmë me sukses këtë themelatë. Nëse nuk i kryejmë obligimet e përcaktuara me Ligj dhe Statut ju keni të drejtë të kërkonit llogari nga ne. Ndërsa ky treshi ka përgjegjësi edhe më të madhe.

Akademia është institucion autonom dhe pothuajse i vetmi i pavarur dhe i papolitizuar në Kosovë, kjo është pa dyshim pasuria më e madhe që kemi. Autoriteti i i tij varet nga puna dhe sjellja jonë. Me çdo çmim duhet të vazhdojmë t'i mënjanojmë ndikimet e jashtme partiake dhe politike. Kurrë nuk duhet të lejohet që Akademia ta marrë rolin e partisë politike apo të bëhet si Akademia Serbe që t'u bëjë dëme të mëdha popujve të tjerë dhe kulturave të tyre dhe në fund edhe vetë popullit tonë dhe ta urrejë gjithë bota përparimtare. Është institucion i së vërtetës dhe e ka rolin e vet të përcaktuar me Ligj – institucion këshillues dhe sugjerues. Nëse e kërkon shteti, shoqëria, ajo është aty. Para luftës kemi dalë shumë në opinion, sikundër edhe deri te pavarësia. Tash janë institucionet shtetërore: legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, me infrastrukturën e tyre.

Akademia nuk mund të bëhet kujdestar për gjithçka, siç mendon një pjesë e opinionit më tepër mediatik. Del një problem që lidhet me jetën e përditshme, ku është Akademia; bëhet një

hallakamë diku, pse nuk prononcohet Akademia; nuk merren vesh partitë politike në mes vete për diçka, po hesht Akademia; bëhen abuzime të ndryshme në shoqëri, pse nuk ndërhyt Akademia etj.

Këtë mandat 3-vjeçar punuam në rrethana relativisht të volitshme financiare, hapësirë etj. në raport me kushtet e mëhershme dhe shënuam rezultate evidente në produktionin tonë. Nxorëm shumë botime shkencore dhe monografi artistike, mbajtëm tryeza e konferenca shkencore, realizuam dhe po realizojmë projekte, vazhduam me hapjen e Akademisë ndaj institucioneve akademike dhe shkencore evropiane, e afirmuam Kosovën dhe kulturën shqiptare, gjithnjë në përputhje me mundësitë tona etj.

Tash i kemi rreth 20 botime shkencore dhe artistike, që dolën kryesisht këtë vit, disa vijnë këto ditë. Këto botime dhe të tjerat para tyre, të papromovuara, menduam t'i përuarim para vitit të ri, por u vonuan autorët. Përuarimi i tyre në grup do të bëhet pas vitit të ri.

Në këtë periudhë, nga 1 janari 2012 u ngritën të ardhurat goxha mirë; u pagua puna krijuese në të gjitha nivelet; rregullisht janë paguar shtesat funksionale, honoraret e punës shkencore-profesionale dhe artistike, recensentët, redaktorët e botimeve dhe redaksitë e revistave, autorët e punimeve në revista dhe puna në Fjalorin Enciklopedik në të gjitha nivelet etj. Ky stimulim na obligon që të punojmë edhe më tepër.

Arritëm t'i forcojmë Shërbimet profesionale, administrative dhe teknike

me kuadro të përgatitura: kontabilitetin, zyrën e prokurimit, zyrën e mbështetjes profesionale dhe bibliotekën. Zatën, pa këto instanca nuk funksionon kjo themelatë. Këtë vit besojmë shumë që do të miratohet Ligji për Akademinë dhe pastaj edhe aktet tjera normative, që i kemi të vjetruara.

Në qoftë se nuk hapen zyrat tona me javë dhe me muaj, përgjegjës jemi ne vetë. Mos ta konsiderojmë Akademinë vetëm si burim të privilegjeve, por si shtëpi të dytën, ku bëhet punë produktive për institucionin, për dijen dhe shoqërinë.

Tash do të shkojmë në një drekë dhe për këtë i kemi disa arsye: e para e kemi bërë traditë dhe këtë duhet ta kultivojmë; e dyta shkojmë për nder të tre anëtarëve tanë (akademikët Idriz Ajeti, Mark Krasniqi dhe Ali Aliu) që u dekoruan nga Presidenti i Shqipërisë Bujar Nishani me çmimin "Nderi i Kombit"; dhe e treta që akademik Nexhat Daci u zgjodh anëtar i rregullt i Akademisë Evropiane të Shkencave me seli në Salsburg të Austrisë. Urime të gjithëve. Kjo drekë, natyrisht, përputhet edhe me festat e fundvitit.

Ju falemnderit!

Mbledhja u mbyll në orën 12:30.

Procesmbajtës

Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Hivzi Islami

KRONIKA E VITIT 2014

(Aktivitete shkencore, ekspozita, vizita, përvjetorë, ligjërata, përrurime...)



ASHAK NDAN PËR HERË TË PARË SHPËRBLIMIN MBËSHTETËS 2014

Më 10 shkurt 2014, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u mbajt ceremonia solemne e ndarjes së Shpërblimit mbështetës 2014.

Fjalën e hapjes me këtë rast e mbajti Kryetari i Akademisë, akademik Hivzi Islami, i cili ndër të tjera tha:

“Jemi mbledhur sot në mjediset e Akademisë për një rast të veçantë për të cilin nuk jemi tubuar asnjëherë në historinë tashmë katërdekadëshe të kësaj themelate. Jemi këtu për ta shpallur një çmim që e ka themeluar Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, të cilin e ka emërtuar “Shpërblimi mbështetës 2014” dhe u jepet kandidatëve të moshës së re që kanë arritur rezultate të larta, të veçanta në fushën e shkencës dhe të artit. Ky çmim do të

jetë tradicional dhe do të jepet në fillim të çdo viti. Fondi për këtë shpërblim krijohet nga donacionet.

Tashmë një kohë të gjatë Kryesia e Akademisë përgatitet për dhënien e këtij çmimi, që ishte nismë e kryetarit të mëparshëm, akademik Besim Bokshit, i cili besonte se përmes një forme tjetër financiare do ta jepte çmimin. Por kjo nuk u realizua për disa arsye. E falënderoj shumë për idenë dhe përpjekjet e tij.

Në mbledhjen e saj të 31 dhjetorit 2013, Kryesia e themeloi këtë çmim dhe më 22 janar 2014 e shpalli konkursin publik për këtë qëllim. Në konkurs u paraqitën katër kandidatë nga fusha të ndryshme të shkencave dhe të arteve. Kryesia në mbledhjen e vet të mbajtur më 31 janar 2014 ka caktuar Komisionin vlerësues në përbërje kryetari i Akademisë Hivzi Islami, akademik Tahir Emra dhe anëtari korresp. Qamil Haxhibeqiri.

Komisioni pasi e shqyrtoi dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur dhe në përputhje me kushtet e kërkuara me konkurs, përzgjedhi për laureat të çmimit “Shpërblimi mbështetës 2014” dr. Qëndrim Gashin, profesor i asocuar në Departamentin e Matematikës të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore të UP-së. Si një shfaqje e re

në jetën tonë arsimore e shkencore, dr. Qëndrim Gashi në moshën 18-vjeçare u diplomua në Departamentin e Matematikës të FSHMN-së, që ishte një përjashtim në Kosovë dhe më gjerë, dhe në moshën 23 vjeçare u doktorua në Universitetin e Çikagos të SHBA-së. Në punën e tij arriti rezultate shumë të larta, të veçanta në fushën e shkencës, konkretisht të shkencës së matematikës. Për realizimet e tij në këtë fushë u bë i njohur në botën e shkencës në të katër anët e globit.

Vlera materiale e "Shpërblimit mbështetës 2014" është 3.000 euro. Ky është donacioni i parë që vjen nga kompania Ing. Office, Sh P K., Gjilan, me përfaqësuesin inxh. Mejdi Rexhepi në krye, i cili është këtu dhe në emër të Akademisë e falënderoj shumë. Shpërblimi i dhënë mbi bazë të këtij donacioni mendojmë se është një simbolikë e fuqishme, sepse përmes tij, kjo themelatë si më e larta e shkencës dhe e artit në Kosovë, ia njeh punën dhe meritat një të riu pa i mbushur të 30-tat, për atë që ka arritur deri më sot në fushën e shkencës dhe e motivon për punë të mëtutjeshme produktive në shkencë, në këtë rast në shkencën e matematikës. Por ky shpërblim është një privilegj edhe për Akademinë që iu dha mundësia, në saje të donacionit në fjalë, ta laureojë një të ri me këto kualitete.

Raportin vlerësues për punën dhe rezultatet e arritura të dr. Qëndrim Gashit në shkencën e matematikës do ta paraqesë anëtari korrespondent

dr. Qamil Haxhibeqiri, anëtar i komisionit dhe profesor e bashkëpunëtor i laureatit Gashi".

Në fjalën e tij anëtari korrespondent Qamil Haxhibeqiri pasi paraqiti biobilografinë për kandidatin prof. dr. Qëndrim Gashi, ndër të tjera tha:

"Edhe pse i ri në moshë (së shpejti do t'i mbushë 30 vjet), dr. Qëndrim Gashi, pa dyshim, është një punëtor i mirëfilltë shkencor. Me aktivitetin i tij shkencor e profesional ai e afirmoi shkencën tonë në mënyrën më të denjë në suaza ndërkombëtare. Jemi thellë të bindur që ai e meriton "Shpërblimin mbështetës 2014" që ASHAK-u e ndan për shkencëtarin më të ri dhe më të suksesshëm. Prandaj me kënaqësi e propozojmë që ky shpërblim t'i ndahet dr. Qëndrim Gashit, profesor i asocuar, si mirënjohje për kontributin shkencor dhe si një shtytje për punën e tij të mëtejme shkencore dhe profesionale".

Laureati prof. dr. Qëndrim Gashi në fjalën e tij pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, falënderoi Akademinë për Shpërblimin mbështetës. Ai tha se ndjehet jashtëzakonisht i nderuar dhe i privilegjuar që merr këtë shpërblim nga Institucioni më i lartë i Shkencës dhe i Artit në vend dhe u zotua se do ta mbajë me nder gjatë gjithë jetës dhe veprimtarisë së tij.

MBAHET LIGJËRATA INAUGURUESE E ANËTARIT KORRESPONDENT SALIH GASHI

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, më 13 shkurt 2014 organizoi ligjëratën inauguruese të anëtarit korrespondent Salih Gashit me temën: “Proceset membranore dhe zbatimi i tyre”.

Fjalën e hapjes më këtë rast e mbajti sekretari i Seksionit të Shkencave të Natyrës akademik Fejzullah Krasniqi.



AKADEMIK HIVZI ISLAMI DHE ANËTARE KORRESPONDENTE EDI SHUKRIU INAUGUROHEN ANËTARË TË AKADEMISË EVROPIANE TË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE

Më 8 mars 2014 në Asambenë e përgjithshme të Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve (ASAE), me seli në Salcburg të Austrisë u bë inaugurimi solemn i dy anëtarëve të kësaj Akademie, prof. dr. Hivzi Islami, demograf, anëtar i rregullt i ASHAK dhe kryetar aktual i saj, dhe prof. dr. Edi Shukriut, arkeologe, anëtare korrespondente. Akademikët Islami dhe Shukriu në nëntor të vitit 2013 ishin zgjedhur anëtarë të Akademisë

Evropiane të Shkencave dhe të Arteve.



NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT ME AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË MAQEDONISË

Në Prishtinë, më 11 mars 2014 Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Maqedonisë nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit në fushat e shkencave dhe arteve.

Marrëveshja u nënshkrua në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës nga kryetari i ASHAK-ut, Akademik Hivzi Islami dhe kryetari i Akademisë së Maqedonisë Akademik Vlado Kambovski.

Para ceremonisë së nënshkrimit u zhvillua takimi ndërmjet udhëheqjes së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe delegacionit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë.

Kryetari i MANU-së, akademik Vlado Kambovski, shoqërohej nga nënkryetari, akademik Lupço Kocarev, sekretari, akademik Gjorgji Stardellov, dhe akademikët Alajdin Abazi e Luan Starova dhe nga ambasadori i Maqedonisë në Kosovë, H. E. Stojan Karajanov.

Format e bashkëpunimit ndërademik

mes të tjerash do të jenë përmes modaliteteve: takime bilaterale shkencore, simpoziume, konferenca dhe seminare pune, si dhe aktivitete në fushën e arteve që mbulohen nga palët; shkëmbim të shkencëtarëve; shkëmbim të informacioneve dhe publikimeve; mbajtje të ligjëratave dhe aktivitete të tjera nëse është e nevojshme, sipas marrëveshjes ndërmjet të dy palëve.

**ANËTAR KORRESPONDENT ARSIM
BAJRAMI MERR PJESË NË
KONFERENCËN SHKENCORE
NDËRKOMBËTARE NË UNIVERSITETIN
SHTETËROR TË TETOVËS**

Më 11-13 mars anëtari korrespondent Arsim Bajrami ka përfaqësuar ASHAK-un në Konferencën shkencore ndërkombëtare me titull: "Demokracia dhe sfidat e transicionit demokratik", të mbajtur në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

Profesor Bajrami në konferencë ka paraqitur kumtesën me titull: "Sfidat e transicionit në Kosovë".

Kosovës, më 14 mars 2014 u mbajt mbledhja e radhës e Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe. Mbledhja u mbajt nën drejtimin e akad. Rexhep Ismajlit dhe akad. Jani Thomait (bashkëkryetarë), me pjesëmarrjen e akad. Besim Bokshit, akad. Ethem Likajt, akad. Kolec Topallit, akad. Gjovalin Shkurtajt, prof. dr. Shezai Rrokajt, prof. dr. Mehmet Çelikut, prof. dr. Seit Mansakut, prof. dr. Enver Hysës, prof. dr. Tomor Osmanit, prof. dr. Imri Badallajt, prof. dr. Shefkije Islamajt, ligjërues Isa Bajçincës, prof. dr. Bardh Rugovës, prof. dr. Rrahman Paçarrizit dhe prof. dr. Abdullah Zymberit.

Diskutimet u zhvilluan në tri seanca sipas materialeve të parapërgatitura nga grupet e punës për çështje të drejtshkrimit dhe të morfologjisë nga Tirana, si dhe nga anëtari i Këshillit e i kryesisë së tij akademik Kolec Topalli, të diskutuara me shënime të veçanta edhe nga grupet përkatëse nga Prishtina.



**MBAHET NË PRISHTINË MBLEDHJA E
KËSHILLIT NDËRAKADEMIÇ PËR
GJUHËN SHQIPE**

Në mjediset e Qendrës leksikografike-enciklopedike të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të



**MBAHET LIGJËRATA INAUGURUESE E
ANËTARIT KORRESPONDENT ARSIM
MORINA**

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, më 28 mars 2014 organizoi ligjëratën inauguruese të

anëtarit korrespondent prof. dr. Arsim Morinës me temën: "Shkenca e neurokirurgjisë sot".

Fjalën e hapjes me këtë rast e mbajti sekretari i Seksionit akademik Fejzullah Krasniqi.

ANËTAR KORRESPONDENT LUAN MULLIQI NË RUMANI

Më 2-6 prill, anëtari korrespondent Luan Mulliqi, me ftesën e galerisë Triada Timisuara ka marrë pjesë në ekspozitën personale, në të cilën ka paraqitur 20 punime të derdhura në bronz. Ekspozita ka zgjuar interesim si te kritika ashtu edhe te mjetet e informimit dhe të publikut prezent. Profesor Mulliqi po ashtu ka marrë pjesë edhe në tryezën: "Mundësitë e bashkëpunimit kulturor rajonal".

AKADEMIK EQREM BASHA NË TUBIMIN E ALLEA-s.

I deleguar nga ASHAK, akademik Eqrem Basha ka marrë pjesë në tubimin e ALLEA-s (All European Academies) në Bruksel, më 8-10 prill 2014. Ai është takuar me përfaqësues të Akademisë Mbretërore Flamane, me të cilët Akademia jonë ka marrëveshje bashkëpunimi. Akademik Basha po ashtu ka marrë pjesë edhe në ceremoninë në të cilën ndahej Çmimi i lartë i ALLEA-s, ku prezentë përveç përfaqësuesve të shumë akademive europiane ishte edhe Kryetari i Komisionit Europian, Jose Emanuel Baroso.



LIGJËRATA INAUGURUESE E EDI SHUKRIUT

Në mjediset e Akademisë, më 17 prill 2014 u mbajt ligjërata inauguruese e anëtares korrespondente Edi Shukriu: "Tej imazhit arkeologjik – kosmologjia dardane".

Fjalën e hapjes më këtë rast e mbajti sekretari i Seksionit të Shkencave Shoqërore akademik Mark Krasniqi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit tha se ligjërata inauguruese po mbahet me rastin e zgjedhjes së prof. Shukriut anëtare korrespondente e ASHAK-ut.

AKADEMIK REXHEP ISMAJLI NË ASAMBLENË XV TË PËRGJITHSHME TË ALLEA-s

Më 23-26 prill 2014 akademik Rexhep Ismajli ka qëndruar në Oslo.

Në mjediset e Akademisë Norvegjeze të Shkencave dhe të Arteve në Oslo ai ka marrë pjesë në Asamblesë XV të përgjithshme të ALLEA-s. Në kuadër të punimeve të Asamblesë akademik Ismajli ka marrë pjesë në Simpoziumin me temë: "Enabling Early Carrier Researchers – Need for Training of a New Generation".

ASHAK MERR PJESË NË FESTIVALIN E LIBRIT DHE ARTIT

Më 23-27 prill në Tiranë ASHAK mori pjesë me botimet e veta në Festivalin e Parë të Librit dhe Artit, Tirana 2014. Manifestimi u mbajt në Muzeun Historik Kombëtar dhe u organizua nga Shoqëria e Librit Shqip.

AKADEMIK ZEQIRJA BALLATA MERR PJESË NË SIMPOZIUMIN NDËRKOMBËTAR MBI ARTET NË SOFJE

Me ftesë të Akademisë së Shkencave të Bullgarisë, në kuadër të protokollit të bashkëpunimit ASHAK-BAS, akademik Zeqirja Ballata ka marrë pjesë në Simpoziumin 5-ditor ndërkombëtar mbi artet, të organizuar nga Instituti i Studimeve të Arteve të Akademisë së Shkencave të Bullgarisë.

Akademik Ballata është paraqitur me kumtesën: "Mbi disa veçori të kompozitorëve shqiptarë të Kosovës të shek. XX".

AKADEMIK REXHEP ISMAJLI MERR PJESË NË PLENUMIN SOLEMN TË AKADEMISË AUSTRIAKE TË SHKENCAVE

Më 15 -19 maj akademik Rexhep Ismajli ka qëndruar në Vjenë, ku ka marrë pjesë në Plenumin solemn të Akademisë Austriake të Shkencave. Ai atje ka marrë pjesë edhe në organizimet tjera në kuadër të

plenumit, si dhe ka realizuar takime të rëndësishme.

TRAJNIMI PËR FJALORIN ENCIKLOPEDIK

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, përkatësisht Redaksia Qendrore e FEK-ut ka organizuar takim pune për Fjalorin Enciklopedik të Kosovës në Durrës nga 9-12 qershor 2014.

Në takim kanë marrë pjesë: Redaksia Qendrore e Fjalorit dhe redaktorët e fushave përkatëse të FEK-ut, me përjashtim të ndonjë zëvendësimi të tyre nga një anëtar i redaksisë përkatëse.

Takimi është realizuar sipas programit të paraparë.

ÇMIMI STIMULUES I FONDIT

Më 16 qershor 2014 u organizua ceremonia solemne e ndarjes së Çmimit stimules për veprën më të mirë nga lëmi i shkencave të natyrës për tre vjetët e fundit (2011-2013). Laureati i këtij çmimi u zgjodh prof. dr. Lulzim Zeneli. Fjalën e hapjes me këtë rast e mbajti akademik Fejzullah Krasniqi, ndërsa për veprimtarinë shkencore të prof. Zenelit foli akademik Nexhat Daci, i cili e vlerësoi lart punën e tij.

Në fund prof. Zeneli falënderoi ASHAK-un për çmimin e dhënë.



TRYEZË SHKENCORE

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i Shkencave Shoqërore, organizoi Tryezën shkencore "Arkeologjia në trojet shqiptare - sfidat dhe mundësitë".

Tryeza u mbajt të enjten, më 19 qershor 2014, me fillim në orën 9:30, në mjediset e Akademisë.

Fjalën e hapjes e mbajti sekretari i Seksionit akademik Mark Krasniqi.

AKADEMIK PAJAZIT NUSHI MERR PJESË NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE KUSHTUAR AKADEMIKUT JASHAR REXHEPAGIQ

Me ftesë të Akademisë Pedagogjike të Tiranës, akademik Pajazit Nushi, më 22-23 maj ka marrë pjesë në Konferencën ndër-kombëtare me titull: "Akademik Jashar Rexhepagiqi dhe mendimi social-pedagogjik i tij". Akademik Nushi është paraqitur me kumtesën e tij: "Psikologjia dhe pedagogjia në mendimin social-pedagogjik të akademik Jashar Rexhepagiqit".

AKADEMIK REXHEP ISMAJLI DHE ANËTARJA KORRESPONDENTE EDI SHUKRIU NË BUDAPEST

Më 25-27 maj akademik Rexhep Ismajli dhe anëtarja korrespondente Edi Shukriu kanë marrë pjesë në konferencën shkencore me titull: "Albanians and Hungarians Historical Similarities and Differences in Centuries - The Contribution of Their Diasporas in Their Mutual Recognition" të organizuar nga Universiteti i Budapestit.

ANËTARI KORRESPONDENT SALIH GASHI QËNDRON NË KOPENHAGEN

Më 21-26 qershor anëtari korrespondent Salih Gashi ka qëndruar në Kopenhagen, ku ka marrë pjesë në tubimin: "Euroscience Open Forum (ESOF)". Ai ka realizuar edhe takime të rëndësishme në kuadër të zhvillimit të shkencës dhe orientimet për të ardhmen.

ASHAK MERR PJESË NË SHKOLLËN VERORE DHE KONFERENCËN LET'S FACE CHAOS THROUGH NONLINEAR DYNAMICS

Më 22 qershor deri më 6 korrik 2014, në Maribor u mbajt shkolla verore dhe konferenca: "Let's Face Chaos Through Nonlinear Dynamics".

Në emër të ASHAK-ut në këtë ngjarje mori pjesë prof. dr. Qëndrim Gashi.

KONCERT VEPRASH VOKALO- PIANISTIKE

Seksioni i Arteve i Akademisë së

Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 3 korrik 2014, në mjediset e Akademisë organizoi koncert veprash vokalo-pianistike me vepra të përzgjedhura kompozitorësh të njohur: Wolfgang Amadeus Mozart, Franz Lehar, Kozma Lara, Esat Rizvanolli, Fahri Beqiri, Zeqirja Ballata, Rauf Dhomi.

Artistët: Besa Llugini, soprano; Armando Likaj, bariton; Lejla Haxhiu Pula, piano; Etrita Ibrahim, piano; Çun Lajqi, aktor, të cilët realizuan me shumë sukses programin e paraparë.

TUBIM SHKENCOR - GJUHA E SIMETRIVE

Më 11 korrik 2014, në sallën e Akademisë, Seksioni i Shkencave të Natyrës, përkatësisht Këshilli organizativ në përbërje: Dr. Qamil Haxhibeqiri (ASHAK), Dr. Masoud Kamgarpour (Universiteti i Kuinslandit) dhe Dr. Qëndrim Gashi (Universiteti i Prishtinës) organizoi Tubimin shkencor me titull: "Gjuha e simetrive - një këndvështrim nga teoria e përfaqësimit dhe gjeometria".

Referues në këtë tubim ishin: Dr. Ethan Cotterill, Universiteti Federal Fluminense, Brazil, dr. Harald Grobner, Universiteti i Vjenës, Austri, dr. Masoud Kamgarpour, Universiteti i Kuinslandit, Australi, Robert Kremser, Universiteti i Mynihut, Gjermani, dr. Marie-Amelie Lawn, Universiteti i Teksasit, Austin, SHBA, dr. Justin Noel, Universiteti i Regensburgut. Gjermani, dr. Travis Schedler, Universiteti i Teksasit, Austin, SHBA.

MBAHET NË TIRANË MBLEDHJA E KËSHILLIT NDËRAKADEMIK PËR GJUHËN SHQIPE (KNGJSH)

Më 20 qershor 2014, në Tiranë, në mjediset e Bibliotekës së Akademisë së Shkencave u mbajt mbledhja e radhës e Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe, nën drejtimin e akademikëve Jani Thomai e Rexhep Ismajli (bashkëkryetarë) dhe me pjesëmarrjen e anëtarëve të Këshillit: akademikët Kolec Topalli e Gjovalin Shkurtaj dhe profesorët Mehmet Çeliku, Seit Mansaku, Shezai Rrokaj, Shefikje Islamaj, Enver Hysa, Isa Bajçinca, Imri Badallaj, Abdullah Zymberi, Bardh Rugova e Rrahman Paçarizi.

Në rendin e ditës për diskutim pati dy çështje:

1. Çështje të sintaksës në shqipen standarde;
2. Shqipja standarde dhe shkolla.

Për të dy çështjet u paraqitën parashtrësit e hartuara nga grupet përkatëse të punës në Tiranë e në Prishtinë, në të cilat shtroheshin vëzhgimet për gjendjen dhe propozimet për përmirësime të mëtejshme në përdorimin e zbatimin e shqipes standarde.

Këshilli arriti këto përfundime e propozime:

1. Meqë cikli nëntëvjeçar nuk po arrin dot t'ua mësojë mirë nxënësve të gjitha nënsistemet e shqipes standarde, si në të shkruar ashtu edhe në të folur, propozohet që gjuha shqipe në planin mësimor të shkollës së mesme të jetë lëndë e veçantë, e ndarë nga letërsia, dhe të jepet provim pjekurie në

përfundim të shkollimit parauniversitar.

2. U miratua propozimi që në të gjitha shkollat e mesme të të gjitha profileve lënda e gjuhës të mësohet gjatë tri viteve, me një program të ri dhe me tekste të reja.

3. U mbështet propozimi që në vitet e para të ciklit nëntëvjeçar (cikli fillor) në mësimin e gjuhës shqipe t'i jepet përparësi anës praktike, zotërimit të standardit, bashkë me leximin; në vitet në vazhdim të ciklit nëntëvjeçar (klasa VI-IX) dhe në ciklin e shkollës së mesme gjuha të mësohet në aspektin teorik, por, krahas kësaj, t'u jepet rëndësi e veçantë leximit të letërsisë artistike dhe punëve me shkrim, hartimeve e diktimeve.

4. U arrit përfundimi që planet e programet në fakultetet e mësuesisë, përfshirë ato të gjuhëve të huaja e fakultetet që përgatisin edukatorë për institucionet parashkollore, si dhe në fakultetet e gazetarisë, ka nevojë të rishikohen, duke u dhënë shtrirje më të gjerë lëndëve kryesore të gjuhës së sotme, si leksikologjia, morfologjia, sintaksa. Mendohet që përvetësimi i drejtshkrimit duhet të përfundojë në shkollimin parauniversitar. U propozua që lënda Kulturë gjuhe të përfshihet në programet e universiteteve, në radhë të parë në fakultetet e mësuesisë, të gazetarisë, të gjuhëve të huaja, të arteve, të drejtësisë, të mjekësisë etj., me synimin e zotërimit sa më të mirë të normës leksikore, gramatikore, stilistike e terminologjike në funksion të komunikimit sa më të plotë.

5. U pa e arsyeshme të kërkohet për t'u zbatuar nga institucionet përkatëse:

- rritja e orëve mësimore për lëndën e gjuhës në ciklet nëntëvjeçare;

- reduktimi i normës mësimore për mësuesit e gjuhës;

- mësimi i gjuhës shqipe në ciklet parauniversitare, nëpërmjet teksteve e mësuesve, sipas koncepteve teorike e terminologjike bashkëkohore;

- trajnimi i mësuesve të gjuhës në kurse periodike katërvjeçare;

- hartimi i teksteve për fëmijët e emigrantëve sipas një politike në ndihmë të emigracionit;

6. Përgatitja e gjuhës shqipe në universitete duhet të jetë përparësi e arsimit universitar, ndërsa mësimdhënës i lëndës së gjuhës dhe të letërsisë shqipe në nivelet e ulëta e të mesme nuk mund të jetë askush që nuk ka, së paku, 180 kredi (ECTS) të lëndëve profesionale sipas plan-programeve të shkollave përkatëse. Ndonëse nismat për përmirësimin e cilësisë në arsim kanë propozuar shtimin e komponentit didaktik, kujtojmë se kompetenca gjuhësore është parakushti themelor për mësimdhënie cilësore.

7. Albanologjia, me shqipen në veçanti, duhet të jetë përparësi e investimeve shkencore të qeverive përkatëse. Përqindje të konsiderueshme të investimeve për shkencë e kërkime shkencore duhet të jepen për projekte që lidhen me albanologjinë. Duhet të ngrihet departament i veçantë për gjuhën shqipe (përdorimet, terminologjitë, përshtatjet me standardet evropiane, ku po synojmë të integrohemi) në

kuadër të ekzekutivit (mbase brenda Ministrive të Arsimit a të Kulturës).

8. Në shkolla t'i kushtohet vëmendje diversitetit kulturor e begatisë dialektore të shqipes, në mënyrë që të mos krijohet hapësirë për stigmatizim të cilitdo varietetit të shqipes.



MBLEDHJA PËRKUJTIMORE PËR AKADEMIK BESIM BOKSHIN

Më 16 gusht 2014 vdiq akademik Besim Bokshi. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës mbajti mbledhjen komemorative më 17 gusht.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë akademik Hivzi Islami i cili ndër të tjera tha:

“E nderuara familje Bokshi,
Të nderuar kolegë dhe miq,
Zonja dhe zotërinj,

Jemi mbledhur sot këtu, në mjediset e Akademisë, për t'i bërë nderimet e fundit anëtarit të rregullt të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe ish-kryetarit të saj, dijetarit dhe personalitetit që pati një rrugë të bujshme jetësore, intelektuale,

shkencore-hulumtuese dhe publike, akademik Besim Bokshit.

Ju ftoj që me një minutë heshtje ta nderojmë bashkëshortin, prindin, gjyshin, mikun dhe kolegun tonë të dashur profesor Besim Bokshin. Akademik Bokshi bën pjesë në lagjen e personaliteteve më të shquara në fushën e shkencës, të arsimit dhe të kulturës shqiptare në Kosovë dhe jashtë saj këto 6 dhjetëvjetëshat e fundit, ku la gjurmë të pashlyeshme në jetën letrare-kulturore, kombëtare dhe intelektuale, në dijet albanologjike dhe veçanërisht në gjuhësinë shqiptare, duke u gjendur në majat e saj. Punën e tij e filloi në Gjakovën arsimdashëse dhe patriotike, ku në vitet e 50-ta e të 60-ta të shek. të kaluar ushtroi funksione të ndryshme në arsim dhe kulturë, për të arritur deri te bashkëpunëtori shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës, të cilit në fillimet e tij i dha mbështetje të fuqishme profesionale, pastaj u zgjodh profesor i Universitetit të Prishtinës dhe anëtar i rregullt i Akademisë dhe nënkryetar e kryetar i saj. U shqua dhe në afirmimin e vlerave kombëtare e kulturore-civilizuese të shqiptarëve dhe në organizimin e institucioneve shkencore, pedagogjike e kulturore të Kosovës. E deshi shumë Gjakovën, por edhe ajo e deshi dhe e respektoi shumë, duke ia akorduar çmimin qytetar i nderit të qytetit. Deri në minutën e fundit të jetës nuk pushoi të kontribuojë në fushën e shkencës së gjuhësisë dhe albanistikës në përgjithësi, duke zgjeruar opusin e tij shkencor me botime të reja. Për këtë dëshmon edhe dorëshkrimi që la të

finalizuar, i cili këto ditë shkon në shtyp, gjithnjë në fushën e gjuhësisë shqiptare, por nuk pati jetë që ta priste daljen në dritë të tij. Vepra e tij shkencore në sferën e gjuhësisë do të mbetet pa dyshim burim reference për brezat e sotme dhe të nesërme. Pa akademik Bokshin nuk ka dyshim që gjuhësia dhe kultura shqiptare do të ishin më të varfra. Trashëgimia e ndritshme që la pas e bëjnë të pavdekshëm shkencëtarin dhe krijuesin, profesor Besim Bokshin.

Me këtë rast Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së akademikut Besim Bokshi, si dhe të gjithë miqve dhe shokëve të tij të shumtë anë e mbanë Kosovës dhe trojeve shqiptare”.

Për jetën dhe vdekjen e akademik Bokshit fjalë rasti mbajti akademik Rexhep Ismajli, nga e cila veçnam:

“I nderuar Z. Kryetar i Akademisë,

Zonja Muhamedije, Astrit, Shkëndije, Ilir, familja Bokshi, miq e kolegë të pikëlluar.

Dje pushoi së rrahuri zemra e dijetarit dhe poetit, e të urtit, studiuesit, vrojtuesit e këshilltarit të durimshëm, albanologut që gjithë jetën e tij kërkoi dhe gjeti shpjegime për mistere të fshehura në historinë e pashkruar të thesarit tonë më të madh të gjuhës, poetit që me dritën e mendjes përjetësonte e luçidonte qeniesimin tonë të përkohshëm, të vështirë e të mundimshëm, vinte çdo ditë nga një gur në themelin e krenarisë sonë.

Me studimet që shënojnë majat e

albanistikës, me krijimet e veçanta letrare poetike, me veprimtarinë intelektuale publike, me jetën e tij frymëgjatë arsimuese për brezat e shekullit që shoi robërinë, me punën e tij të themeltë shoqërore e politike, me angazhimet në Lëvizjen për pavarësi të vendit, Akademik Besim Bokshi shquhet në horizontet e dijeve, të kulturës dhe të botës shqiptare. I lindur në Gjakovë më 1930, i diplomuar në albanologji më 1958, i doktoruar në shkencat filologjike me specializim në fushë të historisë së gjuhës shqipe në Prishtinë më 1978, profesor dhe drejtor i gjimnazit në Gjakovë, profesor dhe Drejtor i SHLP në Gjakovë, profesor dhe shef i Degës së Gjuhës Shqipe në FF/ F të UP-së, anëtar i ASHAK-ut nga 1989, nënkryetar i ASHAK-ut 2002-2008 dhe kryetar nga viti 2008-2011, pjesëmarrës aktiv dhe bashkëhartues i Konkluzave të Konsultës Gjuhësore të Prishtinës, pjesëmarrës i Kongresit të Drejtshkrimit, drejtues i Komisionit për Gjuhë i ASHAK-ut, anëtar i Këshillit Ndërrakademik për Shqipëri Standarde, akademik Besim Bokshi ishte i pranishëm në mënyrë të vazhdueshme, të qetë, por me veprim të themeltë, në jetën tonë plot të papritura dhe ngado që sillej linte gjurmë të pashlyeshme kulturore, shkencore, arsimore e emancipuese shoqërore në botën shqiptare qysh nga vitet '50 të sh. XX. Prania e tij në gjithë këtë gamë përpjekjesh të botës shqiptare në një histori tashmë të pikatur për rropatjet e turbulencat do të mbetet e shënuar me ndihmesat thelbësore, me rezultatet që çojnë peshë, me orientimet ndriçimtare, me synimet për çlirimin

nga vargojt e të gjitha llojeve. I dijshtëm dhe i urtë, shembull korrekte ndaj tjetrit, vrojtues i thellë e me veprime të matura, por të vendosura e deri në fund të përgjegjshme, Besim Bokshi ishte bërë një lloj shenje orientuese për ata që e rrethonin, për ata që ndjenin rrezet e dritës së mendjes së tij, për ata që mësuan prej tij, për ata që shijuan bukurinë dhe thellësinë e fjalës së tij, për ata që vlerësuan moralin dhe mësimin shembullor moral prej veprës dhe veprimtarisë së tij, për të gjithë ata që nga Gjakova e në tërë Kosovën, në hapësirat e dijeve e të jetës kërkonin horizonte të lirisë, të dinjitetit, të krijimit e të lumturisë njerëzore.

Në veprimtarinë e tij shoqërore Besim Bokshi ishte gjithnjë i lidhur me fushën e arsimit, ku shkëlqeu me aurën e tij prej të dijshtëmit, të thellit, të urtit kërkues të së drejtës e të barazisë dhe pikërisht në bazë të një autoriteti të tillë vazhdimisht ishte kërkuar nga ai të angazhohej në funksione të ndryshme shoqërore, të jepte ndihmesën e tij për zgjerimin e horizonteve të lirisë nga deputeti i Kosovës në fund të viteve '60 e deri te kryetari i Partisë Socialdemokrate të Kosovës në vitet e rënda '90.

Në letrat shqipe emri i Besim Bokshit shfaqet në vitet '50 me poezitë me ngjeshje të madhe semantike e emocionale në temën e poezisë refleksive e shoqërore, me vulën e protestës, me metaforikën e thellë e me simbolikën kombëtare, poezi që zhytet në thellësitë dhe degëzimet e simboleve, të kuptimeve. Në poezinë e Bokshit edhe tematizimet sociale marrin vulën e refleksionit, shprehen

me një figuracion të kursyer, por të thellë. Jo rrallë në të gjejmë reflekse të thelluara me shprehje finoke të qëndrimeve, të distancave ndaj padrejtësisë, ndaj pabarazisë, ndaj shkeljeve të dinjiteti njerëzor, ndaj cenimit të lirisë, në pritje të së cilës edhe kur të plakem, siç thoshte ai në poezinë e bukur Në pritje, 'e s'do të mundem me qeshë si filladi i pranverës', "Me vdekë, porse, nga gëzimi do të mundem".

Shkëlqimin madhor të mendjes krijuese akademik Besim Bokshi e shënoi në studimet për gjuhën shqipe, ku vlen ndër autoritetet më të mëdha. Me hulumtimet frymëgjata e të thelluara në fushën e linguistikës, në fushën e strukturës gramatikore të shqipes, me vrojtimitet e rëndësishme për strukturat gramatikore të gjuhëve të Ballkanit, me akribinë shembullore shkencore, akademik Besim Bokshi ka sjellë kontribute me vlerë të jashtëzakonshme. Ndihtesat e tij për studimet e zhvillimeve gramatikore të shqipes zënë vend të veçantë për origjinalitetin e mënyrës së hulumtimit, për rezultatet e shumta, për thellimin krejt të veçantë, për vështrimin sistemor e struktural në këto studime, për orientimin e përgjithshëm të tyre drejt horizonteve të reja, për krijimin e një koncepti koherent dhe konsistent për rrugët e zhvillimeve morfologjike, në ndërlidhje me zhvillimet e tërësishme strukturore të shqipes. Duke i integruar studimet për strukturën gramatikore të shqipes në rrjedhat studimore të kohës, duke i

shpënë ato ndjeshëm përpara dhe modernizuar në metodë, akademik Besim Bokshi e ka rritur kredibilitetin e studimeve albanistike shqiptare në komunitetin e studiuesve të gjuhës dhe ka krijuar një model për t'u ndjekur nga të rinjtë.

Po lejohem të shquaj me këtë rast për disa prej veprave të tij madhore. Në gjuhësinë shqiptare ai u shfaq më 1971 me studimin befasishtë të thellë për tipat e temave nominale në gjuhën shqipe.

Më 1978 Bokshi përfundoi monografinë *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, vepër në të cilën dalin në shesh cilësitë kryesore të lingvistit Bokshi: orientimi rezolut diakronik, por prandaj me vështrim të thelluar në funksionimin sinkronik të sistemit gjuhësor. Në studimet e gramatikës historike të shqipes me atë vepër futeshin nëpër derë të madhe metodat gjuhësore mbisunduese të shekullit 20, ato që gjuhën e shihnin si sistem. Kjo monografi e Besim Bokshit mbetet një nga veprat me rëndësi themelore për studimet në fushën e gramatikës historike të shqipes në tërësi. Prapavendosja e nyjeve në gjuhët ballkanike është një libër tjetër me vlerë i Besim Bokshit për albanologjinë dhe për ballkanologjinë, vepër në të cilën hipoteza për ngjizjen e procesit të prapavendosjes së nyjës në gjuhët e Ballkanit ka nisur pikërisht në shqipen vjen e bëhet një teori e rëndësishme, refuzimi i së cilës tashmë nuk është gjë e lehtë.

Ai na ka dhënë një monografi të rëndësishme që na shpie drejt shpjegimeve edhe të sistemit foljor po me këto rrugë e procedime: monografinë *Pjesorja e shqipes*. Depërtime të ngjashme të Bokshit ndeshim dhe në monografinë me shumë interes *Për vetorët e shqipes*, ndërsa kërkuesi i madhe zgjon libri i tij i fundit *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*, që paraqet një vepër sintetizuese për idetë dhe për periodizimet e propozuara deri tash mbi bazë të të dhënave vetëm gjuhësore. Me këtë libër Bokshi ka bërë dhe një hap tjetër me rëndësi, duke vënë kështu një rend që mund të nxisë ide të reja më tej. Akademik Besim Bokshi nuk reshti së studiuar deri në frymën e fundit të jetës së tij. Para pak javësh shkoi në shtyp vepra e tij më e re *Varia*, ku përfshihen diskutime për çështje të veçanta shkencore, por edhe për personalitete të dijes e të jetës shoqërore. Për fat të keq, ai nuk arriti ta shihte dritën e këtij botimi. Pak ditë më herët ai më fliste për një projekt të tij të ri studimi, për të cilin po punonte edhe në atë gjendje të rënduar me probleme shëndetësore. Horizontin e studimeve të tij gjuhësore akademik Besim Bokshi e kishte lidhur me nevojën për shpjegimet e zhvillimeve që kanë ndodhur në një gjuhë me lashtësi të madhe, por me dokumentim të vonë. Të kuptuarit e funksionimit të sotëm të kësaj gjuhe i jepte atij dritën e çelësit shpjegues për rrugët e atij zhvillimi. Dhe atë funksionim ai e kishte hetuar me tërë frymën dhe thellësinë e mendjes,

gjë që shpesh, në mbisundimin e nevojës për shpjegimet diakronike, mbetjet implicite, e nënkuptuar, e kërkueshme nga lexuesi, frymëzuese për atë që hyn në dialog me të. Dhe kjo u siguron veprës dhe ideve të tij jetëgjatësinë.

Në poezi, si në aforizma, në gjuhësi apo në jetë, Besim Bokshiti i përshtatet thënia: për thelbësoren fol në mënyrë thelbësore. Me thellësinë, me refleksivitetin prej të urti, me vendosmërinë dhe guximin prej hulumtuesi të përkushtuar, me lirinë dhe dritën e mendjes, me afërsinë njerëzore, me butësinë dhe dashamirësinë e tij, me përmbajtjen e respektin ndaj tjetrit që rrezaton qetësi e siguri tek rrethi, akademik Bokshiti ka bërë që mjedisi ku ka vepruar të ndjehet krenar që e ka pasur në shkollë, në Universitet, në Akademi, në institucione apo jashtë tyre, në rrethin e gjerë dhe në horizontet e jetës. Për familjen dhe rrethin e të afërmeve shuarja e të dashurit është e rëndë, ndërsa për kulturën, dijen dhe botën shqiptare e pakompensueshme. Ngushëllimin duhet ta gjejmë në veprën që na ka lënë, në dritën e mendjes që do të vijojë të na ndriçojë”.

Pas mbledhjes komemorative u bënë homazhe të shumta pranë trupit të të ndjerit dhe më pas kortezhi funeral u nis për në varrezat e Gjakovës.

Pranë varrit të akademik Bokshiti në praninë e shumë strukturave udhëheqëse, qytetarëve të Gjakovës

dhe më gjerë folën: akademik Pajazit Nushi, në emër të ASHAK-ut, përfaqësues nga ASHSH dhe kryetari i Asamblesë Komunale të Gjakovës.

AKADEMIK ENJËLL BERISHA NDEROHET ME ÇMIMIN KOMBËTAR PËR VEPËR JETËSORE "Niketë Dardani"

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Memli Krasniqi, më 17. 09. 2014, në një ceremoni solemne ia ka ndarë Çmimin Kombëtar për Vepër Jetësore "Niketë Dardani" për fushën e muzikës, kompozitorit dhe pedagogut të njohur shqiptar, akademik Engjëll Berishës.



KONFERENCË SHKENCORE Lufta e Parë Botërore dhe çështja shqiptare 1914- 1918.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i Shkencave Shoqërore, organizoi Konferencën shkencore "Lufta e Parë Botërore dhe çështja shqiptare 1914-1918".

Konferenca u mbajt të premtën, më 19 shtator 2013, me fillim në orën 10:00, në mjediset e Akademisë.

Konferencën e shpalli të hapur me një fjalë rasti akademik Pajazit Nushi.

Anëtarë të Këshillit Organizues ishin Jusuf Bajraktari, Beqir Meta, Fehmi Rexhepi, Marenglen Verli, Frashër Demaj, Lush Culaj.

Me kumtesat e tyre në konferencë u paraqitën:

1. Beqir META, Ndikimi i Luftës së Parë Botërore në procesin e konsolidimit të kombit shqiptar;

2. Jusuf BAJRAKTARI, Kosova dhe viset tjera shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore;

3. Marenglen VERLI, Shqipëria në optikën e diplomacisë vjeneze në prag të Luftës së Parë Botërore;

4. Anton PANÇEV, Statistikat bullgare mbi popullsinë e Kosovës në Luftën e Parë Botërore;

5. Skender ASANI, Viset lindore shqiptare nën okupimin serb 1912-1915;

6. Fehmi REXHEPI, Zona okupuese bullgare gjatë Luftës së Parë Botërore në Kosovë;

7. Frashër DEMAJ, Diplomacia e Fuqive të Mëdha gjatë Luftës së Parë Botërore;

8. Isa BICAJ, Mali i Zi dhe shqiptarët gjatë Luftës së Parë Botërore;

9. Islam LAUKA, Lufta e Parë Botërore dhe konflikti aktual Rusi-Ukrainë;

10. Teki KURTI, Shtypi shqiptar për Luftën e Parë Botërore;

11. Ramë MANAJ, Lënda arkivore për Luftën e Parë Botërore në Arkivin e Kosovës;

12. Lush CULAJ, Protestat e

shqiptarëve dërguar Konferencës së Versajës.

Fjalën përmbyllëse e mbajti anëtar korrespondent Jusuf Bajraktari.



TRYEZË SHKENCORE "UJITJA NË KOSOVË - Menaxhimi i ujërave për bujqësi të qëndrueshme".

Seksioni i Shkencave të Natyrës i ASHAK-ut organizoi më 16 tetor 2014 tryezën shkencore "Ujitja në Kosovë - Menaxhimi i ujërave për bujqësi të qëndrueshme".

Anëtarë të Këshillit Organizues ishin Ruzhdi Pllana, anëtar korrespondent i ASHAK-ut, Feriz Krasniqi, akademik, dhe prof. dr. Bashkim Kabashi.

Fjala hyrëse u mbajt nga akademik Fejzullah Krasniqi, ndërsa fjala përshëndetëse nga Ruzhdi Pllana, anëtar korrespondent i ASHAK-ut. Tryeza u zhvillua në dy sesione gjatë të cilave u paraqitën kumtesat e pjesëmarrësve si dhe u zhvilluan diskutime pas secilit sesion. Kumtesat u lexuan nga këta pjesëmarrës: Bashkim Kabashi, Ruzhdi Pllana, Mazllum Baraliu, Besnik Gjongecaj, Latif Susuri,

Sylejman Daka, Shukri Fetahu, Sali Aliu, Justina Boriqi, Besim Sahiti, Lavdim Lepaja, Demë Abazi dhe Sami Kryeziu. Disa nga kumtesat ishin kumtesa të përbashkëta. Në fund pjesëmarrësit u pajtuan që të dalin me konkluzione të përbashkëta rreth tryezës shkencore.

ANËTARI KORRESPONDENT ARSIM BAJRAMI NË MAQEDONI

Më 5-6 nëntor, me ftesë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë, anëtari korrespondent Arsim Bajrami ka marrë pjesë në konferencën shkencore kushtuar projektit të bashkëpunimit rajonal, në të cilën kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të akademive të tjera, si: Shqipëria, Bullgaria, Turqia, Moldavia.

NË TIRANË MBAHET KONFERENCA SHKENCORE KUSHTUAR 200-VJETORIT TË LINDJES SË DE RADËS

Akademia e Shkencave e Shqipërisë më 11 nëntor 2014 organizoi Konferencën shkencore kushtuar 200-vjetorit të lindjes së Jeronim De Radës. Nga Akademia jonë në këtë konferencë morën pjesë akademikët Ali Aliu dhe Sabri Hamiti.

Ali Aliu u paraqit me kumtesën: "Vizioni testamentar i De Radës" tek 'Parimet e estetikës', ndërsa Sabri Hamiti paraqiti kumtesën: "Milosao".



ASHAK MERR PJESË NË PANAIRIN E LIBRIT TIRANA 2014

Më 12-16 nëntor në Tiranë, në Panairin e 17-të të librit, Tirana 2014, në mesin e rreth 100 shtëpive botuese, institucioneve shkencore dhe arsimore nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia, përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Francës, Italisë dhe Suedisë, me botimet e veta është paraqitur edhe ASHAK.

Stenda ka qenë e vendosur në hollin kryesor të Pallatit të Kongreseve dhe ASHAK.

ANËTARJA KORRESPONDENTE EDI SHUKRIU MERR PJESË NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE INTEGRIMI KULTUROR DHE STABILITETI NË BALKAN

Më 25-27 nëntor anëtarja korrespondente Edi Shukriu ka qëndruar në Shkup. Ajo ka marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare me titull: "Integrimi kulturor dhe stabiliteti në Ballkan" të organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Maqedonisë dhe Akademia e Shkencave të Bullgarisë. Konferenca u

organizua si pjesë e projektit bilateral shkencor, i cili kishte në fokus hulumtimet e vitit 2014 lidhur me identitetet ballkanike dhe stereotipet rreth identitetit ballkanik në kontekstin e rrjedhave bashkëkohore të integritimit kulturor të identiteteve kulturore të veçanta.



TRYEZË SHKENCORE "Në 200-vjetorin e lindjes së Jeronim De Radës".

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i ASHAK-ut më 21 nëntor 2014 organizoi tryezën shkencore 'Në 200-vjetorin e lindjes së Jeronim De Radës'. Fjala hyrëse u mbajt nga akademik Mehmet Kraja, ndërsa tryezua u moderua nga akademik Ali Aliu. Tryeza u mbajt sipas programit të paraparë prej dy seancash gjatë të cilave u lexuan kumtesat e të ftuarve. Në tryezë morën pjesë të gjithë të ftuarit. Në kuadër të seancës së parë u paraqitën me kumtesa pjesëmarrësit si në vijim: Ali Aliu, Françesko Altimari, Floresha Dado, Sabri Hamiti, Pajazit Nushi, Dhurata Shehri, Luan Starova dhe Alfred Uçi.

Pushimi i shkurtër për kafe u shfrytëzua për promovimin e veprës së Françesko Altimarit "Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe

italian" e cila u mirëprit nga pjesëmarrësit si një kontribut i çmuar në këtë fushë. Pjesëmarrësit që u paraqitën me kumtesa në seancën e dytë ishin: Mateo Mandala, Ymer Çiraku, Zejnullah Rrahmani, Ardian Marashi, Fatmir Sulejmani, Mark Marku, Kujtim Shala dhe Mehmet Kraja.

Kjo tryezë u vlerësua të jetë edhe një hap më tutje në trajtimin e veprës së Jeronim De Radës nga aspekte të ndryshme sociolinguistike, estetike etj.



AKADEMIKËT IDRIZ AJETI, MARK KRASNIQI dhe ALI ALIU "Nderi i Kombit"

Presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Bujar Nishani dekoroi me çmimin "Nderi i Kombit" akademikët Idriz Ajetin, Mark Krasniqin dhe Ali Aliun. Ceremonia solemne u mbajt më 28 nëntor në Tiranë.

Në nderim të akademikëve në fjalë, kryetari Islami shtroi drekë solemne në mjediset e Akademisë.



REAGIM I ASHAK

Deklaratë e ASHAK-ut përkitazi me ngjarjet e fundit në UP

Udhëheqja e Akademisë së Shkencave dhe e Arteve të Kosovës po i ndjek me vëmendje zhvillimet në Universitetin e Prishtinës dhe rreth tij. Tensionimet e fundit kanë marrë përmasa shqetësuese.

E tërë kjo situatë tendosjeje në UP ndërlihet me praktikat e gjata të ndërhyrjeve të ndryshme, të drejtpërdrejta a të tërthorta, nga jashtë në punën e këtij institucioni të pavarur. Pasojat e një gjendjeje të tillë, bashkë me ritmet e paharmonizuara të zhvillimeve e sollën UP-në në një gjendje të vështirë, me rreziqe për proceset e ligjshmërisë në funksionimin e tij.

Zgjedhja e rektorit të ri – profesor dr. Ramadan Zejnullahut dhe veprimet e tij në drejtim të respektimit të ligjshmërisë dhe të stabilizimit të gjendjes të përcjellë me çrregullime për vite të tëra janë një shpresë për zhvillime të reja në drejtim pozitiv në

këtë institucion të rëndësishëm arsimor-shkencor të Kosovës dhe të rajonit. Duke e njohur dhe punën e tij të mëhershme si profesor i UP-së, si shkencëtar dhe si dekan shumë i suksesshëm i Fakultetit të Shkencave, duke i vlerësuar nismat që ka ndërmarrë dhe maturinë e vendosmërinë që e karakterizojnë punën e tij, shprehim publikisht mbështetjen për angazhimet e tilla brenda UP-së dhe kërkojmë nga institucionet që të gjejnë rrugë për zhblokimin e nismave të tij gjithsesi pozitive.

Jemi të ndjeshëm dhe për kërkesat dhe nevojat e shtresave të ndryshme të popullsisë, sidomos të pasardhësve të pjesëmarrësve të UÇK-së në luftën e viteve 1998-99, por besojmë se shoqëria dhe institucionet munden dhe duhet të gjejnë rrugë për mbështetjen e tyre duke krijuar rrethana për respektimin e ligjshmërisë dhe të pavarësisë institucionale të Universitetit të Prishtinës, ashtu si të të gjitha institucioneve të tilla në vend. Ligjshmëria dhe puna e përgjegjshme institucionale në UP janë thelbësore dhe vetëm respektimi i plotë i tyre mund të krijojë rrethana edhe për mbrojtjen e interesave të shtresave të ndryshme dhe të tërë Kosovës.

Në historinë e këtij vendi UP ka luajtur rol shumë të rëndësishëm. Prekja e themeleve të tij, që është të qenit institucion i pavarur i arsimit dhe shkencës, vatër e dijes dhe e emancipimit të përgjithshëm të Kosovës dhe të rajonit, mund të lërë pasojë që nuk merren me mend në

zhvillimet e mëtejme. Prandaj bëjmë apel tek institucionet e shtetit që të ndër marrin çdo gjë për të krijuar rrethana sa më të përshtatshme infrastrukturore, po edhe në fushën e burimeve njerëzore e profesionale-shkencore, në mënyrë që UP-ja të jetë në gjendje t'i zgjidhë vetë dhe në mënyrë të pavarur kërkesat e rritura gjithë duke e ngritur cilësinë. Ndërhyrjet nga jashtë, tensionimet si këto të fundit dhe kërcënimet ndaj rektorit që po bën përpjekje serioze për stabilizimin e gjendjes vetëm sa e thellojnë krizën në këtë institucion vital edhe për funksionimet e tjera në vend. Kërkojmë nga të gjithë të jemi të matur dhe të përgjegjshëm në vlerësime, ndërhyrje e nxitje dhe të shquajmë atë që është thelbësore për interesat e UP-së dhe të vendit.



EKSPOZITË DHE MBRËMJE MUZIKORE-POETIKE

Seksioni i Arteve i ASHAK-ut organizoi më 5 dhjetor 2014 një "Ekspozitë dhe mbrëmje muzikore-

poetike" në kuadër të shënimit të 80-vjetorit të lindjes së muzikologut Engjëll Berisha dhe piktorit Xhevdet Xhafa.

Mbrëmja muzikore-poetike u hap nga akademik Zeqirja Ballata. Akademik Rexhep Ferri mbajti fjalën e rastit për piktorin Xhevdet Xhafa, ndërsa akademik Zeqirja Ballata mbajti fjalën e rastit për muzikologun Engjëll Berisha.

Aktori i njohur Çun Lajqi recitoi vargje poetike, ndërsa pjesa muzikore përfshiu interpretimet e sopranos Sanije Matoshi, përcjellë në piano nga Lirika Pula Kasapolli. Mbrëmja muzikore-poetike u mbyll nga akademik Zeqirja Ballata.



AKADEMIK NEXHAT DACI – anëtar i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve të Evropës (ASAE)

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Evropës (ASAE), me seli në Salcburg të Austrisë, ka konfirmuar këto ditë zgjedhjen në radhët e saj të akademik Nexhat Dacit. Në adresë të Akademisë dhe të prof. Dacit, ekspert i njohur në fushën e shkencave kimike, anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ka ardhur letra zyrtare me të cilën njoftohen se është zgjedhur anëtar i rregullt i kësaj Akademie në mbledhjen e Komitetit të Nominimit të mbajtur në

nëntor të këtij viti. Inaugurimi solemn i Akademik Nexhat Dacit do të bëhet në Asamblenë e përgjithshme, që do të mbahet më 8 mars 2015, në Salzburg. Me këtë dëshmohen edhe një herë meritat që u bëhen shkencëtarëve nga Kosova në suaza ndërkombëtare.

ANËTARI KORRESPONDENT SALIH GASHI MERR PJSË NË MBLEDHJEN PLENARE TË GRUPI PUNUES TË ALLEA-s

Më 16-19 dhjetor anëtar korrespondent Salih Gashi ka marrë pjesë në mbledhjen plenare të grupit punues të ALLEA-s, që është mbajtur në Akademinë e Shkencave të Francës, në Paris. Në takim janë shqyrtuar një varg çështjes në lidhje me aktivitetin e grupi punues për vitin 2014, përfshirë edhe projektin AEMASE, marrë nga Komisioni Evropian.



ASHAK NDEROHET ME MIRËNJOHJE NGA BIBLIOTEKA NDËRKOMUNALE E PRIZRENIT

Më 22 dhjetor 2014 në Prizren, në një ceremoni solemne ASHAK nderohet me Mirënjohje për bashkëpunim në

pasurimin e fondit librar. Nga ASHAK në ceremoni morën pjesë anëtarja korrespondente Edi Shukriu dhe znj. Lendita Juniku Pula, sekretare e ASHAK-ut.

Mirënjohjen në emër të ASHAK-ut e mori znj. Pula, e cila me këtë rast përshëndeti të pranishmit me një fjalë rasti.



MBAHET MBLEDHJA E KUVENDIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJEN E KRYESISË SË AKADEMISË

Më 24 dhjetor, në sallën e Akademisë u mbajt mbledhja e Kuvendit zgjedhor të Akademisë për zgjedhjen e Kryesisë së re të saj.

Kuvendi zgjodhi Kryesinë e re me këtë përbërje:

Akademik Hivzi Islami, kryetar, akademik Pajazit Nushi, nënkryetar, akademik Isuf Krasniqi, sekretar i përgjithshëm, akademik Eqrem Basha, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, anëtar korrespondent Jusuf Bajraktari, sekretar i seksionit të Shkencave Shoqërore, akademik Fejzullah Krasniqi, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe anëtar korrespondent Luan Mulliqi, sekretar i Seksionit të Arteve.

VJETARI

2014

Botues

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Mr. Shefqet Riza

Redaktor teknik:

ASHAK

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia: 6.5 tabakë shtypi

Tirazhi: 200 copë

Formati: 16x24 cm

Shtypi:

Focus Print

Shkup